



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 54 regjistër (JR)
Datë 24.09.2021

Nr. 38 i vendimit
Datë 20.09.2023

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Rezarta Schuetz	Kryesuese
Ina Rama	Relatore
Sokol Çomo	Anëtar
Albana Shtylla	Anëtare
Natasha Mulaj	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 20.09.2023, ditën e mërkurë, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Willem Brouwer, me Sekretare Gjyqësore Elba Arapi, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Saimir Smaka, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 415, datë 07.07.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Neni F i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 42 dhe 179/b, pika 5 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 1, 2, 62, 63 dhe 66, pika 1, germa “b” të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ligji nr. 44/2015, datë 30.04.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Neni 46 e vijues i ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.
Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, fillimisht në datën 27.07.2023 e më pas në datën 20.09.2023, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet e ankimit dhe pretendimet e ngritura nga subjekti i rivlerësimit, në ankim dhe në parashtrime, me anë të të cilave kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 415, datë 07.07.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Ina Rama, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Saimir Smaka (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), për shkak të funksionit si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në bazë të nenit 179/b të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio* nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”).
2. Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente brenda afatit ligjor, në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, deklaratën e pasurisë, deklaratën për kontrollin e figurës dhe formularin e vetëvlerësimit profesional.
3. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në funksion të zhvillimit të procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, bazuar në përcaktimet e neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e dërguara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”).
 - 3.1. Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar¹, duke konstatuar se:

(i) *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin, ka mungesë dokumentacioni justifikues për banesën e deklaruar nga babai i subjektit;*

¹ Raporti i ILDKPKI-së është dërguar në Komision me shkresën nr. {***} prot., datë 08.11.2018.

- (ii) *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- (iii) *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- (iv) *nuk ka kryer deklaram të rremë;*
- (v) *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

3.2. DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016 dhe ka konstatuar përshtatshmërinë për vijimin e detyrës për subjektin e rivlerësimit Saimir Smaka².

3.3. KLP-ja ka dërguar në Komision raportin vlerësues për subjektin e rivlerësimit Saimir Smaka³. Raporti është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e formularit të vetëdeklarimit, tri dokumenteve të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe pesë dosjeve të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor. Bazuar në kriteret e vlerësimit, sipas ligjit nr. 96/2016, referuar neneve 71-76, për periudhën 08.10.2013-08.10.2016, KLP-ja ka analizuar lidhur me: (a) aftësitë profesionale⁴; (b) aftësitë organizative⁵; (c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale⁶; si dhe (ç) aftësitë personale dhe angazhimi profesional⁷.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

4. Komisioni, pasi kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Saimir Smaka, për të tria kriteret e rivlerësimit, bazuar në pikat 1/c dhe 3, të nenit 58, pikat 3 dhe 5, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. 415, datë 07.07.2021, vendosi shkarkimin e subjektin e rivlerësimit nga detyra, bazuar në përfundimet për secilin prej kriterëve të vlerësuar si më poshtë.

² Raporti i DSIK-së nr. {***}, datë 30.10.2017, deklasifikuar plotësisht me vendim nr. {***}, datë 30.04.2021, të KDZh-së.

³ Raporti i KLP-së, i miratuar me vendimin nr. {***}, datë 15.05.2020, është dërguar në Komision me shkresën nr. {***} prot., datë 29.05.2020.

⁴ Aftësitë profesionale: (a) në aspektin e njohurive ligjore, subjekti shfaq aftësi në interpretimin dhe zbatimin e ligjit, identifikon drejtë normën ligjore të zbatueshme dhe argumenton zbatimin e saj në rastin konkret (me përjashtim të një rasti në dosjen nr. 2 të përzgjedhur nga subjekti); (b) në aspektin e arsytimit ligjor, shfaq aftësi në arsytimin ligjor e logjik, duke përpiluar vendime e akte të kuptueshme me tekst të qartë, me strukturë të akteve të qëndrueshme, të mirëorganizuar dhe të standardizuar. Subjekti ka marrë pjesë në aktivitete profesionale për ngritjen e nivelit të tij profesional.

⁵ Aftësitë organizative: (a) në aspektin e aftësisë për të përballuar ngarkesën në punë, subjekti i ka kryer hetimet brenda një afati të arsyeshëm në raport me kompleksitetin dhe llojshmërinë e çështjeve; (b) në aspektin e aftësisë për të kryer procedurat hetimore, subjekti ka kryer veprimet e duhura hetimore në kohë të arsyeshme; (c) në aspektin e aftësive për të administruar dosjet, dosjet e vëzhguara janë të rregullta, të plota dhe aktet procedurale janë të sakta, të strukturuar, në respektim të normave të drejtshkrimit.

⁶ Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale: subjekti paraqet komunikim dhe bashkëpunim korrekt me kolegët, eprorët e vartësit. Nuk konstatohet që nga 5 dosjet e vëzhguara të kenë dalë të dhëna me imunitetin e tij ndaj ndonjë ndikimi apo presion të jashtëm, ndonjë shkak paanësie i dokumentuar apo cenim i të drejtave të pjesëmarrësve në proces apo të grupeve shoqërore vulnerable.

⁷ Aftësitë personale dhe angazhimi profesional: (a) aftësitë e komunikimit; (b) aftësia për të bashkëpunuar; (c) gatishmëria për t'u angazhuar. Subjekti shfaq aftësi të mira komunikimi, sjellje të mirë, ka aftësi bashkëpunimi dhe pune në grup, është angazhuar në disa aktivitete profesionale.

4.1. *Për kriterin e vlerësimit të pasurisë: referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës, kreu IV dhe nenit 51 të ligjit nr. 84/2016, bazuar në vlerësimin tërësor të rrethanave të çështjes, subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë. Në vlerësimin e Komisionit, subjekti i rivlerësimit:*

- (i) Ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm.*
- (ii) Nga analiza financiare për periudhën 2013-2016 rezulton se me të ardhurat e fituara nga punësimi i tij, i personave të lidhur me të, ai nuk ka pasur burime të mjaftueshme financiare për kryerjen e investimeve dhe të shpenzimeve të deklaruara në shumën prej 172.731 lekësh.*
- (iii) Nuk ka pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e depozitës prej 1.719.000 lekësh me të ardhurat nga dhënia me qira e tokës bujqësore, duke rezultuar me një balancë negative prej 1.719.000 lekësh.*

4.2. *Për kriterin e pastërtisë së figurës: referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës, kreu V të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.*

4.3. *Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale: referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës, kreu VI të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.*

III. Shkaqet e ankimit

5. Subjekti i rivlerësimit i është drejtuar Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”) me ankim kundër vendimit nr. 415, datë 07.07.2021, të Komisionit, për shkaqe me natyrë procedurale dhe materiale, lidhur me situatën faktike dhe zbatimin e ligjit nr. 84/2016. Këto pretendime janë përsëritur edhe në parashtrimet e paraqitura në datën 24.07.2023. Bazuar në nenin 66, pika 1, germa “b” të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenin 51 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, subjekti i rivlerësimit kërkoi në Kolegj:

- *Gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike.*
- *Konstatimin e shkeljeve të të drejtave kushtetuese dhe ato të parashikuara nga KEDNj-ja ndaj subjektit të rivlerësimit Saimir Smaka, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë.*
- *Ndryshimin e vendimit nr. 415, datë 07.07.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Saimir Smaka, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë.*

A. Parashtrimet e subjektit të rivlerësimit në ankim

6. Lidhur me procesin e rregullt ligjor dhe aspektet procedurale të procesit të rivlerësimit

6.1. *Vendimi i Komisionit është marrë mbi bazën e një hetimi dhe vlerësimi administrativ të paplotë, pa u bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 84/2016, konkluzionet*

e Komisionit janë nxjerrë në shkelje të parimeve themelore procedurale. Ndaj tij është zhvilluar një proces i parregullt ligjor, në kuptim të neneve 42 dhe 179/b, pika 2 të Kushtetutës, nenit 6 të KEDNj-së, nenit 4, pikat 5 dhe 6, nenit 52, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

6.2. *Në shkelje të nenit 6 të KEDNj-së, gjykata nuk ka qenë e pavarur dhe e paanshme, në të gjithë procedurën e ndjekur dhe në vendimin objekt ankimi ka elementë të theksuar të paragjykimit dhe të vendimit të paracaktuar.*

6.3. *Në shkelje të nenit 6 të KEDNj-së, nuk është dëgjuar drejtësisht në përputhje me parimin e kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve. Komisioni ka nxjerrë konkluzione që përbëjnë shkak shkarkimi pa ia njoftuar paraprakisht subjektit dhe pa i kaluar barrën e provës duke mos i dhënë asnjë mundësi për t'u mbrojtur.*

6.4. *Në shkelje të nenit 8 të KEDNj-së, shkarkimi i tij nga detyra është jo proporcional me qëllimin e ndjekur dhe konkluzionet në të cilat është bazuar.*

7. Lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë

7.1. *Për burimin e krijimit të pasurisë llogari rrjedhëse nr. {***} në “Raiffeisen Bank”, në shpjegimet e dhëna në ILDKPKI në datën 20.11.2015 dhe përgjigjet e tij gjatë hetimit administrativ nuk ka përjashtuar të ardhurat e anëtarëve të familjes, prandaj analiza financiare duhet të kryhet për të ardhurat e të gjithë anëtarëve të familjes.*

7.2. *Pasaktësia e konstatuar në formën e mosdeklarimit të burimit të krijimit të pasurisë llogari rrjedhëse, depozitë nr. {***}, nuk është bërë me qëllim fshehjen përderisa provohet mundësia për krijimin e saj me të ardhura të ligjshme.*

7.3. *Për mundësinë e krijimit të pasurisë automjet tip “Mercedes-Benz”, me targa {***}, vlera 4.500 euro, analiza financiare duhet të përfshijë të ardhurat e anëtarëve të tjerë të familjes, përderisa kanë pasur ekonomi të përbashkët familjare, konstatuar dukshëm nga dokumentet e paraqitura prej tij.*

7.4. *Mosdeklarimi i pjesëve takuese të pasurive të llojit “arë” me sip. 1840 m², me sip. 880 m², me sip. 3900 m² dhe ullishte me sip. 1080 m², përfutuar me ligjin nr. 7501/1991, të cilat përcaktohen nga ligji, është pasaktësi e parëndësishme.*

7.5. *Marrëdhënien e qirasë, me vlerë 15.000 lekë në muaj, e shlyer tërësisht për 12 muaj në vlerë 180.000 lekë, e ka deklaruar në deklaratat vjetore të pasurisë, pavarësisht se vlerat kanë qenë nën kufirin për shpenzimet e deklarueshme.*

7.6. *Në analizën financiare 2013-2016, për vitin 2014 janë përlllogaritur dy herë shpenzimet e transportit dhe të qirasë. Balanca negative megjithëse është hipotetike, duhet të interpretohet bazuar në parimin e proporcionalitetit sikundër Komisioni ka vepruar në raste të tjera.*

8. Lidhur me kriterin e kontrollit të figurës

8.1. *Me rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni nuk i ka njoftuar asnjë gjetje dhe nuk i ka kaluar barrën e provës, e pa asnjë të dhënë ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, duke abuzuar me parimin e diskrecionit të njohur nga ligji nr. 84/2016.*

8.2. *DSIK-ja, organi ndihmës i caktuar nga ligji për kontrollin e figurës ka konstatuar përshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit për vijimin e detyrës. Konkluzioni i Komisionit i bazuar në informacione dhe dokumentacion që nuk mund të përdoret është jo logjik dhe i pabazuar në pikën 5, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.*

9. Lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

9.1. *Për procedimin penal nr. {***}, datë 26.11.2014, vendimi i mosfillimit është marrë pas tërheqjes së ankimit dhe ai njoftohet nga sekretaria gjyqësore.*

9.2. *Për procedimin penal nr. {***}, datë 15.02.2016, regjistruar për veprën penale “vjedhje”, nuk ka fakt penal, gabimi në arsyetim në një rast sporadik, edhe sikur të ketë ndodhur nuk përbën shkelje sipas parashikimeve të ligjit nr. 96/2016.*

9.3. *Lidhur me procedimin penal nr. {***}, datë 10.02.2016, regjistruar për veprën penale “përdorim me keqdashje të thirrjeve telefonike”, nuk ka fakt penal dhe, në këto kushte, gabimi në arsyetim në një rast sporadik, edhe sikur të ketë ndodhur, nuk përbën shkelje sipas parashikimeve të ligjit nr. 96/2016.*

9.4. *Lidhur me procedimin penal nr. {***}, regjistruar për veprat penale “mashttrim në dëm të disa personave” dhe “falsifikim i dokumenteve”, kohëzgjatja e hetimeve është diktuar për shkak të kompleksitetit të çështjes dhe dinamikës së veprimeve hetimore.*

9.5. *Lidhur me procedimin penal nr. {***}, regjistruar për veprën penale “dhunë në familje”, kohëzgjatja e hetimeve paraprake, 7 muaj e 22 ditë, është diktuar për shkak të ripyetjes së palëve të përfshira në konfliktin familjar, vendimet dhe kërkesat e paraqitura prej tij janë bazuar në provat e grumbulluara dhe bindjen e brendshme.*

9.6. *Lidhur me procedimin penal nr. {***}, ka marrë vendim mosfillimi duke u bazuar në bindjen e tij të brendshme se në faktet objekt kallëzimi nuk ka pasur elementë të ndonjë vepre penale. Pavarësisht bindjes, ka regjistruar procedimin penal për të kryer veprimet e urdhëruara nga gjykata, të pamundura për t'u kryer, pasi dosja civile ishte për gjykim në Gjykatën e Lartë. Pretendimet në lidhje me dokumentacionin e falsifikuar janë ngritur në gjykimin civil dhe janë rrëzuar nga Gjykata.*

9.7. *Lidhur me procedimin penal nr. {***}, regjistruar për veprën penale “Prodhim dhe shitje të lëndëve narkotike”, ka ushtruar ndjekjen penale bazuar në provat e administruara dhe bindjen*

e brendshme dhe pa asnjë lloj ndikimi. Konkluzionet e Komisionit janë të paragjykuara për shkak të informacionit jo korrekt të dërguar nga Prokuroria për Krime të Rënda dhe nga fakti që ky procedim penal nuk ka përfunduar për më shumë se tre vjet.

9.8. *Lidhur me procedimin penal nr. {***}, regjistruar për veprën penale të “Dhunës në familje”, kohëzgjatja e hetimeve paraprake ka qenë 1 muaj.*

B. Parashtrime të datës 24.07.2023

10. Në parashtrimet e paraqitura përpara seancës gjyqësore në dhomë këshillimi, duke konfirmuar sa argumentuar në ankim, subjekti i rivlerësimit u fokusua kryesisht në pretendimet e përmbledhura si më sipër. Sa i përket kriterit të figurës dhe të aftësive profesionale, subjekti parashtroi pretendime të reja si vijon.

10.1. *Në bazë të kërkesës së tij, nga Prokuroria e Posaçme⁸ është njoftuar se Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me vendimin nr. 109, datë 28.12.2021, ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. {***} të vitit 2019, për të cilin bënte fjalë shkresa e Prokurorisë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, datë 04.10.2019.*

10.2. *Me vendimin nr. 109, datë 28.12.2021, GjKKO-ja ka vendosur pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të organizuar për pushimin e procedimit penal nr. {***} të vitit 2019, regjistruar për veprat penale të “korrupsionit pasiv të gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”. Vendimi i gjykatës është bazuar në germën “a” të nenit 328/1, pra, fakti nuk ekziston, siç parashtrohet në pjesën përshkruese të vendimit: “Nga analiza e vendimmarrjes së Gjykatës, si dhe nga analiza në tërësi e përmbajtjes së përgjimeve telefonike të realizuara, nuk rezulton as një indice apo provë, për të cilën është regjistruar procedimi penal”.*

10.3. *Bazuar në vendimin nr. 109, datë 28.12.2021, të GjKKO-së, ka rënë çdo dyshim i Komisionit, lidhur me procedimin penal nr. {***} të vitit 2017, dyshime të bazuara në informacionet e dërguara nga institucionet ligjzbatuese. Fakti që masa disiplinore nuk është marrë sipas pikës 4, neni 61 të ligjit nr. 84/2016, tregon se Komisioni nuk e ka konsideruar të papërshtatshëm në kuptim të nenit 44, germa “c” të po të njëjtit ligj.*

11. Bashkëlidhur parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit paraqiti dokumente për të cilat kërkoi që të administrohen prej Kolegjit si prova të reja. Në kuptim të neneve 47 dhe 49, pika 2 e ligjit nr. 49/2012⁹, i ndryshuar, deri pesë ditë përpara seancës së shqyrtimit të çështjes, palët kanë të drejtë të paraqesin vetëm parashtrime me shkrim lidhur me shkaqet e ngritura në ankim, por jo prova të reja. Trupi gjykues, nga një vështrim *prima facie*, konstatoi se dokumenti, për të cilin subjekti i rivlerësimit pretendoi se hedh dritë mbi një nga çështjet më të rëndësishme që ka diktuar masën

⁸ Shkresa nr. {***} prot., datë 20.07.2023.

⁹ Ligji nr. 49/2012, në nenin 49, pika 2, parashikon: “[...] Palët kanë të drejtë të paraqesin deri 5 ditë para seancës së shqyrtimit të çështjes parashtrime me shkrim lidhur me shkaqet e ngritura në ankim dhe kundërankim”.

disiplinore të dhënë ndaj tij dhe pasqyron një situatë të ndryshme faktike/juridike nga ajo që ka ekzistuar në momentin e dhënies së vendimit prej Komisionit, ishte i administruar në Kolegj, konkretisht:

11.1. Vendimi nr. 109, datë 28.12.2021, i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (në vijim “GjKKO”), ishte administruar në Kolegj në përgjigje të kërkesave të gjyqtares relatores në funksion të përgatitjes së kësaj çështje për gjykim, dërguar nga kjo gjykatë, si edhe nga Prokuroria e Posaçme¹⁰. Për rrjedhojë, ky vendim i paraqitur nga subjekti me parashtrime do të ishte i panevojshëm për t’u administruar si provë në kuptim të parashikimeve të nenit 49, pika 6, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, por përmbajtja e tij u vlerësua gjithsesi si pjesë e parashtrimeve të paraqitura prej subjektit.

11.2. Shkresa e Prokurorisë së Posaçme, nr. {***} prot., datë 20.07.2023, me të cilën subjektin i është përcjellë vendimi nr. 109, datë 28.12.2021, i GjKKO-së, në përgjigje të kërkesës së tij për informacion lidhur me kallëzime penale apo materiale të tjera procedurale të paraqitura ndaj tij pranë kësaj prokurorie, si dhe për përcaktimin e pozitës procedurale të tij në lidhje me to. Me shkresën sipërcituar, Prokuroria e Posaçme informon lidhur me procedimin penal nr. {***} [përfundimin e hetimeve, paraqitjen e kërkesës për pushimin e tij, vendimin nr. 109, datë 28.12.2021, të GjKKO-së], si dhe për një kallëzimin penal të paraqitur nga një shtetase në datën 07.09.2021, i dërguar, pas verifikimeve, për kompetencë në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Vlorë. Për rrjedhojë, edhe kjo shkresë, e cila jep informacion për fakte që pasqyrohen në vendimin e GjKKO-së, u vlerësua e panevojshme për t’u administruar, në kuptim të parashikimeve të nenit 49, pika 6, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

12. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji, si e vetmja gjykatë e procesit të rivlerësimit, ka juridiksion *ratione materiae* për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, me objekt kundërshtimin e vendimit të Komisionit, i cili ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Saimir Smaka, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.
13. Ankuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë

¹⁰ Fillimisht u adresua kërkesë në Prokurorinë e Posaçme për përditësimin e informacionit për procedimin penal nr. {***}, e pas informacionit se ky procedim penal ishte pushuar me vendim të GjKKO-së, sipas kërkesës së prokurorisë, u kërkuar nga GjKKO-ja dhe Prokuroria e Posaçme përcjellja e vendimit.

Komisionit, brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të këtij të fundit¹¹, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

14. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, përveç rasteve kur trupi gjykues vendos se plotësohen kriteret e nenit 51 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”), për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve.

14.1. Trupi gjykues, në zbatim të parashikimeve të nenit F, pika 3, të Aneksit të Kushtetutës, ku parashikohen kompetencat korigjuese të Kolegjit lidhur me mbledhjen e fakteve/provave apo korigjimin e gabimeve procedurale të Komisionit, duke mbajtur parasysh të drejtat themelore të subjektit të rivlerësuar, fillimisht analizoi pretendimin e subjektit për nxjerrje të konkluzioneve prej Komisionit për kontrollin e figurës, pa i njoftuar paraprakisht asnjë gjetje dhe pa i kaluar barrën e provës, duke mos i dhënë asnjë mundësi për t’u mbrojtur. Nga vendimi objekt shqyrtimi dhe aktet e administruara në fashikuj, trupi gjykues konstatoi si vijon.

14.1.1. Në vendimin e Komisionit, lidhur me kontrollin e figurës, pasqyrohet [...] *Bazuar në informacionet dhe dokumentacionet e klasifikuara, të cilat nuk mund të përdoren në aktet publike apo të vihen në dispozicion të subjektit, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë. Komisioni nuk i ka vënë në dispozicion subjektit të gjithë dokumentacioni i klasifikuar, me përjashtim të atij të përfshirë në një pjesë të rezultateve në lidhje me vlerësimin profesional, duke mbajtur në konsideratë edhe qëndrimin e Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut, në vendimin Regner kundër Republikës Çeke [...]*¹². Gjithashtu, në pjesën “Konstatime të tjera” të vendimit pasqyrohet [...] *Komisioni, nisur nga disa indicie të tjera/indicie nga organet ligjzbatuese, për sa i përket aspektit profesional, të cilat, siç është shpjeguar, janë të klasifikuara dhe nuk mund t’i viheshin në dispozicion subjektit, bazuar edhe në qëndrimin e Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut, në vendimin Regner kundër Republikës Çeke, ka konsideruar të arsyeshme të kryejë hetime të mëtejshme për verifikimin e disa çështjeve gjyqësore penale, duke zgjeruar hetimin në lidhje me aftësitë profesionale të subjektit, duke administruar dhe dosje të tjera përveç 5 dosjeve të përzgjedhura me short në bazë të nenit 41/4 të ligjit nr. 84/2016 [...]*¹³.

14.1.2. Në raportin për rezultatet e hetimit kryesisht të Komisionit, pjesa “B. Kontrolli i figurës”¹⁴, përmbillet [...] *nisur nga informacioni i ardhur nga autoritetet verifikuese, trupi gjykues, bazuar në nenin 38 të ligjit nr. 84/2016, analizoi provat e administruara nga ana e autoriteteve verifikuese.*

¹¹ Sipas kopjes së “Regjistrimit të dorëzimit të objekteve të porositura” të Zyrës Postare Fier Qendër, në datë 3.09.2021 subjekti ka nënshkruar dëftesën postare “Lajmërim për kthim”. Ankimi i tij është administruar në Komision me nr. {***} prot., datë 20.09.2021.

¹² Shih vendimin e Komisionit, faqe 29.

¹³ Shih vendimin e Komisionit, faqe 46.

¹⁴ Shih raportin e Komisionit për rezultatet e hetimit, faqe 25.

Në përfundim të hetimeve, një pjesë e rezultateve të cilat pasqyrohen në raportin profesional, duket se përmbajtja e këtyre materialeve përputhet dhe mbështet informacionin e ardhur nga organet ligjzbatuese [...], pa pasqyruar barrë prove që i kalon subjektit, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016. Në pjesën “Konstatime të tjera” të raportit, pasqyrohet se [...] Komisioni, nisur nga disa indicie të tjera/indicie nga organet ligjzbatuese, për sa i përket aspektit profesional, ka konsideruar të arsyeshme të kryejë hetime të mëtejshme për verifikimin e disa çështjeve gjyqësore penale [...]. Për dosjen e administruar në kuadër të zgjerimit të hetimit për shkaqet e sipërcituara, që i përket procedimit penal nr. {***}, regjistruar për veprën penale “Prodhim dhe shitje të lëndëve narkotike” në ngarkim të të pandehurve E. D. dhe F. K., përfundimet e Komisionit bazohen në të dhënat e administruara nga organet ligjzbatuese dhe gjetjet nga hetimi administrativ dhe subjektit i ka kaluar barra e provës për të provuar të kundërtën e tyre.

14.2. Duke konstatuar se në aktet e sipërcituara, Komisioni nuk referon ndonjë të dhënë lidhur me konstatimet nga dokumentacioni i klasifikuar dhe as në fashikuj nuk ndodhej ndonjë akt për të dëshmuar lidhur me kryerjen e këtij veprimi procedural, sipas parashikimeve të nenit 14, pika 5, germa “ç” e ligjit nr. 84/2016, gjyqtarja relatoe kërkoi informacion nga Komisioni për sa konstatuar lidhur me këtë çështje. Në përgjigje, Komisioni informoi¹⁵ për veprimet e tij verifikuese, të cilat i shërbyen trupit gjykues për vijimin e mëtejshëm të procesit.

14.3. Sa më sipër, në konsideratë edhe të qëndrimit të GjEDNj-së në çështjen *Thanza kundër Shqipërisë*¹⁶, në jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit¹⁷, si dhe në zbatim të parashikimeve të nenit F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, trupi gjykues i Kolegjit, me vendim të ndërmjetëm të datës 27.07.2023, vendosi të njihet drejtpërdrejt me informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, të vënë në dispozicion trupit gjykues të Komisionit dhe Vëzhguesit Ndërkombëtar nga Shërbimi Informativ Shtetëror, në datën 08.05.2021. Për këtë qëllim u ndërpre seanca gjyqësore e datës 27.07.2023 dhe ju bë me dije subjektit të rivlerësimit kryerja e këtij veprimi procedural.

14.4. Pas kryerjes së këtij veprimi procedural në datën 14.09.2023¹⁸, trupi gjykues i Kolegjit analizoi dhe vlerësoi se kufizimi i së drejtës së subjektit për njohjen me këtë informacion, në

¹⁵ Sipas shkresës nr. {***} prot., datë 30.06.2023, se: “Trupi gjykues i Komisionit, pas kërkesës së vëzhguesit ndërkombëtar drejtuar ShISH-it dhe në prezencë të tij, më datë 08.05.2021, ka verifikuar në këtë institucion, informacionet e klasifikuara që kishin të bënin me subjektin e rivlerësimit. Në varësi dhe në analizë të informacioneve dhe problematikave të konstatuara, Komisioni ka arritur në konkluzionet përkatëse në lidhje me kriterin e figurës. Gjithashtu, Komisioni ka kryer hetime të thelluara, rezultatet e të cilave janë pasqyruar në pjesën “Gjetje të tjera” të vendimit nr. 415, datë 07.07.2021, të Komisionit, ku përfshihet edhe komunikimi në formën “pyetje përgjigje” gjatë seancës dëgjimore me subjektin e rivlerësimit. Kjo mënyrë hetimi, tashmë është praktikë e konsoliduar e Komisionit, i cili edhe pas informacioneve të evidentuara në ShISH, ka të drejtë të hetojë, të analizojë dhe të konkludojë në lidhje me kriterin e figurës dhe atë profesional dhe cenimit ose jo të besimit të publikut, në kuadër të zbatimit të ligjit nr. 84/2016, bazuar në informacionet e evidentuara në SHISH, pa qenë i nevojshëm administrimi fizik i dokumenteve të tjera apo edhe rishikimi i raportit fillestar mbi kriterin e figurës nga ana e ShISH, si organ ndihmës në këtë proces”.

¹⁶ Shih <https://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-225653>, vendimi i GjEDNj-së, çështja *Thanza kundër Shqipërisë*, paragrafët 113-123.

¹⁷ Shih vendimet e Kolegjit nr. 7, datë 24.06.2020, nr. 14, datë 14.09.2020 dhe nr. 31, datë 27.07.2022.

¹⁸ Shih procesverbalin e trupit gjykues të Kolegjit, me praninë e vëzhguesit ndërkombëtar dhe punonjëseve shoqëruese të institucionit verifikues, mbajtur në ambientet e këtij institucioni, në datën 14.09.2023.

raport me sigurinë e burimit të tij, ishte i domosdoshëm dhe proporcional. Nga ana tjetër, trupi gjykues vlerësoi se në raportin për rezultatet e hetimit administrativ, megjithëse për kontrollin e figurës gjetjet nuk janë pasqyruar formalisht, Komisioni është shprehur se një pjesë e rezultateve të hetimit për këtë kriter pasqyrohet në raportin profesional. Nga leximi i integruar i pjesëve të raportit, të referuara në pikën 14.1.2 më lart, është evidente ndërlidhja e rezultateve të hetimit administrativ për kontrollin e figurës me ato të vlerësimit të aftësive profesionale referuar procedimit penal nr. {***}, për të cilat subjektit i ka kaluar barra e provës. Gjithashtu, nga shqyrtimi i procesverbalit të seancës dëgjimore në Komision, trupi gjykues i Kolegjit konstatoi se përmes pyetje-përgjigjeve, të cilat do të analizohen në detaje në vijim, Komisioni, jo vetëm ka përcjellë indiciet e përfutuara nga aksesi në dokumentacionin e klasifikuar, por edhe ka thelluar hetimin administrativ, duke i dhënë mundësi subjektit të sqarojë qëndrimin e tij lidhur me sa ka rezultuar nga ky informacion. Në këto kushte, trupi gjykues vlerësoi se mosnjohja e subjektit me të dhënat e plota që pasqyrohen në informacionin e klasifikuar, përderisa ai ka marrë dijeni nga seanca dëgjimore e zhvilluar në Komision, qoftë edhe në mënyrë të tërthortë, mbi rrethanat nga të cilat ka buruar informacioni dhe ka dhënë përgjigje për to sipas nevojave të tij për mbrojtje, nuk ka cenuar thelbin e të drejtave të tij për t'u mbrojtur, sipas vlerësimit të jurisprudencës së GjEDNj-së në çështjen *Regner kundër Republikës Çeke*. Për më tepër, trupi gjykues vlerësoi se ekspozimi i plotë i këtij informacioni do të cenonte paprekshmërinë dhe sigurinë e burimeve të këtij informacioni. Në këtë kuptim, kufizimi i të drejtës së subjektit për t'u njohur me të u vlerësua proporcional dhe në përputhje me garancitë për një proces të rregullt ligjor nën dritën e parashikimeve të KEDNj-së.

14.5. Për sa më sipër, trupi gjykues çmoi se nuk përmbushen kriteret e përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, për kalimin e çështjes për gjykim në seancë gjyqësore publike, dhe vendosi të vijojë me shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit, sipas parashikimeve të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, bazuar në shkaqet e ngritura në ankimin dhe parashtrimet e subjektit të rivlerësimit. Seanca vijuese gjyqësore në dhomë këshillimi u caktua në datën 20.09.2023, ora 10:00 dhe subjekti i rivlerësimit u njoftua për zhvillimin e saj.

B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit që lidhen me aspekte procedurale të procesit të rivlerësimit të kryer nga Komisioni dhe çështje të zbatimit të legjislacionit.

- 15.** Subjekti i rivlerësimit pretendoi për shkelje të nenit 6 të KEDNj-së. Sipas tij, bazuar në analizën e kriterëve të përcaktuara nga GjEDNj-ja në çështjen *Volkov kundër Ukrainës*, gjykata nuk ka qenë e pavarur dhe e paanshme.

15.1. Lidhur me pretendimet për mospërfaqësim thelbësor të gjyqtarëve në Komision se asnjë nga anëtarët e tij nuk ka ardhur nga gjyqësori në momentin e emërimit dhe pavarësisht se atyre u njihet statusi i gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, ata nuk janë gjyqtarë dhe se mandati i kufizuar i organeve të rivlerësimit bën që anëtarët e tyre të jenë jashtëzakonisht të prekshëm duke ndikuar e minuar pavarësinë e tyre, trupi gjykues sjell në vëmendje se Kolegji ka tashmë një qëndrim të konsoliduar, sipas të cilit, në disa vendime të tij ka analizuar dhe vlerësuar pabazueshmërinë e

këtyre pretendimeve përkundrejt garancive të kuadrit kushtetues dhe ligjor të procesit të rivlerësimit, i cili ka kaluar testin e gjykimit kushtetues¹⁹ edhe të GjEDNj-së²⁰. Në qëndrimin e saj, Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar se dispozitat ligjore, mbi të cilat mbështetet krijimi i institucioneve të rivlerësimit, janë në përputhje me Kushtetutën dhe ofrojnë garanci të plota të elementëve të procesit të rregullt gjyqësor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNj-së.

15.2. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se disa nga anëtarët e trupit gjykues në Komision, që shqyrtuan çështjen e tij, nuk përmbushin kriteret e përzgjedhjes së përcaktuar në ligjin nr. 84/2016. Sipas subjektit, ligji nr. 84/2016 parashikon kriteret strikte për përzgjedhjen, por nuk parashikon si do të verifikohen kushtet e zgjedhshmërisë së kandidatëve, si do të verifikohet integriteti i lartë moral apo profesional i tyre, si dhe nuk ka asnjë kontroll për ligjshmërinë e pasurisë së kandidatëve. Për këtë pretendim, subjekti parashtroi se vetë Avokati i Popullit në listën e kandidatëve që nuk plotësojnë kriteret ligjore, përcjellë në Kuvend në mars 2017, ka renditur znj. T. dhe znj. Zh., anëtare të trupës gjyqësore të Komisionit që ka shqyrtuar çështjen e tij.

15.2.1. Trupi gjykues, sjell në vëmendje qëndrimin e mbajtur nga Kolegji²¹, në të njëjtën linjë me GjEDNj-në²², duke i analizuar dhe vlerësuar këto pretendime në disa këndvështrime, nën dritën e garancive procedurale që gëzon subjekti i rivlerësimit, sipas legjislacionit shqiptar dhe jurisprudencës së GjEDNj-së, ndër të tjera, *çështjet Astradsson kundër Islandës dhe B. Cani kundër Shqipërisë*. Konkretisht, në rastin e trajtimit të pretendimeve analoge, Kolegji ka vlerësuar si vijon:

[...] trupi gjykues i Kolegjit çmon të theksojë natyrën e jashtëzakonshme të procesit të rivlerësimit dhe qëllimin e legjislatorit që, në kontekstin e një vlerësimi kalimtar, përzgjedhja e anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit t'i nënshtrohej disa procedurave të mirëpërcaktuara. Mbi bazën e këtyre parimeve edhe përzgjedhja e anëtarëve të institucioneve pasqyroi vullnetin politik të përfaqësuar të shoqërisë shqiptare. Në zbatim të këtij qëllimi, ligji nr. 84/2016, mbi bazën e të cilit është kryer përzgjedhja e anëtarëve të institucioneve, përcakton në detaj dhe çdo hap që do të duhet t'i paraprinte emërimin fundor të tyre. Me fjalë të tjera, qëllimi i legjislatorit, për të krijuar një infrastrukturë të aftë për të kryer procesin, është shoqëruar me garanci që përjashtojnë kontestimin e mandateve të anëtarëve të institucioneve, që nëse do t'i lihej rastësisë do të sfidonte qëllimin dhe natyrën e jashtëzakonshme, kalimtare dhe me afat të përcaktuar të procesit të rivlerësimit. Së fundmi, në këtë analizë të gjithanshme të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues mban në konsideratë balancën që duhet të mbahet në funksion të sigurisë ligjore dhe kohës që ka kaluar nga momenti i krijimit të institucioneve të rivlerësimit, përfshirë edhe

¹⁹ Shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 2/2017 dhe nr. 78/2017, mbështetur në Opinionin {***} të Komisionit të Venecias.

²⁰ GjEDNj-ja në çështjen Altina Xhoxhaj k. Shqipërisë, paragrafët 295-300.

²¹ Shih vendimet e Kolegjit (JR) nr. 43, datë 15.11.2022, subjekti i rivlerësimit H. M., (JR) nr. 3, datë 06.02.2023, subjekti i rivlerësimit T. H.

²² Shih vendimet e GjEDNj-së, çështja Altina Xhoxhaj kundër Shqipërisë, paragrafët 66-73; çështja Besnik Cani kundër Shqipërisë, paragrafët 66-73, çështja Sevdari kundër Shqipërisë, paragrafi 109; çështja Admir Thanza kundër Shqipërisë, paragrafët 83- 84.

Komisionin. Nën dritën e efektit negativ që do të kishte kontestimi pa afat mbi bazën e pretendimeve për gjykatë të krijuar me ligj, sipas testit të vendosur nga GjEDNj-ja²³, trupi gjykues i Kolegjit çmon të theksojë peshën me të cilën shoqërohet siguria ligjore me kalimin e kohës kundrejt të drejtave individuale të subjektit të rivlerësimit. Këto të drejta, në rrethanat konkrete, pa përsëritur sa është shtjelluar më sipër, konsiderohen të adresuara nga kontrolli i gjithanshëm i vendimit të Komisionit, kryer në Kolegj [...].

15.3. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se vetë Kushtetuta që parashikon shprehimisht që parimi i pavarësisë dhe paanësisë nuk zbatohet plotësisht për anëtarët e KPK-së dhe KPA-së është një parashikim i paprecedent. Sipas tij ka një argument që vërteton pakundërshtueshmërisht se KPK-ja dhe KPA-ja nuk janë të pavarura: neni A i Aneksit të Kushtetutës thekson se [...] në masën e nevojshme për të kryer rivlerësimin, diapazoni i zbatimit të disa neneve të kësaj Kushtetute janë kufizuar pjesërisht në përputhje me nenin 17 të Kushtetutës [...] midis të tjerave në procesin e rivlerësimit mund të kufizohet neni 145/1 i Kushtetutës që thotë se gjyqtarët dhe prokurorët janë të pavarur dhe i nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve.

15.3.1. Trupi gjykues i Kolegjit çmon të theksojë se normat kushtetuese dhe ligjore që garantojnë pavarësinë e organeve të rivlerësimit janë vlerësuar nga Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 2/2017, e cila shprehet se [...] Gjykata, duke bërë një interpretim sistematik të dispozitave të ligjit të kundërshtuar, nga konteksti i tyre, si dhe nisur nga kuptimi i përgjithshëm i këtij ligji, vlerëson se qëllimi i tyre është përcaktimi i rregullave që do të ndiqen gjatë procesit të rivlerësimit nga organet kushtetuese të pavarura, të cilat janë të vetmet organe që kanë kompetencën për të realizuar kontrollin e pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit, si dhe kriteret dhe mënyra e realizimit të këtij procesi. [...]. Gjithashtu, edhe GjEDNj-ja ka mbajtur qëndrim, duke vlerësuar të pabazuara pretendimet lidhur me pavarësinë e organeve të rivlerësimit, për sa subjektet e rivlerësimit që i kanë ngritur ato nuk kanë kontestuar paanësinë subjektive të anëtarëve të organeve të rivlerësimit²⁴. Për rrjedhojë, pretendimet e subjektit, lidhur me kuadrin kushtetues dhe ligjor të rivlerësimit kalimtar, proces me natyrë të jashtëzakonshme dhe qëllim rikthimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, vlerësohen tërësisht të pabazuara.

15.4. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se në të gjithë procedurën e ndjekur dhe në vendimin objekt ankimi ka elementë të theksuar të paragjykimit, të një vendimi të paracaktuar, duke vepruar nën doza të larta paragjykimi dhe në shkelje të parimit të prezumimit të pafajësisë dhe, për pasojë, ai nuk është gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Parashtrimet e subjektit për këtë pretendim analizohen si vijon.

15.4.1. Subjekti pretendoi se Komisioni nuk i ka vënë në dispozicion një nga “provat” më të rëndësishme tek e cila janë mbështetur pothuaj të gjithë konkluzionet, shkresën e lëshuar nga organet ligjzbatuese. Trupi gjykues, nga shqyrtimi i akteve në fashikuj, konstaton si vijon.

²³ <https://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-206582>, paragrafi 221.

²⁴ Shih vendimin e GjEDNj-së, çështja Xhoxhaj kundër Shqipërisë, paragrafin 296 e vijues.

15.4.2. Prokuroria e Përgjithshme, në përgjigje të kërkesës së Komisionit²⁵, me shkresën nr. {***} prot., datë 5.03.2020, ka përcjellë të gjithë informacionin për subjektin e rivlerësimit Saimir Smaka të kësaj prokurorie dhe atë të ardhur nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe Prokuroritë pranë gjykatave të rretheve gjyqësore me juridiksion të përgjithshëm. Prokuroria e Posaçme²⁶ ka informuar se [...] nga aktet e ardhura për kompetencë lëndore, rezulton se Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, mbi bazën e akteve të referuar nga Shërbimet e Policisë Gjyqësore të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, në datën 28.09.2018, ka regjistruar procedimin penal nr. {***}, për kryerjen e veprës penale “Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, “Korrupsioni pasiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, parashikuar nga nenet 319 dhe 319/ç të K. Penale. Nga të dhënat e grumbulluara nga Agjencitë ligjzbatuese në vend, si dhe nga shërbimet e Policisë Gjyqësore të Policisë së Shtetit, ka indicie për përfshirje të prokurorit Saimir Smaka, me detyrë Prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë në veprën penale “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, parashikuar nga neni 319/ç i K. Penal, fakt për të cilin hetimet vazhdojnë. Ju bëjmë me dije se emri i shtetasit Saimir Smaka nuk është regjistruar në regjistrin e njoftimeve të veprave penale [...].

15.4.3. Prokuroria e Posaçme²⁷, në përgjigje të kërkesës së Komisionit, ka informuar se informacionet e ardhura në ish-Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda²⁸ janë administruar në kuadër të procedimit penal nr. {***} të regjistruar nga kjo prokurori dhe të kaluar për kompetencë në Prokurorinë e Posaçme në datën 18.12.2019, ku ky procedim penal është regjistruar me nr. {***}, datë 20.12.2019, i cili është në fazë hetimi dhe nuk ka emra të regjistruar. Lidhur me dokumentacionin e kërkuar për këto informacione, Prokuroria e Posaçme ka informuar se nuk mund t’i dërgojë, pasi nuk është institucioni që i ka prodhuar ato dhe Komisioni mund t’i drejtohet institucioneve ligjzbatuese, të cilat i kanë prodhuar këto informacione.

15.4.4. Në raportin për rezultatet e hetimit administrativ, si për kontrollin e figurës, ashtu edhe për vlerësimin e aftësive profesionale, Komisioni shprehet se rezultatet e hetimit janë bazuar në të dhënat e organeve ligjzbatuese. Pas njohjes me raportin e rezultateve të hetimit administrativ, në

²⁵ Komisioni, me shkresën nr. {***} prot., datë 27.01.2020, ka kërkuar nga Prokuroria e Përgjithshme informacion lidhur me subjektin e rivlerësimit Saimir Smaka, ndër të tjera nëse ka të dhëna nga agjencitë ligjzbatuese për veprime që cenojnë figurën e subjektit të rivlerësimit, të dhëna për kontakte të tij me persona të papërshtatshëm, kopje të fashikujve të procedimeve penale të mosfilluara, të pushuara apo të pezulluara ku përmendet emri i tij.

²⁶ Shkresa nr. {***} prot., datë 04.02.2020, e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, administruar në Prokurorinë e Përgjithshme me nr. {***} prot., datë 06.02.2020.

²⁷ Shkresa nr. {***} prot., datë 26.05.2021, e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, administruar në Komision me nr. {***} prot., datë 27.05.2021.

²⁸ Komisioni në shkresën me nr. {***} prot., datë 18.05.2021, drejtuar Prokurorisë së Posaçme, shprehet se nga ana Prokuroria e Përgjithshme është informuar se për subjektin e rivlerësimit Saimir Smaka janë dërguar katër informacione nga agjencitë ligjzbatuese, me nr. {***} prot., datë 12.09.2018, nr. {***}, datë 17.09.2018, nr. {***}, datë 26.09.2018 dhe nr. {***}, datë 12.11.2018. Komisioni ka kërkuar vënien në dispozicion të këtyre informacioneve dhe dokumentacionit, të përcjella për kompetencë e trajtim pranë Prokurorisë së Posaçme.

ushtrim të të drejtave të tij, subjekti i rivlerësimit është njohur me materialet në dosjet e Komisionit, ka marrë dokumentacionin për të cilin ka pasur interes, në formë elektronike apo shkresore²⁹, pa shfaqur asnjë vërejtje apo pretendim. Në parashtrimet për raportin e rezultateve të hetimit administrativ dhe barrën e provës së kaluar, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, përcjellë në Komision më datë 01.07.2021, subjekti i rivlerësimit Saimir Smaka nuk ka paraqitur pretendime apo kërkesa lidhur me dokumentacionin e vënë në dispozicion prej Komisionit. Gjithashtu, në seancë dëgjimore, i pyetur nëse i ka marrë në dorëzim materialet e dosjes së vënë në dispozicion nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit është përgjigjur [...] *po të nderuar jam njohur dhe i kam parë në detajet më të imta [...] dhe për pyetjen vijuese nëse ka kërkesa paraprake është përgjigjur se nuk ka të tilla.* Në këto kushte, rezulton se subjekti i rivlerësimit është njohur dhe ka marrë në dorëzim të gjitha aktet e administruara nga Komisioni përgjatë hetimit administrativ, përveç dokumentacionit të klasifikuar si sekret shtetëror, i cili mbrohet nga ligji nr. 8457, datë 11.02.1999, “Për Informacionin e Klasifikuar “Sekret Shtetëror””, në përputhje me parashikimet e nenit 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenit 46 të ligjit nr. 44/2015, Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.

15.5. Subjekti i rivlerësimit Saimir Smaka pretendoi se në anshmërinë e Komisionit ka ndikuar përfshirja e tij në procedurën e rivlerësimit në bazë të një liste të propozuar nga ONM-ja, hartuar mbi bazë të kritereve të panjohura, ndërkohë që ligji nuk i njuh të drejtën Komisionit të miratojë rregulla për radhën e përparësisë, të ndryshme nga ato që vetë ligji parashikon. Fakti që ONM-ja, organ me kompetenca shumë të gjera dhe ndikuese mbi anëtarët e institucioneve të rivlerësimit, përfshirë edhe sferën e procedurave disiplinore ndaj tyre, ka kërkuar përfshirjen me përparësi në procesin e rivlerësimit të një numri të caktuar subjektësh, ku përfshihet edhe ai, pa short, mbi bazën e kritereve të panjohura, krijon premisa për paragjykim dhe anshmëri të trupës gjyquese, pretendoi subjekti

15.5.1. Trupi gjyqësor i Kolegjit, konstaton se në vendimin nr. 1, datë 18.11.2019, të trupit gjyqësor të Komisionit, me rend dite caktimin e kryesuesit, relatorit dhe deklarinimit të interesit, pasqyrohet [...] *Referuar mbledhjes së KPK-së për hedhjen e shortit për subjektet e listës së përparësive për shkak të ligjit[...].* Përpos që subjekti i rivlerësimit nuk referon të dhëna që do të identifikonin listën e përpiluar nga ONM-ja apo aktin e Komisionit me të cilin, sipas tij, janë miratuar rregullat për radhën e përparësisë, në fashikujt e tij nuk konstatohet ndonjë komunikim mes ONM-së dhe Komisionit në drejtim të procesit të rivlerësimit të tij. Gjithashtu, në faqen zyrtare të Komisionit, rezulton i publikuar njoftimi për fillimin e procedurave të rivlerësimit për 48 subjekte, sipas shortit të datës 12.11.2019, pas miratimit të listës me vendim nr. 59, datë 07.11.2019, të Komisionit. Subjekti i rivlerësimit Saimir Smaka³⁰, në këtë listë, renditet me numër

²⁹ Në përmbajtje të deklaratës të nënshkruar prej subjektit në datë 30.06.2021, evidentohet si vijon [...] *pasi u njoha me dokumentacionin fizik dhe në formë elektronike (CD) të dosjeve të hetimit administrativ të zhvilluar nga Komisioni, deklaroj se [...] u njoha dhe mora të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga ana ime në CD apo në formë shkresore (fotokopje) sipas kërkesës sime. Deklaroj se nuk kam asnjë vërejtje në lidhje me dokumentacionin/materialet e tërhequra pranë Komisionit. Ky dokumentacion është konform me dokumentacionin e dosjeve që mu vunë në dispozicion [...].*

³⁰ Shih <https://kpk.al/njoftim-143/11/>

rendor 7. Sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit nuk konstaton fakte mbi të cilat mund të mbështet pretendimi i ngritur nga subjekti se është përfshirë në procesin e rivlerësimit mbi bazën e kriterëve të panjohura dhe pa short.

15.5.2. Lidhur me pretendimin për ndikim të ONM-së mbi anëtarët e institucioneve të rivlerësimit, për shkak të rolit në fazën e përzgjedhjes dhe emërimit, rolit vendimtar gjatë procesit të *vetting*-ut, dhe, për më tepër, të kompetencave në sferën e procedurave disiplinore ndaj anëtarëve të organeve të rivlerësimit, trupi gjykues çmon të sjellë në vëmendje qëndrimin e mbajtur nga Kolegji se [...] *të drejtën për nisjen e procedimit disiplinor për anëtarët e institucioneve të rivlerësimit nuk e kanë vëzhguesit ndërkombëtarë ekskluzivisht. Sipas nenit 17, pika 1, gjerat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016, çdo anëtar i institucioneve të rivlerësimit ka të drejtë të kërkojë fillimin e hetimit disiplinor për të barabartët e vet. Për më tepër, sipas përcaktimeve në vijim të së njëjtës dispozitë, janë gjyqtarët e Kolegjit të Posaçëm të Apelit ata që kanë tagrin përfundimtar vendimmarrës për procedurën disiplinore. Në këto kushte, nëse do të pranohej argumenti i përfaqësuesit ligjor për ndikim potencial serioz ndaj pavarësisë së komisionerëve, nën dritën e ligjit, hipotetikisht, ky ndikim do të duhej t’i atribuohet Kolegjit të Posaçëm të Apelit, dhe jo vëzhguesve ndërkombëtarë [...]*³¹. Për rrjedhojë, ky pretendim i ngritur edhe nga subjekti i rivlerësimit Saimir Smaka vlerësohet i pabazuar në fakte dhe ligj.

15.6. Trupi gjykues i Kolegjit, nga shqyrtimi i akteve në fashikuj, nuk konstaton që subjekti i rivlerësimit të ketë paraqitur në Komision ndonjë pretendim për procedurat e ndjekura për nisjen e procesit të rivlerësimit, për përbërjen e trupit gjykues të Komisionit apo që të ketë kërkuar sqarime lidhur me rezultatet e hetimit për kontrollin e figurës, për të cilat në raport Komisioni shprehet se një pjesë e tyre pasqyrohen në raportin profesional. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar mungesën e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues, por rezulton që nuk ka dhënë shpjegime për të gjitha problematikat, për të cilat Komisioni i ka ngarkuar barrën e provës. Për një pjesë të tyre ka dhënë shpjegime vetëm në seancë dëgjimore. Me këtë qëndrim, në mospërbushje të detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, lidhur me barrën e provës dhe modalitetet e formën e përmbysjes së saj, sipas përcaktimeve të bëra nga Komisioni në raportin e hetimeve paraprake duke ushtruar në mënyrë të kufizuar sipas vullnetit e tij të drejtën për t’u mbrojtur e dëgjuar, subjekti e zhvlerëson pretendimin e tij për paragjykim të procesit të rivlerësimit dhe për vendim të paracaktuar.

15.7. Në përmbledhje, në kushtet kur asnjë e dhënë në aktet e administruara dhe as në parashtrimet e subjektit nuk tregojnë qoftë edhe indicie të anshmërisë, pretendimet e subjektit për tendenciozitet, paragjykim apo paracaktim të vendimit vlerësohen nga trupi gjykues të pambështetura në fakte dhe si një përpjekje me synimin e delegjitimitimit të procesit të kryer në kontekstin e themelit, duke ngritur shkaqe ankimi mbi rrethana që, jo vetëm nuk konstatohen se ekzistojnë, por anashkalojnë konkluzionet e Komisionit për to.

16. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se në shkelje të nenit 6 të KEDNj-së nuk është dëgjuar drejtësisht, në kundërshtim me parimin e kontradiktoritetit dhe të barazisë së armëve, pasi Komisioni ka vendosur ndaj tij një barrë prove të paarsyeshme, jo proporcionale, jo objektive, në kundërshtim me parashikimet e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, nenet 52 dhe 62 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenit

³¹ *Shih vendimin e Kolegjit nr. 11/2022 (JR), që i përket subjektit të rivlerësimit E. I.*

87 të ligjit nr. 44/2015. Në themel të vendimit janë vendosur fakte dhe shkaqe për të cilat nuk i ka kaluar barra e provës, pretendoi subjekti.

16.1. Lidhur me këtë pretendim, subjekti parashtroi se Komisioni ka detyrimin ligjor të kalojë barrën e provës për çdo gjetje, që sipas vlerësimit të tij përbën mospërmbushje të detyrimit ligjor nga ana e subjektit dhe ka si sanksion disiplinor marrjen e një mase administrative, duhet t'i komunikojë drejtpërdrejt subjektit nëse elementët e konstatuar mund të çojnë drejt prezumimit të vendosjes së masës disiplinore të shkarkimit apo ndonjë mase tjetër dhe pavarësisht konstatimeve për çdo pasuri, Komisioni në përmbledhje të gjithë konstatimeve, duhet të përcaktojë qartë bazën ligjore të pretenduar të shkelur.

16.1.1. Nga analizimi i raportit për rezultatet e hetimit administrativ kryesisht, trupi gjykues konstaton se janë pasqyruar të gjithë provat e administruara, shpjegimet e subjektit, si dhe janë pasqyruar qartë konstatimet, për të cilat, në bazë të parashikimeve të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës, përfshirë edhe rezultatet për kontrollin të figurës, për të cilin do të analizohet gjerësisht në këtë vendim. Dispozitat e kuadrit ligjor të rivlerësimit nuk parashikojnë detyrimin që Komisioni, në këtë akt procedural të shprehen literalisht lidhur me prezumimin e masës disiplinore, për më tepër, subjektet e rivlerësimit, me formimin e tyre profesional, kanë aftësitë për të vlerësuar peshën e konstatimit në raport me parashikimet e ligjit nr. 84/2016 për aplikim të masës disiplinore parashikuar nga po i njëjti ligj, kjo edhe në referim të parashikimeve të nenit 87 të ligjit nr. 44/2015. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit vlerësohet i pabazuar.

16.2. Subjekti i rivlerësimit parashtroi se në rezultatet e hetimit administrativ dhe në vendim, Komisioni nuk ka arritur në përfundimin se pasuria e tij është më e madhe se dyfishi i asaj të ligjshme ose pasaktësitë në deklaram kanë pasur qëllim fshehjen e pasurive dhe, në këto kushte, ai nuk kishte detyrimin për barrë prove në kuptim të nenit D, pika 4 dhe nenit C, pika 5 të Aneksit të Kushtetutës.

16.2.1. Trupi gjykues sjell në vëmendje që ky argument i paraqitur edhe nga subjekti i rivlerësimit Saimir Smaka ka gjetur trajtim gjerësisht në jurisprudencën e Kolegjit³². Në analizë të argumenteve të ngritura nga subjekte të tjerë rivlerësimi, Kolegji ka theksuar se pika 1 e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 përcakton rrethana faktike dhe ligjore - kur subjekti i rivlerësimit ka deklaruar më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme gjatë vlerësimit të pasurisë, përfshirë edhe personat e lidhur me të - të cilat janë autonome nga rrethanat e tjera që normohen nga ky nen, në të cilat organet e rivlerësimit pa ushtruar diskrecion zbatojnë masën disiplinore të shkarkimit nga detyra. Nga ana tjetër, deklarimi i pamjaftueshëm i pasurisë, sipas ligjit, konstatohet nën dritën e përcaktimeve kushtetuese të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Kjo dispozitë parashikon detyrimin për subjektin e rivlerësimit që të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Në përmbushje të këtij detyrimi kushtetues, pika 2, neni 52 i ligjit nr. 84/2016

³² *Shih vendime të Kolegjit, nr. 1/2021 (JR) që i përket subjektit të rivlerësimit A. S., nr. 26/2020 (JR), që i përket subjektit të rivlerësimit Ç. Shahini dhe nr. 23/2022 (JR) që i përket subjektit të rivlerësimit A. Sh..*

parashikon detyrimin e subjektit të rivlerësimit që në përgjigje të barrës së provës të paraqesë prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e përfundimeve të arritura nga organet e rivlerësimit, Komisionit në këtë rast. Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se pretendimet e subjektit, lidhur me barrën e provës së kaluar prej Komisionit, janë të pabazuara.

16.3. Duke referuar në opinionin e Komisionit të Venecias³³, lidhur me zbatimin në procedimin disiplinor të parimit procedural penal të parashikueshmërisë së shkeljeve ligjore, subjekti i rivlerësimit parashit se procesi i rivlerësimit kalimtar është një proces disiplinor dhe parimet e procedimit disiplinor, të parashikuara në nenin 100 të ligjit nr. 96/2016, si parimi i prezumimit të pafajësisë dhe parimi i dyshimit në favor të magjistratit flasin për parime të një procesi penal. Referuar parashikimeve kushtetuese, nenet 175 dhe 42 të Kushtetutës, e drejta për një proces të rregullt ligjor nuk mund të kufizohet as në procesin e jashtëzakonshëm të rivlerësimit.

16.3.1. Trupi gjykues, së pari vlerëson të theksojë se në procesin e rivlerësimit kalimtar shkarkimi i prokurorit nga detyra është një sanksion kushtetues me natyrë disiplinore dhe jo penale. Parimet, rregullat dhe metodologjia në të cilat bazohet ky proces normohen në detaje nga ligji nr. 84/2016. Kuadri kushtetues dhe ligjor i procesit të rivlerësimit përcakton detyrimin e organeve të rivlerësimit, në këtë rast Komisionit, t'i kalojnë barrën e provës subjektit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit për situata që ngarkojnë subjektin me përgjegjësi. Qëndrimi i Komisionit, lidhur me kualifikimin ligjor të kriterit përkatës apo vlerësimit tërësor të çështjes, është ai që deklarohet si i tillë në vendimin që përmbyll procedurën administrative, ndaj të cilit subjekti i rivlerësimit ka të drejtën e ankimit pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

16.3.2. Nga ana tjetër, trupi gjykues sjell në vëmendje se referuar qëndrimin të GjEDNj-së³⁴, koncepti “akuzë penale” ka një kuptim “autonom” të pavarur prej kategorizimeve të përdorura nga sistemet juridike kombëtare dhe koncepti “akuzë” përkufizohet si njoftim zyrtar nga organi kompetent i një individi, që mendohet se ka kryer një vepër penale, e që varet, gjithashtu, nga ekzistenca ose jo e pasojave të rëndësishme në situatën e të dyshuarit³⁵. Gjithashtu, në kuptim të nenit 6 të KEDNj-së, për t’u marrë në konsideratë e për të përcaktuar nëse gjendemi përballë një akuze penale, shqyrtimi mbështet në kriteret e parashikuara nga GjEDNj-ja: cilësimi i veprës, natyra e veprës dhe ashpërsia e dënimit³⁶. Konsideruar se procesi i rivlerësimit ka natyrë disiplinore, rregullohet nga Kushtetuta, ligji nr. 84/2016 dhe, sipas rastit, ligjet nr. 44/2015 dhe nr. 96/2016, në përfundim të së cilit mund të jepet si masë shkarkimi nga detyra, sanksion karakteristik i një shkelje disiplinore, fakti se kjo masë është me natyrë të përhershme është i pamjaftueshëm për ta konsideruar atë si ndëshkim penal. Gjithashtu, fakti që në të ardhmen një veprim ose një

³³ Subjekti referon në opinionin nr. 789, datë 15.12.2014, të Komisionit të Venecias (*Amicus Curia për Gjykatën Kushtetuese të Moldavisë*): “63. Nisur nga ngjashmëria midis procedimit disiplinor të gjyqtarëve dhe procedimit penal, parimi procedural penal i parashikueshmërisë së shkeljeve ligjore dhe të interpretimit të tyre të ngushtë (moslejimi i interpretimit me analogji), zbatohet mutadis mutandis edhe në procedimin disiplinor”.

³⁴ Referojuni vendimit të GjEDNj-së, çështja *Adolf kundër Austrisë*, paragrafi 30.

³⁵ Referojuni vendimeve të GjEDNj-së, çështja *Deweer kundër Belgjikës*, paragrafi 42, *Eckle kundër Gjermanisë*, paragrafi 73.

³⁶ Referojuni vendimeve të GjEDNj-së, çështjet *Engel me të tjerë kundër Vendeve të Ulëta*; paragrafët 82-83; *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*.

mosveprim mund të çojë potencialisht edhe në një sanksion penal, nuk mund të shërbejë si pretendim për aplikim të parimeve të procedimit penal në procesin e rivlerësimit me natyrë të qartë administrative. Për rrjedhojë, pretendimet e subjektit të rivlerësimit gjenden të pabazuara.

16.4. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se, në kundërshtim me parimet që normojnë procesin e rregullt ligjor për kontrollin e figurës, Komisioni ka nxjerrë konkluzione që përbëjnë shkak shkarkimi pa i njoftuar me rezultatet e hetimit asnjë gjetje, pa i kaluar barrën e provës, pa i bërë prezent provat ku është mbështetur ky konkluzion, duke mos i dhënë asnjë mundësi për t'u mbrojtur.

16.4.1. Lidhur me pretendimet për njoftimin e rezultateve të hetimit për kontrollin e figurës, trupi gjykues ka analizuar gjerësisht më lart, në pikën 14 të këtij vendimi. Në seancë dëgjimore, lidhur me kriterin e figurës, subjekti i rivlerësimit është njoftuar me shpjegimin [...] *ndërsa në lidhje me anën e figurës, unë e lexova dhe në mënyrë të detajuar raportin, konstatoj që si nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme dhe nga ana e DSKI-së dhe nga ShKB-ja, pra, në të gjitha këto institucione që vlerësojnë figurën, kanë konstatuar që subjekti është i përshtatshëm [...]*³⁷. Nga ana tjetër, trupi gjykues konstaton se për rezultatet e hetimit të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, për të cilat Komisioni në raport shprehet se janë të bazuara edhe në të dhënat e administruara nga organet ligjzbatuese, subjektit i janë drejtuar pyetje të drejtpërdrejta në seancë dëgjimore nga Komisioni dhe vëzhguesi ndërkombëtar. Ndër të tjera, subjekti është pyetur nëse ka kontaktuar ndonjëherë, edhe për efekt të hetimeve, me të afërm të të pandehurve dhe çfarë masash ka marrë për të dokumentuar takimet. Nga procesverbali i seancës dëgjimore, trupi gjykues konstaton se subjekti është shprehur se [...] *unë jam shumë i sigurt kush është ai person që qëndron mbrapa këtij denoncimi nuk dua ta bëj publik këtu [...] po asnjë kontakt [...]*, duke dëshmuar se për të nuk ishte i panjohur dokumentacioni dhe rrethanat faktike për të cilat Komisioni po thellonte hetimin përmes pyetje-përgjigjeve. Sa i përket takimeve, të cilësuar prej tij *institucionale* dhe të përshkruara [...] *në të dyja rastet kanë ardhur nën të subjekteve, i ka pritur në zyrë dhe i ka thënë që do të shkojë çështja në gjyq, brenda afateve do merrni masën dhe llojin e dënimit që parashikon Kodi dhe pa rënduar pozitën e tyre [...]*, është pyetur se si prokuror, për takimin në zyrë me prindërit e dy të pandehurve nën hetim, a ka pasur një person të tretë, a është mbajtur një procesverbal dhe si e provon bisedën e zhvilluar me ata. Subjekti, me shpjegimet e tij, ka devijuar nga dhënia e përgjigjes konkrete dhe, pas disa pyetjeve, lidhur me dokumentimin e takimit ka pohuar se [...] *është mbajtur regjistri te recepsioni [...] dhe pyetjes vijuese [...] nëse këto zonjat, prindërit, do të vinin vetëm tek ju dhe ai babai apo nëna do të nxirrnin një zarf me X mijë euro si do të mbroheshit [...]*, *cilat janë masat që keni marrë ju për të ruajtur dinjitetin dhe integritetin tuaj [...]*, subjekti i rivlerësimit është përgjigjur se [...] *në lidhje me momentet se si referoheshin e zgjidheshin këto raste, siç e thashë e vetmja provë shkresore është fakti që kanë shkruar atje tek recepsioni, kaq, tjetër s'kemi [...]*. Ndërkohë që kishte deklaruar [...] *ajo erdhi për herë të dytë [...]*, i pyetur se cila nga nënat e të pandehurve ka shkruar për ta takuar për herë të dytë, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se [...] *nuk e mban mend në mënyrë absolute se ka kaluar shumë kohë*

³⁷ Shih faqen 28 të procesverbalit të seancës dëgjimore, paragrafi 2-të.

[...] se janë vetëm dy takime [...] detyra e tij është që personave t'u tregojë që çështja është dërguar për gjykim apo është nën hetim dhe që të marrin drejtësi nga organet kompetente dhe kaq [...]. Përgjigjet kontradiktore të subjektit, të cilat kanë variuar nga mohimi e më pas në pohim të takimeve me familjarë të të pandehurve nën hetim prej tij, si dhe dështimi për të provuar lidhur me qëllimin e takimeve dhe zhvillimin e tyre, dëshmojnë synimin për të devijuar nga dhënia e shpjegimeve për rrethana faktike, të cilat, më së paku, dëshmojnë për ushtrim të detyrës në mungesë të theksuar transparence dhe jo që subjekti gjendej në vështirësi të realizimit të mbrojtjes për shkak të mosnjohjes me informacionin e klasifikuar, siç ai pretendon.

16.4.2. Trupi gjykues konstaton se lidhur me vlerësimin e kriterit profesional, subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e tij në përgjigje të rezultateve të hetimit, nuk ka dhënë shpjegime për të gjitha çështjet për të cilat i ka kaluar barra e provës. I pyetur nga trupi gjykues, lidhur me këtë qëndrim, subjekti është shprehur se [...] ka bërë parashtrimet me shkrim në lidhje me çështjen e shtetasve A. S. dhe F. M. që ishin dy denoncimet e fundit fare, sepse konstatoj që në lidhje me aspektin profesional Prokuroria e Përgjithshme apo KLP-ja konstatoi që në tërësi ato janë pozitive, vetëm që kapen me elementë proceduralë të njoftimit apo zgjatje [...]. Në seancën dëgjimore, ku ka zgjedhur të japë shpjegimet e tij për barrën e provës, subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur ndonjë pretendim për arsyet apo indiciet për të cilat Komisioni po thellonte hetimin administrativ, duke adresuar pyetje në drejtim të kontakteve të tij me familjarë të të pandehurve të një çështjeje të hetuar prej tij, ndërkohë që natyra dhe përmbajtja e pyetjeve dëshmonte se Komisioni kishte informacion përtej dokumentacionit të administruar në dosje lidhur me këto kontakte. Ky qëndrim dëshmon se subjekti nuk është surprizuar për shkaqet për të cilat hetimi administrativ po thellohej, por dhe se ka qenë i qartë për kufizimin e njohjes me dokumentacionin e klasifikuar, sipas parashikimeve ligjore që rregullojnë procedurën administrative³⁸.

16.4.3. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se zgjerimi i hetimit administrativ në bazë të informacionit nga organet ligjzbatuese për përfshirje të subjektit në veprime korruptive, dokument me të cilin subjekti ishte njohur³⁹, sikurse edhe thellimi i hetimit administrativ gjatë seancës dëgjimore për këtë çështje, dëshmojnë se subjektit i janë komunikuar qartë rrethanat faktike për të

³⁸ Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, në nenin 46 të titulluar “Kufizimi i së drejtës së palëve për njohje me dosjen” parashikon: “E drejta e palëve, sipas nenit 45, të këtij Kodi, kufizohet vetëm në ato raste dhe në atë masë që parashikohet nga legjislacioni në fuqi”.

³⁹ Në raportin për rezultatet e hetimit administrativ, në pjesën “Konstatime të tjera” [fq.41], Komisioni shprehet: “Komisioni, nisur nga disa indicie të tjera/ indicie nga organet ligjzbatuese, për sa i përket aspektit profesional, ka konsideruar të arsyeshme të kryejë hetime të mëtejshme për verifikimin e disa çështjeve gjyqësore penale duke zgjeruar hetimin në lidhje me aftësitë profesionale të subjektit duke administruar edhe dosje të tjera përveç 5 dosjeve të përzgjedhura me short në bazë të nenit 41/4 të ligjit nr. 84/2016. Komisioni ka kërkuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, fashikujt e dosjeve në ngarkim të të pandehurve Sh. B., si dhe E. D. e F. K.. Me shkresën nr. {***}, datë 18.05.2021, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka dërguar pranë Komisionit, kopje të këtyre dosjeve. Me shkresën nr. {***}, datë 01.06.2021, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë ka dërguar pranë Komisionit, dosjen gjyqësore të procedimit penal nr. {***}, viti 2017, në ngarkim të të pandehurve E. D. dhe F. K.. Nga shqyrtimi i dosjes, Komisioni vëren se [...]”. Me deklaratën e datës 30.06.2021, subjekti i rivlerësimit Saimir Smaka deklaroi se është njohur dhe ka marrë të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga ana e tij në CD dhe/apo formë shkresore (fotokopje), sipas kërkesës së tij, dhe se nuk ka asnjë vërejtje në lidhje me dokumentacionin/materialet e tërhequra pranë Komisionit.

cilat Komisioni i kishte kaluar barrën e provës se *dukej se kishte favorizuar një shtetas si rezultat i caktimit të një mase më të butë dënimi*. Për sa më sipëranalizuar, trupi gjykues nuk gjen argument që të mbështesë pretendimin e subjektit se nuk i është njoftuar asnjë gjetje dhe se me rezultat e hetimit nuk i janë bërë prezent provat ku janë mbështetur konkluzionet e Komisionit. Trupi gjykues vlerëson se mosnjohja me informacionin e klasifikuar nuk mund të zhbëjë faktin se gjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka qenë i mirëinformuar për rrethana faktike të rezultuara nga ky informacion. Për takimet e zhvilluara në zyrën e tij me nënat e të pandehurve nën hetim, pyetjet kanë ndërlidhur të dhënat e informacionit të klasifikuar me faktet për të cilat është pyetur, duke i bërë me dije subjektit tërësinë e rrethanave relevante dhe duke i krijuar mundësinë të ndërtojë mbrojtjen e tij në mënyrë efektive, në respektim të parimit të kontradiktorialitetit dhe barazisë së armëve. Për rrjedhojë, pretendimet e subjektit vlerësohen prej trupit gjykues të pabazuara.

16.5. Lidhur me pretendimin se informacioni dhe dokumentacioni i administruar nga organet e inteligjencës nuk mund të përdoret nga Komisioni, dhe se përdorimi i tij përbën shkelje të rëndë, trupi gjykues sjell në vëmendje se neni 45 i ligjit nr. 84/2016 parashikon që organet e rivlerësimit dhe vëzhguesit ndërkombëtarë hetojnë dhe vlerësojnë të gjithë faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit dhe për këtë qëllim një dispozitë e veçantë e ligjit, neni 50 i tij, parashikon për mundësi të gjera aksesi në informacion, pa asnjë kufizim. Njohja me dokumentacionin e klasifikuar, i papërdorshëm në aktet publike, i shërben organeve të rivlerësimit për të thelluar hetimin dhe krijuar bindjen e brendshme për rrethana faktike të çështjes objekt shqyrtimi. Në këtë situatë ligjore dhe faktike, pretendimi i subjektit për shkelje procedurale nga Komisioni vlerësohet nga trupi gjykues si përpjekje në vazhden e pretendimeve të tjera të tij për të delegjitimuar procesin në Komision, për rrjedhojë, i pabazuar.

16.6. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se *çështja Regner kundër Republikës Çeke* e shqyrtuar nga GjEDNj-ja, në të cilën është bazuar Komisioni në arsyetimin për kufizimin e së drejtës së tij për njohje me dokumentacionin e klasifikuar, nuk ka relevancë në rastin e tij. Subjekti parashitroi se *ligji nr. 84/2016 dhe Aneksi i Kushtetutës nuk i ka dhënë kompetencë organeve të rivlerësimit të marrin në shqyrtim arsyet e klasifikimit të informacionit, të shfuqizojnë këtë vendim, t'i vënë në dispozicion subjektit dokumentet pavarësisht vendimmarrjes së autoritetit që ka vendosur klasifikimin e tij*. Sipas subjektit, *në çështjen Regner kundër Republikës Çeke: (i)* flitet për prova të siguruara në mënyrë të ligjshme nga organe kompetente, të cilat madje mund t'i vihen në një moment të caktuar në dispozicion subjektit, mbi bazë të vendimit të Gjykatës; *(ii)* edhe sikur e dhëna të jetë siguruar nga një organ kompetent apo në mënyrë procedurale të ligjshme, në mënyrë që të vendosen në themel të vendimit, duhet të plotësohen disa garanci minimale për një proces të rregullt ligjor. Si të tilla, sipas subjektit, renditen: aksesi i pakufizuar i gjykatës në të gjithë dokumentet e klasifikuara në të cilat autoriteti është mbështetur për dhënien e vendimit; kompetenca për kryerjen e ekzaminimit të hollësishëm të arsyeve të paraqitura prej autoritetit për moszbulimin e dokumenteve të klasifikuara dhe të urdhërojnë vënien në dispozicion të subjektit të atyre dokumenteve që konsiderojnë se nuk përmbushin kushtet për klasifikim; autorizimi për të vlerësuar thelbin e vendimit të autoritetit që revokon lejen e sigurisë dhe për të anuluar, kur është e nevojshme një vendim arbitrar të autoritetit; juridiksioni i gjykatave që shqyrtojnë çështjen të

përfshijë të gjitha faktet dhe të mos jetë i kufizuar në shqyrtimin e arsyeve të mbështetura nga kërkuesi; kërkuesi të dëgjohet nga gjyqtarët dhe të jetë në gjendje të bëjë parashtrime me shkrim mbi vendimin e autoritetit që heq lejen e sigurisë.

16.6.1. Trupi gjykues, në përgjigje të këtyre pretendimeve, çmon të sjellë në vëmendje se bazuar në parashikimet e ligjit nr. 84/2016, anëtarët e organeve të rivlerësimit në funksion të vendimmarrjes kanë akses dhe mund të verifikojnë dhe studiojnë dokumente të klasifikuara, por sipas parashikimeve të kuadrit ligjor që rregullon veprimtarinë e organeve ligjzbatuese që i disponojnë ato pa ekspozuar burimin dhe pa përdorur këto dokumente në aktet publike⁴⁰. Në këtë situatë, përshtypja e parë e krijuar për mosrespektimin plotësisht të parimit të kontradiktoritetit dhe, për rrjedhojë, dyshimi mbi respektimin e procesit të rregullt ligjor janë zgjidhur në favor të prevalimit të një interesi madhor publik - nëpërmjet ruajtjes së konfidencialitetit të informacioneve të klasifikuara - duke u pranuar dhe duke u konsideruar i ligjshëm kufizimi i pjesshëm i të drejtave të palëve për t'u njohur me provat dhe përgatitjen e mbrojtjes së tyre. Ky parim është i materializuar edhe në ligjin nr. 84/2016, ku lidhur me procedurat për kontrollin e figurës, në nenin 39 përcakton *se informacioni nuk bëhet publik nëse ai rrezikon sigurinë e burimit [...]*.

16.6.2. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, nenit 38, pika 1, ku sanksionohet se *kontrolli i figurës zhvillohet bazuar në prova të sakta, në informacione konfidenciale, si dhe informacione të tjera të disponueshme*, si dhe të nenit 49, pika 4, ku sanksionohet se *Komisioni dhe Kolegji i Apelimit e bazojnë vendimin e tyre vetëm në dokumentet nga burime të njohura, në prova të besueshme ose që janë në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera. Ata kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo indicie në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes, të lexuara në harmoni mes tyre, dëshmojnë që ligjvënësi për kontrollin e figurës nuk kërkon ekzistencën e provave përtej çdo dyshimi, por ka zgjeruar gamën e elementeve të përdorshme nga organet e rivlerësimit, mbi të cilat, përtej çdo dyshimi mund të bëhet vlerësimi mbi përshtatshmërinë ose jo të subjektit të rivlerësimit. Për sa më sipëranalizuar, bazuar edhe në vendimin e GjEDNj-së në *çështjen Regner kundër Republikës Çeke*, ku është vlerësuar se [...] *e drejta për zbulimin e provave përkatëse nuk është një e drejtë absolute. Në çështje penale ka gjetur se mund të ketë interesa konkurruese, siç është siguria kombëtare ose nevoja për të mbrojtur dëshmitarët në rrezik të hakmarrjes ose të mbajë sekret metodat e policisë për hetimin e krimit, të cilat duhet të vlerësohen kundrejt të drejtave të palës në gjykim[...]*, pretendimet e subjektit se në çështjen e tij nuk ka relevancë vendimi i GjEDNj-së sipërcituar vlerësohen prej trupit gjykues të pabazuara.*

16.7. Trupi gjykues i Kolegjit, për sa analizuar më lart në këtë vendim, vlerëson se Komisioni pavarësisht se nuk ka vënë në dispozicion të subjektit dokumentacionet e klasifikuara, të cilat nuk mund të përdoren në aktet publike⁴¹, i është përmbajtur parimit të kontradiktoritetit dhe barazisë

⁴⁰ Ligji nr. 8391, datë 28.10.1998, "Për shërbimin informativ kombëtar", i ndryshuar, në nenin 10, parashikon: "Shërbimi Informativ Kombëtar përjashtohet nga detyrimet që kërkojnë publikimin e metodave të punës dhe të burimeve të informacionit, të informacionit të klasifikuar, të strukturave, të funksioneve, të emrave, të titujve zyrtarë, të pagave e të numrit të personelit".

⁴¹ Ligji nr. 8457/1999 "Për informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror", në nenin 2 të titulluar "Përkufizime" parashikon: "Sekret shtetëror" do të thotë informacion i klasifikuar sipas këtij ligji, ekspozimi i paautorizuar i të cilit

së armëve. Konkretisht, bazuar në informacionin e organeve ligjzbatuese se ka indicie për përfshirjen e subjektit të rivlerësimit në veprën penale “korrupsion pasiv të gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, parashikuar nga neni 319/ç i Kodit të Penal, ka bërë pjesë të hetimit administrativ dosjet gjyqësore penale, me të cilat subjekti është njohur, i ka kaluar subjektit barrën e provës për gjetjet lidhur me to dhe ka thelluar hetimin administrativ në seancë gjyqësore, duke ofruar garanci për sa ka rezultuar e mundur, që subjekti i rivlerësimit të mbrojtë interesat e tij. Nga ana tjetër, trupi gjykues mban në konsideratë faktin se, pasi është njohur me rezultatet e hetimit administrativ kryesisht, me të cilat i ka kaluar barra e provës, subjekti i rivlerësimit në parashtrime nuk ka dhënë shpjegime, duke zgjedhur të heqë dorë nga një mbrojtje efektive në këtë moment procedural shumë të rëndësishëm për realizimin e mbrojtjes dhe në seancë dëgjimore ka dhënë deklarime vetëm pas pyetjeve të Komisionit, duke mohuar e më pas pohuar për fakte të rëndësishme e më peshë për çështjen në shqyrtim, duke dështuar në këtë mënyrë të përmbysë barrën e provës. Sa më sipëranalizuar, pretendimi se vendimi i Komisionit është jologjik, për sa mbështetet në dokumente dhe informacione që nuk mund të përdoren në aktet publike, vlerësohet prej trupit gjykues i pakuptimtë dhe si përpjekje për të zhvendosur fokusin nga përfundimet e Komisionit.

16.8. Në konsideratë të qëndrimit të GjEDNj-së [...] gjykatat ushtronin siç duhet kompetencat e kontrollit në dispozicion të tyre në këtë proces, si në lidhje me nevojën për të ruajtur konfidencialitetin e dokumenteve të klasifikuara, ashtu dhe në lidhje me arsyetimin e vendimit duke dhënë arsye për vendimet e tyre në lidhje me rrethanat specifike të çështjes[...]. Duke pasur parasysh gjykimin në tërësi, natyrën e mosmarrëveshjes dhe marzhin e vlerësimit që gëzojnë autoritetet e brendshme, kufizimet që veprojnë mbi gëzimin e të drejtave të kërkuarit, të dhëna atij në pajtim me parimet e gjykimin bazuar në parimet e kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve, u kompensuan në mënyrë të tillë që ekuilibri i drejtë midis palëve të mos ndikohej në atë masë sa të cenonte vetë thelbin e së drejtës së ankuesit për një gjykim të drejtë [...]”⁴², me këtë bazë të dhënash dhe nivel aksesit mbi informacionin e klasifikuar, mbështetur në të drejtën e gjykatës për të vlerësuar të dhënat e klasifikuara, Kolegji analizoi dhe vlerësoi këto të dhëna mbështetur në parimet e ligjshmërisë dhe objektivitetit, pa cenuar ato të drejta të subjektit që prekin thelbin e një procesi të rregullt ligjor.

17. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se është shkelur neni 8 i KEDNj-së për shkak të moszbatimit të parimit të proporcionalitetit. Sipas subjektit, ligji nr. 84/2016 nuk përmban rregulla për të siguruar zbatimin e parimit të proporcionalitetit në rastet e dhënies së masës disiplinore të shkarkimit nga detyra dhe shkarkimi i tij nga detyra është joproporcional me qëllimin e ndjekur dhe konkluzionet në të cilat është bazuar.

mund të rrezikojë sigurimin kombëtar. “Informacion” do të thotë çdo njohuri që mund të komunikohet apo të dokumentohet, pavarësisht nga forma dhe që është nën kontrollin e shtetit. “Institucion” do të thotë një institucion shtetëror apo çdo zyrë tjetër brenda këtyre institucioneve, që vihet në zotërim të një informacioni të klasifikuar. “Kontroll” do të thotë e drejta e autoritetit nga buron informacioni i klasifikuar apo zotëruesit e tij, për ta mbrojtur nga çdo e drejtë njohjeje e paautorizuar”; dhe në nenin 4 të titulluar “Autoriteti klasifikues” parashikon “Informacioni që përbën sekret shtetëror klasifikohet nga një autoritet i klasifikimit origjinal. Ai zotërohet e prodhohet për interesa të shtetit dhe është nën kontrollin e tij”.

⁴² Shih vendimin e GjEDNj-së, çështja Regner kundër Republikës Çeke, paragrafët 154, 161.

17.1. Në konsideratë të qëndrimit të Kolegjit në çështje të tjera⁴³, ku është analizuar se proporcionaliteti është një pjesë e tërësisë së parimeve nga të cilat udhëhiqen institucionet e rivlerësimit dhe nuk mund të gjejë zbatim si parim i veçantë dhe i vetëm i rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se Komisioni ka konkluduar për probleme për të tria kriteret e rivlerësimit. Në këtë situatë faktike dhe ligjore, trupi gjykues e vlerëson të tejkaluar pretendimin e subjektit se shkarkimi i tij nga detyra është *jo proporcional me qëllimin e ndjekur dhe konkluzionet në të cilat është bazuar*.

17.2. Lidhur me pretendimin e subjektit se me masën disiplinore të shkarkimit nga detyra ka humbur të gjitha mundësitë për punësim, që përkojnë me kualifikimin dhe eksperiencën e tij profesionale, nuk mund të ushtrojë gjithë jetën profesionin e gjyqtarit apo prokurorit, nuk mund të aplikojë për një pozicion pune në administratë publike⁴⁴, nuk mund të jetë noter apo ekspert i pavarur apo të marrë titullin e avokatit⁴⁵, sillet në vëmendje se pretendime të tilla janë trajtuar gjerësisht prej Kolegjit në jurisprudencën e tij⁴⁶, në të njëjtën linjë me qëndrimin e mbajtur nga GjEDNj-ja në çështjen *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*⁴⁷, duke vlerësuar se, për sa shkarkimi nga detyra ka ardhur si pasojë e shkeljeve të konstatuara gjatë procesit të rivlerësimit, nuk ka shkelje të nenit 8 të KEDNj-së.

18. Në përmbledhje të sa më sipëranalizuar, në konsideratë edhe të jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese⁴⁸ dhe GjEDNj-së⁴⁹, lidhur me parimet e procesit të rregullt ligjor, specifikisht për parimin e kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve, për rëndësinë e veçantë që merr krijimi i mundësive të arsyeshme për të paraqitur provat dhe vlerësimet ligjore të lidhura me çështjen që shqyrtohet, trupi gjykues i Kolegjit konstaton që pretendimet e subjektit se Komisioni ka cenuar parimet e procesit të rregullt nuk qëndrojnë. Nga aktet në fashikull, rezulton se Komisioni, duke e njohur subjektin e rivlerësimit Saimir Smaka me të gjitha faktet kundrejt të cilave analizohej veprimtaria e tij profesionale, i ka dhënë atij mundësinë të ushtrojë të gjitha të drejtat e tij për proces të rregullt. Për rrjedhojë, trupi gjykues i vlerëson pretendimet e tij të pabazuara.

⁴³ Shih vendimet e Kolegjit nr. 2/2020, datë 27.02.2020; nr. 20/2020, datë 08.09.2020 dhe nr. 36/2020, datë 16.12.2020.

⁴⁴ Subjekti referon parashikimet e nenit 21 të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar.

⁴⁵ Subjekti referon parashikimet e germës "f", neni 13, i ligjit nr. 55/2018 "Për profesionin e avokatit".

⁴⁶ Shih vendimin e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 23, datë 28.06.2022

⁴⁷ Shih vendimin e GjEDNj-së, çështja *Xhoxhaj kundër Shqipërisë* ku Gjykata ka mbajtur qëndrim: "[...] Ndalimi i përjetshëm i vendosur ndaj kërkueses dhe individëve të tjerë të shkarkuar, për shkak të shkeljeve të rënda etike nuk është në kundërshtim ose në raport të zhdrejtë me objektivin legjitim të ndjekur nga Shteti për të siguruar integritetin e detyrës gjyqësore dhe besimin e publikut në sistemin e drejtësisë (shih, *mutatis mutandis*, *Naidin kundër Rumanisë*, nr. {***}, 21 tetor 2014, paragrafi 54–55, që kishte të bënte me natyrën absolute të ndalimit të një ish-bashkëpunëtori të policisë politike për t'u punësuar në shërbimin publik; për kontrast, *Sidabras dhe Džiautas kundër Lituaniës*, nr. {***} dhe {***}, paragrafi 58, *Gjykata 2004 VIII; Rainys dhe Gasparavičius kundër Lituaniës*, nr. {***} dhe {***}, paragrafi 36, 7 prill 2005; dhe *Žičkus kundër Lituaniës*, nr. {***}, paragrafi 31, 7 prill 2009, në lidhje me kufizimet e një personi për të gjetur punë në sektorin privat). Kjo është veçanërisht e tillë në kontekstin kombëtar të konsolidimit të vazhdueshëm të shtetit të së drejtës. Duke pasur parasysh shkaqet e mësipërme, Gjykata vlerëson se nuk ka pasur shkelje të nenit 8 të Konventës në lidhje me shkarkimin nga detyra të kërkueses".

⁴⁸ Shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 21, datë 16.04.2015; nr. 34, datë 29.05.2015; nr. 37, datë 30.06.2016, etj.

⁴⁹ Shih vendimet e GjEDNj-së, çështjet *Ruiz-Mateos kundër Spanjës*; *McMichael kundër Mbretërisë së Bashkuar*; *Vermeulen kundër Belgjikës*; *Lobo Machado kundër Portugalisë*; *Kress kundër Francës*, etj.

C. Shkaqet e ankimit që lidhen me kriterin e pasurisë

19. Lidhur me rivlerësimin e pasurisë, subjekti i rivlerësimit pretendon se konkluzionet e Komisionit janë të gabuara si rrjedhojë e vlerësimit jo të drejtë dhe të paanshëm të shpjegimeve dhe provave të depozituara prej tij, por edhe të provave të administruara nga vetë Komisioni.

*Pasuria llogari rrjedhëse nr. {***}, vlerë 365.403 lekë, pjesë takuese: 100% dhe pasuria llogari rrjedhëse, depozitë nr. {***}, në shumën 1.000.080.33 lekë, pjesë takuese: 100%*

20. Këto dy pasuri të deklaruara në deklaratën *vetting* janë analizuar më vete në vendimin objekt shqyrtimi. Duke vlerësuar ndërlidhjen mes këtyre pasurive, burimit të krijimit të tyre, duke qenë se nga llogaria rrjedhëse nr. {***} është krijuar llogaria rrjedhëse [depozitë] nr. {***}, në datën 24.8.2015, si dhe faktit se pretendimet e subjektit lidhur me ligjshmërinë e burimit të krijimit të tyre janë të njëjta, arsyetimi i trupit gjykues do të vijojë me shtjellimin e përmbledhur të tyre për të evituar përsëritjen.

21. Lidhur me llogarinë rrjedhëse nr. {***}, me vlerë 365.403 lekë, Komisioni konkludon se:

21.i. Subjekti i rivlerësimit *ka bërë deklaram të pasaktë*, duke ndryshuar deklaramet e tij në lidhje me burimin e krijimit të shumës së depozitave prej 1.719.000 lekësh: në procesverbalin e ILDKPKI-së në datën 20.11.2015 deklaroi të ardhura nga dhënia e tokës bujqësore me qira dhe gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni kursimet personale nga paga.

21.ii. Duke marrë në konsideratë deklaramin e subjektit të rivlerësimit në ILDKPKI në vitin 2015 se si burim për krijimin e depozitave kanë shërbyer të ardhurat nga dhënia me qira e tokës bujqësore në vitet 2014-2015, për shumën totale 80.000 lekë, si dhe faktin se nuk ka deklaruar burim krijimi të kësaj depozite as në DIPP dhe as në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pamjaftueshëm, duke rezultuar me mungesë të plotë burimesh të ligjshme financiare për krijimin e depozitës në shumën 1.719.000 lekë.

22. Lidhur me llogarinë rrjedhëse, depozitë nr. {***} në shumën 1.000.000 lekë, Komisioni konkludon se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë, duke mosdeklaruar burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj depozite, si dhe nuk arriti të provonte burimin e ligjshëm të krijimit të saj.

23. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi konkluzionet e Komisionit, duke pretenduar se përgjigjet në procesverbalin e ILDKPKI-së në vitin 2015 dhe deklaramet gjatë hetimit administrativ janë keqinterpretuar në mënyrën më të keqe të mundshme, në disfavor të tij. Subjekti pretendoi se për depozitimet bankare, deklarimi i tij në ILDKPKI nuk ka përjashtuar të ardhura të tjera të tij apo të familjarëve, me të cilët ka jetuar në ekonomi të përbashkët familjare. Analiza financiare për të ardhurat e të gjithë anëtarëve të familjes, të cilat rezultojnë 220.000 lekë në muaj, provon mundësinë financiare për krijimin e pasurive me burime të ligjshme. Lidhur me pasurinë llogari rrjedhëse, depozitë në shumën 1.000.000 lekë, subjekti pretendon se mosdeklarami i burimit të krijimit të saj nuk është bërë me qëllim fshehjen e pasurisë.

24. Trupi gjykues i Kolegjit, nga analizimi i akteve në fashikuj dhe pretendimeve të subjektit në ankim dhe parashtrime, konstaton dhe vlerëson si vijon.

○ *Lidhur me llogarinë rrjedhëse nr. {***} në vlerën 365.403 lekë, pjesë takuese 100%*

24.1. Subjekti i rivlerësimit nuk ka *deklaruar* në deklaratën *vetting* burimin e krijimit të kësaj pasurie. Kjo llogari është hapur më 06.11.2007⁵⁰ dhe nuk është deklaruar prej subjektit në deklaratën e pasurisë para fillimit të detyrës së vitit 2013 dhe në deklaratat e pasurisë të viteve 2013 dhe 2014.

24.2. Nga dokumentacioni i “Raiffeisen Bank”⁵¹ për periudhën 22.08.2014-02.10.2015⁵² rezulton se subjekti i rivlerësimit ka depozituar në këtë llogari shumën 1.719.000 lekë. Referuar procesverbalit datë 20.11.2015, të mbajtur para inspektorit pranë ILDKPKI-së, i pyetur për burimin e shumave të derdhura në këtë llogari gjatë vitit 2014, subjekti ka shpjeguar se kanë si burim të ardhurat që babai i tij ka marrë nga qiratë e tokave bujqësore që ka përfituar me ligjin nr. 7501, të cilat ia ka lënë atij për t’u administruar, pasi vetë është i sëmurë me KEMP. Gjatë vitit 2015, një pjesë e likuiditeteve në bankë janë përdorur së bashku dhe me një kredi të marrë në vlerën 300.000 lekë.

24.3. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *vetting*: AMTP-të e datave 29.08.1995 dhe 31.07.1995, në emër, përkatësisht, të babait të tij Z. S. dhe nënës S. S.; certifikatat familjare të datave 01.08.1991, 01.10.1992 dhe 17.12.2014; si dhe certifikatën e pronësisë së tokës, datë 07.05.2015, në emër të babait.

○ *Lidhur me të ardhurat nga dhëna me qira e tokave bujqësore*

24.4. Subjekti i rivlerësimit nuk i ka deklaruar qiratë nga tokat bujqësore në deklaratat e interesave private periodike. Në pyetësin nr. 1, subjekti është pyetur nga Komisioni nëse ka përfituar të ardhura nga qiraja apo të ardhura të tjera dhe nëse janë paguar detyrimet tatimore për to. Në përgjigje, subjekti ka shpjeguar se që nga momenti që ka filluar detyrën si prokuror nuk ka marrë vlera të tjera qiraje në emrin e tij.

24.5. Në përgjigje të pyetësit nr. 2, subjekti ka deklaruar *për periudhën 2013-2015 është lidhur një kontratë (marrëveshje me shkrim) mes nënës së tij dhe shtetasit Sh. M., ku ky i fundit ka paguar qira në këstet 30.000 lekë për vitin 2014 dhe 50.000 lekë për vitin 2015. Këtë marrëdhënie nuk e*

⁵⁰ Në llogarinë rrjedhëse me nr. {***}, nga viti 2011 është kredituar bursa nga Shkolla e Magjistraturës, kurse nga dhjetori i vitit 2013 janë kredituar pagat si prokuror. Në këtë llogari janë disbursuar edhe kreditë bankare të marra nga subjekti i rivlerësimit, konkretisht: disbursuar më 10.08.2015, kredi në shumën 312.000 lekë; më 11.01.2016, kredi në shumën 53.000 lekë; më 19.07.2016, kredi në shumën 239.700 lekë; më 08.06.2018, kredi në shumën 300.000 lekë [llogaria është konfirmuar nga “Raiffeisen Bank” me vërtetimin nr. {***} prot., datë 26.1.2017].

⁵¹ Shkresa nr. {***} prot., datë 29.01.2020, e “Raiffeisen Bank”.

⁵² Subjekti i rivlerësimit ka kryer depozitime bankare në këtë llogari si vijon: datë 22.08.2014 vlerën 74.000 lekë; datë 01.09.2014 vlerën 134.000 lekë; datë 24.10.2014 vlerën 511.000 lekë; datë 06.01.2015 vlerën 146.000 lekë; datë 23.01.2015 vlerën 104.000 lekë; datë 20.02.2015 vlerën 90.000 lekë; datë 08.05.2015 vlerën 350.000 lekë; datë 11.08.2015 vlerën 210.000 lekë; datë 02.10.2015 vlerën 100.000 lekë.

ka deklaruar në DIPP-të 2016, 2017, për këto arsye: (1) kontrata (marrëveshje me shkrim për dhënie me qira tokë bujqësore) nuk ka karakter formal, publik pasi është lidhur me shkresë të thjeshtë; (2) prona nuk është certifikuar, pasi zona ku ajo shtrihet fshati {***}, Njësia Administrative {***}, Bashkia Fier nuk është azhurnuar plotësisht. (3) AMTP-ja është në emër të nënës së tij S. S., çka do të thotë se ajo është titullare e ligjshme e kësaj pasurie të paluajtshme dhe se në këto kushte, duke pasur parasysh karakteristikat e tokës bujqësore dhe familjes bujqësore nuk mund ta deklaronte si pasuri apo pjesën takuese në të. Për shumën prej 760.013 lekësh, ka shpjeguar se janë kursime nga paga e tij, shpërblimet e punës apo dieta, duke sqaruar se të gjithë anëtarët e familjes kishin të ardhura [babai me KEMP, nëna në marrëdhënie pune pranë Drejtorisë Arsimore Rajonale Fier, subjekti prokuror dhe vëllai inxhinier, specialist, shef zyre në OST], kështu që kishte mundësi nëpërmjet kursimeve të tij të bënte derdhje të menjëhershme dhe të njëpasnjëshme pranë “Raiffeisen Bank”. Bashkë me pyetësin nr. 2, subjekti ka paraqitur dokumentacion për të provuar sa deklaruar prej tij⁵³.

24.6. Në parashtrimet për rezultatet e hetimit administrativ dhe gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime për barrën e provës lidhur me: (i) mosdeklarimin e llogarisë bankare dhe gjendjes së saj në deklaratat e pasurisë të viteve 2013-2014, si dhe burimit të ligjshëm të vlerave monetare të depozitimeve bankare, përkatësisht 719.000 lekë në vitin 2014 dhe 854.000 lekë në vitin 2015; (ii) deklaratimet kontradiktore lidhur me burimin e depozitimeve bankare të kryera në periudhën 24.08.2014-02.10.2015, në shumën 1.719.000 lekë, pasi në procesverbalin e ILDKPKI-së deklaroi burim të tyre të ardhura nga qiraja e tokës bujqësore, kurse në pyetësor deklaroi kursimet e tij personale.

24.7. Lidhur me barrën e provës për mos deklarimin e marrëdhënies së qirasë dhe të ardhurat e përfituara në deklaratat e pasurisë të viteve 2013 - 2016, dhe mos kryerjen e pagesës së tatimit për të ardhurat nga qiraja për vitet 2014 - 2015 në kohën e përfitimit të këtyre të ardhurave, por kryerjen e saj më datë 06.05.2021, pas depozitimit të deklaratës vetting, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se në vlerësojmë se ndërmjet palëve [nënës së tij S. S. dhe shtetasit Sh. M.] është lidhur një marrëveshje verbale, dhe se neni 826 i Kodit Civil kërkon regjistrimin e kontratave të qirasë së tokave bujqësore që janë lidhur me afat mbi 9 vjet. Për shkak të afatit më të shkurtër, forma e kontratës mund të bëhet me shkresë të thjeshtë. Gjithashtu, ka shpjeguar se të ardhurat nga qiraja

⁵³ Subjekti ka depozituar: (i) marrëveshje qiraje datë 04.01.2013, mes palëve qiradhënës S. S. dhe qiramarrës Sh. M., për dhënie me qira të pasurisë tokë arë me sip. 3900 m², e ndodhur në Sh., {***}, me afat 3-vjeçar. Vlera e qirasë do të jetë 30.000 lekë/vit dhe me nënshkrimin e saj është paguar shuma prej 50.000 lekësh për periudhën 12-mujore deri më 31.12.2015; (ii) deklaratën individuale vjetore të të ardhurave (DIVA) për vitin 2014 për znj. S. S., deklaruar më 05.05.2021. Të ardhurat bruto vjetore nga qiraja në shumën 30.000 lekë; (iii) urdhërpagesë për tatimin mbi të ardhurat individuale për vitin 2014, në shumën 16,419 lekë, gjeneruar nga sistemi tatimor më 06.05.2021; (iv) mandatpagesë në “Credins Bank” datë 06.05.2021, për shumën 16.719 lekë; (v) DIVA për vitin 2015 për znj. S. S., deklaruar në datën 05.05.2021; të ardhurat bruto vjetore nga qiraja në shumën 50.000 lekë; (vi) urdhërpagesë për tatimin mbi të ardhurat individuale për vitin 2015, në shumën 9.777 lekë, gjeneruar nga sistemi tatimor më 06.05.2021; (vii) mandatpagesë datë 06.05.2021, për shumën 10.077 lekë, në “Credins Bank”; (viii) vërtetim nr. {***}, datë 05.05.2021, nga Njësia Administrative L. Fier dhe librezën e taksave dhe tarifave vendore, sipas së cilave znj. S. S. ka paguar taksat e tokës për periudhën 2011-2021.

janë derdhur në llogarinë e tij rrjedhëse, *depozitë nr. {***}*, duke mos fshehur të ardhurat e ligjshme që burojnë nga kjo marrëdhënie juridike, dhe se i ka shlyer të gjithë taksat për tokat bujqësore.

24.8. Lidhur me barrën e provës se nuk justifikon me burime të ligjshme financiare depozitimin e shumave cash në total prej 1.719.000 lekësh, pasi nga analiza financiare mbi të ardhurat personale, duket se rezulton me balancë negative prej 943.338 lekësh; të ardhurat nga qiraja e tokës në shumën 80.000 lekë për vitet 2014 – 2015, duket se nuk janë të mjaftueshme për të justifikuar këto depozitime cash, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se formalisht dhe potencialisht ka pasur mundësi të krijonte kursime, për shkak se nuk ka pasur detyrime familjare [status beqar], të gjithë anëtarët e familjes së tij kanë pasur të ardhura, si dhe nuk ka pasur as automjet personal.

24.9. Në seancën dëgjimore, subjektit i është kërkuar të japë një vlerësim përfundimtar për burimin e të ardhurave për depozitimet bankare prej 1.719.000 lekësh, për sa në ILDKPKI ka shpjeguar se janë të ardhurat nga qiraja e tokave bujqësore në total 80.000 lekë, shifër dukshëm larg vlerës së shumës së depozituar dhe në pyetësor se janë nga kursimet e tij personale duke marrë për bazë rrogat e një viti e dy muaj punë dhe shpenzimet e jetesës, shifra përsëri mbetet dukshëm larg vlerës së shumës së depozituar. Në përgjigje, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar mundësitë financiare të tij dhe të familjarëve dhe ka potencuar që, jo vetëm formalisht, por edhe potencialisht t'i kursente ato para.

○ Lidhur me llogarinë rrjedhëse, *depozitë nr. {***}*, në shumën 1.000.080.33 lekë, pjesë takuese: 100%

24.10. Në deklaratën *vetting*, subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj depozite të hapur më 1.12.2015⁵⁴. Kjo llogari është deklaruar prej subjektit në DIPP-të e viteve 2015 dhe 2016, por nuk është deklaruar burimi i krijimit të saj.

24.11. Në parashtrimet për rezultatet e hetimit, subjekti ka shpjeguar se shuma në këtë depozitë është transferuar nga llogaria e pagës pranë “Raiffeisen Bank”, dhe se gjatë kësaj kohe ka kursyer nga paga e tij shpërblyer apo dietat e punës. Në kushtet kur të ardhurat *neto* për të gjithë anëtarët e familjes rezultojnë rreth 220.000 lekë/muaj, ai ka pasur mundësi objektive që të rrisë kursimet vetjake. Subjekti ka shpjeguar se gjatë kësaj periudhe kohe nuk ka qëndruar në Vlorë, pavarësisht se ka marrë banesë me qira, lëvizjet vajtje-ardhje i bënte me mjete të transportit publik (furgon), bileta e udhëtimit ka qenë në vlerën 200 lekë. Automjetin e parë e ka blerë në gusht të vitit 2015⁵⁵. Subjekti ka potencuar se një pjesë të këtyre të ardhurave janë siguruar edhe nga kursimet ndër vite të prindërve të tij, të cilët kanë qenë për herë në marrëdhënie të rregullta pune prej vitit 1993 e në vazhdim.

24.12. Trupi gjykues, së pari vlerëson se mosdeklarimi në deklaratën *vetting* i burimit të krijimit të llogarisë rrjedhëse nr. {***} dhe llogarisë rrjedhëse, depozitë nr. {***}, vjen në kundërshtim

⁵⁴ Sipas vërtetimit nr. {***}, datë 26.01.2017, të “Raiffeisen Bank”, llogaria është hapur sipas kontratës së depozitës nr. {***}, me afat 12-mujor, për vlerën 1.000.000 lekë.

⁵⁵ Subjekti ka depozituar vërtetimet e pagës bruto të tij dhe personave të lidhur [babai, nëna, vëllai] për periudhën 2013-2016.

me kuadrin kushtetues dhe ligjor të procesit të rivlerësimit, i cili sanksionon se *subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të ardhurave*. Ky detyrim është qartësuar në detaje në shtojcën 2 të ligjit nr. 84/2016 “Deklaratë e pasurisë”, ku sa i përket deklarimit të pasurive, në ndihmë të subjekteve të rivlerësimit jepet informacioni: “*Objekt i deklarimit: Të gjitha pasuritë e akumuluar ndër vite deri në ditën e dorëzimit të deklaratës së pasurisë, sipas nenit 3, pika 11, të ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, burimet e krijimit të tyre dhe të drejtat reale mbi to, të ndodhura brenda dhe jashtë vendit, të cilat ndodhen në pronësi, në posedim ose në përdorim nga subjekti i rivlerësimit apo në bashkëpronësi të tij me bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en, fëmijët në moshë madhore dhe/ose persona të tjerë të lidhur*”. Gjithashtu, Udhëzimi i ILDKPKI-së⁵⁶ dalë në bazë e për zbatim të ligjit nr. 84/2016, në pikën 1 parashikon: “*Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, deklarojnë të dhënat e detyrueshme për deklarim, pjesë përbërëse e këtij procesi deklarimi, me përshkrimet e kërkuara, sipas shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016, datë 30.08.2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*”.

24.13. Trupi gjykues konstaton se edhe në ankim deklarimet e subjektit për burimin e depozitimeve bankare janë kontradiktore. Konkretisht, teksta pretendon se Kolegji duhet të vlerësojë të gabuar përfundimin e Komisionit, pasi në shpjegime në ILDKPKI dhe në përgjigje të pyetësorëve nuk ka përjashtuar asnjëherë të ardhurat e tij dhe të familjarëve për krijimin e depozitimeve bankare, njëherazi parashtrohet se [...] *Komisioni duke interpretuar në mënyrën më të keqe të mundshme përgjigjet e sipërcituara, në disfavor të ankuesit, duke mos vlerësuar se depozitimet kanë burim vetëm të ardhurat nga qiraja e tokës, ka arritur në konkluzionin se e gjithë shuma e depozituar cash në bankë nuk mbulohet me të ardhura të ligjshme [...]*⁵⁷.

24.14. Në ILDKPKI në vitin 2015, për pyetjen specifike lidhur me të ardhurat për depozitimet bankare në vitet 2014-2015, në llogarinë rrjedhëse nr. {***}, përgjigja se, janë përdorur të ardhura nga qiraja e tokës bujqësore të babait Z. S., të lëna në administrim të tij, është shteruese dhe pa asnjë hapësirë për të pretenduar interpretim të saj e, aq më pak, për të pretenduar se nuk ka përjashtuar përfshirjen e të ardhurave të tij apo familjarëve në krijimin e depozitimeve bankare. Ndërsa me shpjegimet gjatë hetimit administrativ se ka pasur mundësi objektive të rrisë kursimet vetjake që të çelë llogari rrjedhëse pranë “Raiffeisen Bank” në shumën prej 100.000 lekësh, po ashtu ka qenë shteruese, duke përjashtuar të ardhurat nga qiraja e tokës bujqësore për depozitimet bankare. Për më tepër, fakti që për shpjegimet e tij kontradiktore nuk ka përmbushur barrën e provës, por edhe pse i pyetur në seancë dëgjimore për një vlerësim përfundimtar për burimin e të ardhurave për depozitimet bankare prej 1.719.000 lekësh ka dhënë shpjegime se janë kursimet e tij, trupi gjykues i gjen të pabaza pretendimet se shpjegimet dhe deklarimet e tij janë keqinterpretuar prej Komisionit.

24.15. Në përfundim të verifikimit të vërtetësisë së deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në deklaratën vetting lidhur me këto dy pasuri, trupi gjykues konkludon se subjekti gjendet në kushtet

⁵⁶ Udhëzimi nr. {***} prot., datë 10.10.2016, i ILDKPKI-së.

⁵⁷ Shih pikën 80 të ankimit të subjektit të rivlerësimit Saimir Smaka.

e një deklarimi të pasaktë për sa i përket mosdeklarimit të burimit të krijimit të pasurive të tij në deklaratën e pasurisë *vetting*, në kundërshtim me parashikimin e nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.

24.16. Trupi gjykues vlerëson të ndalet edhe në analizimin e ligjshmërisë së të ardhurave nga dhënia me qira e tokave bujqësore, të përmendura prej subjektit në shpjegimet e dhëna në ILDKPKI në vitin 2015, për provueshmërinë e të cilave subjekti ka paraqitur në Komision marrëveshjen mes palëve, shkresë e thjeshtë dhe dokumentacion për pagimin e detyrimeve tatimore në vitin 2021.

24.16.1. Trupi gjykues konstaton se subjekti nuk ka deklaruar në deklaratat e pasurisë marrëdhënien e qirasë, e cila pavarësisht se ishte krijuar nga personi i lidhur, nëna e tij, shtrinte efektet në të drejtat e tij pasurore, si bashkëpronar në këtë pronë të përfitur nga ligji nr. 7501/1991 “Për tokën”. Për rrjedhojë, në kuptim të ligjit nr. 84/2016, nenit 32, pika 5 “*Deklarimet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Apelit*”, subjekti i rivlerësimit ka dështuar të provojë ekzistencën e kësaj marrëdhënie nëpërmjet kësaj prove të posaçme sipas këtij ligji. Gjithashtu, edhe në shpjegimet e dhëna në ILDKPKI në vitin 2015 subjekti nuk e ka përmendur marrëveshjen e qirasë të datës 04.01.2013, mes palëve qiradhënës S. S. dhe qiramarrës Sh. M., por ka deklaruar se kjo marrëdhënie është krijuar nga babai i tij Z. S., duke shënuar një tjetër kontradiktë në deklarime, me pasojë shtimin e dyshimeve të arsyeshme për vërtetësinë e deklarimeve e, për pasojë, edhe të të ardhurave prej saj. Sa i përket marrëveshjes mes palëve, shkresë e thjeshtë, të paraqitur në Komision, edhe pse në aspektin formal, ajo përmbush kriteret e vlefshmërisë dhe ka fuqinë provuese të një shkrese të thjeshtë (private), në kuptim të neneve 246, 251, 258 dhe 259 të Kodit të Procedurës Civile, e paraqitur në kuadër të procesit të rivlerësimit, ngre dyshime të arsyeshme lidhur me kohën e përpilimit të saj përkundrejt aktit noterial, që merr datë të saktë dhe regjistrohet në regjistrat publikë, kopja e të cilit arkivohet e administrohet nga noteri publik.

24.16.2. Në konsideratë të qëndrimit orientues të Kolegjit⁵⁸, lidhur me vlerën provuese të pagimit të detyrimit tatimor për të ardhurat nga qiraja e tokës bujqësore, në fokus të analizës në këtë rast është vlerësimi i rrethanës së parë - *të provuarit bindshëm të ekzistencës së të ardhurave në kohën e krijimit të tyre*. Duke konstatuar se edhe në dokumentin e vetëm të krijuar jashtë periudhës së rivlerësimit, procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI në vitin 2015, subjekti nuk ka deklaruar shumën e të ardhurave të përfituara nga qiratë, trupi gjykues, në konsideratë të qëndrimit të Kolegjit se *pagimi i detyrimit tatimor nuk mund të shërbejë si një mjet për të provuar krijimin e*

⁵⁸ Shih vendimin e Kolegjit nr. 15 (JR), datë 18.06.2021, paragrafin 23: “[...] në lidhje me pagesat me vonesë të detyrimeve tatimore, nëse ato do të mundësojnë legjitimitimin e të ardhurave të krijuara, se [...] vlerësimi i tyre do të duhet të bëhet duke konsideruar disa rrethana. Së pari, duhet që të provohet bindshëm vetë ekzistenca e të ardhurave në kohën e krijimit të tyre, pasi pagimi i detyrimit tatimor nuk mund të shërbejë si një mjet për të provuar krijimin e të ardhurave që nuk provohen me mjete të tjera. Së dyti, në konsideratë të organeve të rivlerësimit duhet të mbahet sjellja e subjektit apo e personave të lidhur dhe e personave të tjerë të lidhur në raport me mospagimin në kohë të tyre. Brenda këtij kriteri, do të duhet të vlerësohen rrethanat që kanë shkaktuar mospagimin në kohë të detyrimit për të përcaktuar nëse mospagimi ka qenë pasojë e ndonjë pakujdesie apo paqartësie apo një qëllim për t’u arritur. Në çdo rast, këto të ardhura nuk mund të legjitimohen nëse subjektet, personat e lidhur apo personat e tjerë të lidhur kanë qenë në kushte keqbesimi, në kufijtë e kryerjes së një vepre penale [...]”.

të ardhurave që nuk provohen me mjete të tjera, vlerëson se pagimi i detyrimeve tatimore gjatë procesit të rivlerësimit nuk legjitimon krijimin e tyre në vitet 2014-2015. Në përmbledhje të sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se vendimi i Komisionit për të mos marrë në konsideratë të ardhurat nga qiraja e tokave bujqësore është i drejtë.

24.16.3. Përfundimisht, trupi gjykues vlerëson se konkluzioni i Komisionit *se krijohet bindja se ndryshimi i burimit të krijimit të depozitimeve bankare në cash në vitet 2014 - 2015, gjatë hetimit administrativ të procesit të rivlerësimit, është bërë pikërisht me qëllimin për të justifikuar burimin e ligjshëm të këtyre depozitimeve, është i drejtë.* Në rrethanat faktike ku shuma e pretenduar e të ardhurave nga qiratë, jo vetëm është dukshëm më e vogël se shuma e depozitimeve bankare, por gjithashtu mbetet e paprovuar, subjekti i rivlerësimit ka zgjedhur të ndryshojë deklarin e tij me qëllim justifikimin me të ardhura të ligjshme të depozitimeve bankare.

24.17. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se për të analizuar ligjshmërinë e shumave të depozitimeve bankare, analiza financiare duhet të kryhet për të gjithë të ardhurat e anëtarëve të familjes, pasi kanë jetuar në ekonomi të përbashkët familjare dhe në këtë rast balanca është pozitive.

24.17.1. Trupi gjykues konstaton se edhe në këtë aspekt subjekti ka qenë kontradiktor në deklarin e tij. Konkretisht: (i) në pyetësin standard ka shpjeguar se deri në datën 24.07.2017, kur është ndarë nga trangu familjar, shpenzimet e jetesës i ka përballuar bashkërisht me prindërit dhe vëllain; (ii) në pyetësin nr. 2, ka shpjeguar se nga muaji janar 2014 deri në muajin shtator 2018 ka banuar në Vlorë, me qira dhe ka paraqitur kontratat përkatëse; (ii) në pyetësin nr. 4 ka deklaruar fillimisht [...] *se nuk ka qëndruar në Vlorë pavarësisht se kishte marrë banesë me qira, por shkonte-vinte me mjete furgon, kosto e biletës 200 lekë, dhe udhëtimi zgjat 30 minuta[...]* dhe po në këtë pyetësor ka vijuar të deklarojë [...] *Qyteti i Vlorës përben një qytet apo një zonë gjeografike, rreth gjyqësor që ka shumë dinamike hetimore, ka një shumëllojshmeri çështjesh dhe kompleksitet të madh, çka e përbën të detyrueshme faktin që unë të kërkoja dhe të sistemohesha në këtë banesë. Për këtë periudhë kohore (nëntor 2013-gusht 2015) në banesën që përdorja me qera nga qeradhënsi z. V. B. kam paguar një shumë prej 10 000 mij lek në muaj. Më pas prej muajit shtator të vitit 2015 deri në muajin shtator të vitit 2018 kam përdorur për banim një tjetër apartament te shtetasit z. V. B. me sipërfaqe më të madhe me këto karakteristika që ndodhet në Lagja “{***}”, Njësia Administrative nr. {***} Rruga “{***}”, apartament, mbrapa Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë [...]”⁵⁹.*

24.17.2. Për periudhën kur ka krijuar depozitimet bankare, subjekti rezulton se ka banuar më vete, pra, *de facto* me regjim pasuror të ndarë nga familja, kjo sipas deklarinave të tij gjatë hetimit administrativ, si edhe në deklaratat e pasurisë të viteve respektive ku në rubrikën “*nëse dispononi vendqëndrim tjetër, adresa e plotë ku banoni*” ka deklaruar “Lagja “{***}”, Bashkia Vlorë, banesë me qira”. Duke arsyetuar *a contrario* se ka vijuar të banojë në Fier duke rrugëtuar vajtje-ardhje çdo ditë në Vlorë, marrja me qira e banesës, për më tepër në mënyrë të pandërprerë për të gjithë periudhën, nuk ka logjikë ekonomike. Për pasojë, trupi gjykues e vlerëson të pabazuar pretendimin se për depozitimet bankare në vitin 2014, analiza financiare duhet të përfshijë të ardhurat e familjarëve të tij. Megjithatë, edhe në një version garantist, duke përllogaritur të ardhurat dhe

⁵⁹ Shënim: gabimet drejtshkrimore janë të subjektit, teksti i cituar është transpozuar nga përgjigja e tij.

shpenzimet për të gjithë familjarët e subjektit, analiza financiare rezulton me mungesë burimesh të ligjshme financiare në shumën (-) 610.756 lekë.

24.18. Për sa më sipër, lidhur me pasuritë, llogari rrjedhëse me vlerë 365.403 lekë, pjesa takuese 100% dhe llogarinë rrjedhëse me vlerë 1.000.080 lekë, me pjesë takuese 100%, subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh të ligjshme financiare për krijimin e tyre, duke qenë se ai ka qenë në pamundësi për të justifikuar me burime të ligjshme kreditimet në njërin prej llogarive rrjedhëse, në periudhën 2014-2015, në vlerën 1.719.000 lekë, situatë që kualifikohet sipas nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

*Lidhur me pasurinë automjet tip “Mercedes-Benz”, vit prodhimi 2003, me targa {***}. Vlera: 4.500 euro. Pjesa takuese: 100%*

25. Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë, duke mos deklaruar në DIPP-në e vitit 2015 dhe në deklaratën *vetting* burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë automjet me targa {***}, dhe se rezulton me mungesë burimesh të ligjshme financiare në shumën (-) 382,307 lekë për të justifikuar blerjen e tij.
26. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se ka pasur mundësi financiare për të blerë këtë automjet në vitin 2015 me të ardhura të ligjshme. Sipas tij, analiza financiare e depozitimeve bankare në llogarinë rrjedhëse duhet të ishte kryer nga Komisioni bashkë me të ardhurat e anëtarëve të tjerë të familjes, sepse kanë pasur një ekonomi të përbashkët familjare, fakt që konstatohet nga dokumentet e paraqitura prej tij në ILDKPKI dhe në institucionet ligjzbatuese.
27. Trupi gjykues, pas shqyrtimit të akteve në fashikuj dhe pretendimeve të subjektit të rivlerësimit në ankim dhe parashtrime, konstaton dhe vlerëson si vijon.

27.1. Subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën *vetting* burimin e krijimit të kësaj pasurie. Deklarimet e tij për këtë pasuri, në deklaratat e pasurisë të administruara në ILDKPKI (në vijim DIPP) dhe gjatë hetimit administrativ, janë si vijon.

- DIPP-në e vitit 2015: “*Blerje automjeti tip ‘Mercedes-Benz C-Class’ viti 2003. Transaksioni kryer në gusht të vitit 2015. Automjeti regjistruar me targa {***}. Vlera: 4.500 euro*”. Në formularin e detyrimeve kontratë kredie bankare me “*Raiffeisen Bank*” në vlerën 312.000 lekë për blerje automjeti, shuma e shlyer nga deklarimi i mëparshëm 42.000 lekë, gjendja e detyrimit mbetur pa shlyer 259.948 lekë;
- DIPP-të e viteve 2016 dhe 2017: “*Blerje automjeti me kredi bankare në proces shlyerje, vit prodhimi 2003 me targa {***}*”, në formularin e detyrimeve ka deklaruar kredinë bankare dhe të dhënat përkatëse për shlyerjen e detyrimit.
- DIPP-në e vitit 2018: “*Shitje automjeti targa {***}, vlera: 3.500 euro*”.

- Gjatë hetimit administrativ⁶⁰ dhe në parashtrimet për rezultatet e hetimit administrativ, subjekti ka deklaruar: *“Nga shuma për blerjen e këtij automjetit 4.500 euro, 312.000 lekë janë siguruar nga një kredi në “Raiffeisen Bank” (konvertuar sipas kursit të këmbimit valutor në 2.500 euro) dhe pjesa tjetër 2.000 euro nga kursimet prej pagës si prokuror”*.

27.2. Trupi gjykues *së pari* vlerëson mospërmbushjen e detyrime ligjore, lidhur me deklarimin e burimit të krijimit të kësaj pasurie, duke u gjendur edhe në këtë rast para një deklarimi të pasaktë, në kundërshtim me parashikimin e nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016. Gjithashtu, për sa analizuar në pikën 24.17 e nën-pikat e saj, subjekti i rivlerësimit gjatë viteve që pretendoi se ka krijuar kursimet *de facto* ka jetuar i ndarë nga familja e tij, për rrjedhojë, trupi gjykues pretendimin se analiza financiare duhet të kryhet për të ardhurat e të gjithë familjarëve e vlerëson të pabazuar.

27.3. Nga kontrolli në Kolegj i analizës financiare të Komisionit, balanca negative konfirmohet. Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se lidhur me pasurinë automjet tip “Mercedes-Benz”, vit prodhimi 2003, me targa {***}, vlera 4.500 euro, pjesa takuese 100%, subjekti i rivlerësimit rezulton me mungesë burimesh të ligjshme financiare për të justifikuar blerjen e saj, duke u gjendur në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

*Pasuritë e llojit “arë” me sip. 1840 m², me sip. 880 m², të ndodhura në lagjen “{***}”, Bashkia Fier dhe pasuritë e llojit “arë” me sip. 3900 m² dhe tokë ullishte me sip. 1080 m², të ndodhura në Njësinë Administrative {***}, Bashkia Fier, përfituar me AMTP, sipas ligjit nr. 7501/1991 “Për tokën”*

- 28.** Lidhur me këto pasuri, Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë bërë deklaram të pasaktë të pasurive, duke mos deklaruar pjesët e tyre takuese në pasurinë e paluajtshme tokë bujqësore, të përfituar në bazë të ligjit nr. 7501/1991, “Për tokën”. Ky përfundim është bazuar në konkluzionet si vijon.

28.1. Nga shpjegimet dhe provat që ka dërguar subjekti, provohet se këto pasuri i përkasin në bashkëpronësi atij dhe familjarëve të tij si anëtarë të familjes bujqësore, pavarësisht se tokat bujqësore janë regjistruar në emër të prindërve të tij si kryefamiljarë⁶¹. Sipas certifikatës familjare që pasqyron gjendjen familjare në datën 01.08.1991 (bashkëlidhur deklaratës *vetting*) dhe certifikatës familjare, datë 01.10.1992, subjekti figuron pjesëtar në familjen e tij me 4 anëtarë dhe, për rrjedhojë, përfiton ¼ pjesë mbi çdo pasuri tokë bujqësore që ka përfituar familja e tij me

⁶⁰ Pyetësori nr. 4, pyetja nr. 2: *“Në deklaratën vetting ju deklaroni automjet tip ‘Mercedez Benz’, vit prodhimi 2003, me targë {***} dhe vlerë 4.500 euro, por nuk keni deklaruar burimin e krijimit. Ju lutemi përcaktoni burimin e ligjshëm financiar për blerjen e mjetit me targë {***}”*.

⁶¹ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting*, këto dokumente: (1) certifikatën dhe kartelën e pasurisë së datës 07.05.2015, në emër të shtetasit Z. S., babai i subjektit si përfaqësues i familjes bujqësore; (2) aktin e marrjes së okës në pronësi (AMTP), datë 29.08.1995, lëshuar në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991, “Për tokën”, sipas të cilit shtetasit Z. S. i është dhënë në pronësi tokë bujqësore me sipërfaqe totale 3040 m², përfshirë edhe parcelën me sip. 1840 m² dhe sip. 880 m²; (3) certifikatat familjare, datë 17.12.2014, për gjendjen familjare në datat 01.08.1991 dhe 01.10.1992, ku rezulton se në përbërje të familjes janë subjekti, prindërit dhe vëllai i subjektit.

AMTP, sipas ligjit nr. 7501/1991 “Për tokën”. Shpjegimet e subjektit janë të qarta e të mjaftueshme në lidhje me përcaktimin e pjesëve takuese mbi pasuritë, por jo bindëse për të justifikuar mosdeklarimin në deklaratën *vetting* dhe në DIPP-të e tjera të pjesëve takuese të pasurive nga subjekti dhe nga personat e lidhur me të, kjo në kushtet kur i njëjti ligj dhe të njëjtat prova, ku subjekti bazon shpjegimet e tij, kanë ekzistuar edhe në kohën kur ka plotësuar deklaratën *vetting* dhe gjithë DIPP-të.

28.2. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se edhe për këto pasuri Komisioni nxjerr konkluzione negative për pasaktësi sado të parëndësishme, qëndrim dukshëm i pabarabartë me qëndrime të tij për subjekte të tjerë. Sipas subjektit të rivlerësimit, pasuritë e sipërcituara janë përfituar në mënyrë të ligjshme, janë deklaruar nga personat e lidhur në deklaratën *vetting* dhe përcaktimi i pjesës takuese bëhet nga ligji. Në këto kushte, mosdeklarimi i pjesës takuese në deklaratën *vetting* është pasaktësi e parëndësishme dhe nuk mund të përbëjë shkak për marrjen e masës disiplinore.

28.3. Pas shqyrtimit të akteve në fashikuj dhe të pretendimeve të subjektit në ankim dhe parashtrime, trupi gjykues i Kolegjit konstaton dhe vlerëson si vijon.

28.3.1. Pasuritë e llojit “arë” me sip. 1840 m², me sip. 880 m², të ndodhura në lagjen “{***}”, Bashkia Fier dhe pasuritë e llojit “arë” me sip. 3900 m² dhe tokë ullishte me sip. 1080 m², të ndodhura në Njësinë Administrative {***}, Bashkia Fier, janë deklaruar në deklaratën *vetting*. Në DIPP-në e vitit 2015, këto pasuri janë shënuar në deklaratën e “personave të lidhur”, pa u nënshkruar nga subjekti dhe as nga personat e lidhur me subjektin (Z., S. dhe D. S.). Në këtë pjesë, subjekti ka deklaruar se *këto prona janë të përfituara dhe të regjistruara në emër të prindërve të mi Z. dhe S. S.. Këto pasuri janë të pandara dhe nuk mund të shprehem për pjesën konkrete që më takon*. Gjithashtu, në DIPP-në 2016 dhe DIPP-në 2017, këto pasuri janë deklaruar edhe nga personat e lidhur. Në të gjitha deklaratat nuk janë përcaktuar pjesët takuese mbi pasuritë. ZVRPP-ja Fier ka konfirmuar pronësinë e pasurive të llojit “arë” me sip. 1840 m², me sip. 880 m², të ndodhura në lagjen “{***}”, Bashkia Fier, në emër të Z. S., si përfaqësues i familjes bujqësore.

28.4. Trupi gjykues, referuar parashikimeve të ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991, “Për tokën”⁶², sjell në vëmendje se për këto pasuri të përfituara sipas këtij ligji të gjithë anëtarët e familjes bujqësore, sipas të dhënave të certifikatës familjare të datës 1.08.1991, rezultojnë në cilësinë e bashkëpronarit, në pjesë të barabartë, pavarësisht moshës dhe regjistrimit të titullit të pronësisë në emër të kryefamiljarit. Deklarimi i këtyre pronave prej subjektit të rivlerësimit, si edhe prej personave të lidhur, babai Z. S., nëna S. S. dhe vëllai D. S., në deklaratën *vetting* dhe në deklaratat e pasurisë, në të njëjtën mënyrë, pa pjesë takuese dhe me burim krijimi përfituar nga ligji nr. 7501, dëshmon se është ndjekur e njëjta logjikë, sikundër parashikon vetë ligji i sipërcituar,

⁶² Ligji nr. 7501, datë 19.07.1991, në nenin 5 parashikon: “Familjet anëtarë të kooperativës bujqësore, pas ndarjes së tokës kanë të drejtë të shkëputen dhe të dalin subjekt më vete, duke marrë në pronësi tokën bujqësore që u takon nga tërësia e subjektit ku bëjnë pjesë. Sasia dhe vendi ku do të jepet toka, përcaktohet nga komisioni i tokës”; dhe në nenin 6 parashikon: “ Familjeve me banim në fshat, që nuk janë anëtarë të kooperativës bujqësore dhe familjeve që punojnë e banojnë në ndërmarrjet bujqësore, u jepet në përdorim tokë bujqësore, madhësia e së cilës përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave”.

bashkëpronësi në pjesë të barabarta. Mosdeklarimi në deklaratën *vetting* i pjesëve takuese të pasurisë të përfituar nga ligji nr. 7501/1991 “shërohet” nga dokumentacioni justifikues ligjor i paraqitur me të, i cili, pavarësisht se pronat figurojnë në emër të Z. dhe S. S., provon pa asnjë ekuivok bashkëpronësinë në pjesë të barabarta të subjektit dhe personave të lidhur.

28.5. Trupi gjykues çmon të sjellë në vëmendje qëndrimin e Kolegjit se kompetenca, me të cilën Kushtetuta dhe ligji e kanë ngarkuar Komisionin për të ushtruar procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, nuk mund të kufizohet dhe të jetë vetëm gjetja e gabimeve ndër vite të subjekteve që hetohen dhe gjykohen. Përkundrazi, Komisioni gjatë hulumtimit dhe zbatimit të detyrave funksionale duhet që këto pasaktësi t’i shoqërojë me konkluzionin se janë pikërisht ato mjetet me të cilat subjekti i rivlerësimit fsheh pasurinë apo burimin e krijimit të saj. Fokusi kryesor juridiksional i Komisionit është dhe mbetet përgjatë gjithë procesit, saktësia dhe vërtetësia e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë të realizuar në kuadrin e procesit të rivlerësimit kalimtar. Nëse pasaktësia apo mospërputhja është e palidhur me fshehjen e pasurisë e mungesën e burimeve të ligjshme dhe është pasojë e një konteksti të caktuar të perceptimit të gabuar dhe në mirëbesim të subjektit të rivlerësimit, atëherë kjo rrethanë nuk mund të kualifikohet si një nga rastet e legjitimuara nga Kushtetuta për dhënien e një mase disiplinore nga ana e organeve vendimmarrëse të procesit të rivlerësimit kalimtar.

- 29.** Në rrethanat faktike si më sipër, trupi gjykues vlerëson se konkluzioni i Komisionit për këto pasuri nuk është i drejtë. Mosdeklarimi i pjesës takuese të këtyre pasurive është një pasaktësi pa pasojë, për sa subjekti me dokumentacionin e dorëzuar ka përmbushur detyrimet ligjore për të provuar bashkëpronësinë në pjesë të barabarta me personat e lidhur. Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit e vlerëson pretendimin e subjektit të bazuar.

Shpenzime të deklarueshme: qira vjetore në bazë të kontratës së qirasë në vlerën 15.000 lekë/muaj, e shlyer tërësisht për 12 muaj. Vlera: 180.000 lekë

- 30.** Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë në lidhje me marrëdhënien e qirasë dhe me vlerat e qirave mujore, bazuar në vlerësimet si vijon.

30.1. Subjekti i rivlerësimit, për periudhën e qirasë së vazhdueshme mbi 1-vjeçare, janar 2014-janar 2017, ka pasur një marrëdhënie qiraje verbale dhe jo në formën e kërkuar ligji, konkretisht nga neni 803 i Kodit Civil “me shkresë”.

30.2. Subjekti ka dhënë shpjegime dhe të dhëna kontradiktore në lidhje me vlerat e qirasë mujore 10.000 lekë/muaj dhe 15.000 lekë/muaj dhe kohën kur është aplikuar secila prej tyre. Komisioni vlerëson se subjekti ka bërë deklaram të pasaktë të marrëdhënies së qirasë dhe vlerave të qirave mujore.

30.3. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se konkluzioni i Komisionit nuk është i drejtë. Për periudhën janar 2014-gusht 2015 ka paguar qira në vlerën 10.000 lekë/muaj dhe për periudhën shtator 2015-tetor 2018 ka paguar qira në vlerën 15.000 lekë/muaj. Vlera e qirasë është deklaruar

në çdo deklaratë vjetore, pavarësisht se ajo ka qenë nën shumën 300.000 lekë-kufiri për shpenzimet e deklarueshme.

30.4. Trupi gjykues, nga analizimi i akteve në fashikuj dhe pretendimeve të subjektit, konstaton dhe vlerëson si vijon.

30.4.1. Me deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka depozituar dy dokumente justifikues që mbajnë datën 27.01.2017: (i) kontratë qiraje⁶³ për marrjen me qira të një apartamenti me sipërfaqe 63,8 m², në Vlorë, për një periudhë njëvjeçare, vlerë qiraje 15.000 lekë/muaj; (ii) deklaratën noteriale të pronarit të këtij apartamenti, shtetasit V. B. dhe subjektit, me të cilën të sipërpërmendurit deklarojnë se apartamenti me sipërfaqe 63,8 m² [e gjithë sipërfaqja] i është dhënë subjektit me qira për banim për periudhën janar 2014 - janar 2017⁶⁴. Të dy dokumentet kanë bashkëlidhur certifikatën e pronësisë në emër të z. V. B., për apartamentin me sipërfaqe 63,8 m² nr. pasurie {***}, lëshuar nga ZVRPP-ja Vlorë në datën 24.07.2013.

30.4.2. Në ILDKPKI, sipas procesverbalit të datës 20.11.2015, subjekti ka shpjeguar se [...] *aktualisht banoj me qira të ulët, në apartamentin e z. V. B. në lagjen “{***}”, rreth 10.000 lekë/muaj, pa kontratë dhe vetëm me marrëveshje verbale.*

30.4.3. Gjatë hetimit administrativ, subjekti ka shpjeguar dhe konfirmuar se për periudhën janar 2014 - shtator 2018 ka banuar me qira në banesën e shtetasit V. B., lagja “{***}”, rruga “{***}”, Vlorë, vlera e qirasë 15.000 lekë/muaj është paguar dorazi [në pyetësorët nr. 1 dhe nr. 2]. Ndërsa më pas ka shpjeguar se në periudhën janar 2014 - gusht 2015 ka paguar qira 10.000 lekë/muaj, kurse në periudhën shtator 2015 - shtator 2018 ka paguar qira 15.000 lekë/muaj, kjo për shkak se në periudhën e parë ka banuar në një garsonierë në pronësi të qiradhënësit e në periudhën e dytë në një apartament tjetër në pronësi të tij dhe rritja e sipërfaqes ndikoi në rritjen e qirasë [pyetësorin nr. 4.]

30.4.4. Trupi gjykues *së pari* konstaton se në të kundërt sa pretendon, subjekti nuk ka deklaruar kontratën e qirasë në deklaratat periodike të pasurisë të viteve korrente, ndërsa në deklaratën e pasurisë të vitit 2016, dorëzuar në ILDKPKI pas dorëzimit të deklaratës *vetting*, ka deklaruar shpenzime qiraje sipas kontratës së qirasë vetëm për këtë vit. Trupi gjykues konstaton se deklaratimet e subjektit gjatë hetimit administrativ janë kontradiktore, duke ndryshuar vlerat në përputhje me interesat e tij. Konkretisht, në deklaratën noteriale, të paraqitur prej tij me deklaratën *vetting* për periudhën janar 2014 - janar 2017, pasqyrohet vlera e qirasë 15.000 lekë/muaj, e rideklaruar prej tij në pyetësorë, por për kërkesën për të dhënë shpjegime për ndryshimin nga vlera e qirasë e deklaruar prej tij në ILDKPKI në vitin 2015, subjekti “kujton” rrethanat që kanë ndikuar për ndryshimin e vlerës së qirasë. Shpjegimet e subjektit se në periudhën janar 2014 - gusht 2015 ka banuar në një garsonierë në pronësi të shtetasit V. B. dhe në periudhën shtator 2015 - shtator 2018 në një apartament tjetër në pronësi të këtij shtetasi dhe rritja e sipërfaqes së apartamentit ka ndikuar në rritjen e qirasë, vijnë në kundërshtim me përmbajtjen e deklaratës noteriale, ku

⁶³ Kontratë qiraje nr. {***}, datë 27.01.2017, lidhur mes subjektit dhe shtetasit V. B..

⁶⁴ Deklaratë noteriale nr. {***}, datë 27.01.2017.

deklarohet dhënia me qira në vlerën 15.000 lekë/muaj për të gjithë periudhën janar 2014 - janar 2017 e të njëjtit apartament. Për sa subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar marrëdhënien e qirasë në deklaratat periodike të pasurisë me pasojë pa mundësimin e kontrollit prej organeve kompetente për konflikt të mundshëm të interesit, nuk ka formalizuar me kontratë me shkrim këtë marrëdhënie për periudhën mbi njëvjeçare, janar 2014 - janar 2017, si parashikim i nenit 803 të Kodit Civil⁶⁵, por edhe si sjellje korrekte si prokuror në raport me ligjin dhe ka dhënë shpjegime kontradiktore për vlerën e qirasë, qëndrimi i Komisionit, megjithëse i saktë nga pikëpamja e konstatimit të situatës faktike, vlerësohet jo relevant dhe i pakualifikueshëm sipas ndonjë prej rasteve të parashikuara nga neni 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Për pasojë, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se deklaratimet e pasakta të subjektit, lidhur me marrëdhënien e qirasë dhe vlerat e qirave mujore, nuk mund të shërbejnë si një shkak mbi të cilin mund të vendoset masa disiplinore.

Analiza financiare për periudhën 2013-2016

31. Komisioni, pas kryerjes së analizës financiare për periudhën 2013 - 2016, ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë në shumën 172.731 lekë.

31.1. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se balanca negative e Komisionit, përpos se është hipotetike duhet të interpretohet bazuar në parimin e proporcionalitetit, si dhe kundërshtoi analizën financiare me argumentet se shpenzimet e përllogaritura, sipas INSTAT-it, janë shpenzimet mesatare për frymë dhe jo shpenzimet e minimumit jetik, shpenzimet për qira dhe transport janë përllogaritur dy herë, si shpenzime më vete dhe si shpenzime jetike [sipas ILDKPKI-së, e cila i referohet të dhënave të INSTAT, për shpenzimet mesatare mujore për frymë përfshihen edhe shpenzimet për qira dhe transport].

31.2. Trupi gjykues, në konsideratë të qëndrimit të mbajtur në jurisprudencën e Kolegjit⁶⁶, vlerëson se metodologjia e përdorur në analizën financiare nga Komisioni është e drejtë dhe e bazuar. Nga kontrolli i analizës financiare të kryer prej Komisionit për këtë periudhë, konfirmohet rezultati i saj se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë mungesë të burimeve të ligjshme financiare, për të kryer shpenzimet familjare dhe për të krijuar pasuritë për periudhën 2013 - 2016, duke u gjendur nën parashikimet e nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

32. Në përfundim, në analizë të qëndrimeve të mësipërme, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se subjekti nuk arrin nivel të besueshëm lidhur me të, në kuptim të nenit D, pika 1 të Aneksit të Kushtetutës dhe se ai gjendet në kushtet e deklaratimit të pamjaftueshëm për këtë kriter, sipas parashikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

⁶⁵ Kodi Civil në nenin 803 parashikon: “[...] Kontrata e qirasë, për një kohë më të gjatë se një vit, duhet bërë me shkresë”.

⁶⁶ Shih vendimin e Kolegjit nr. 18/2022 (JR) paragrafi 27.1.

D. Për kriterin e kontrollit të figurës

33. Lidhur me këtë kriter, pavarësisht konkluzionit të DSIK-së për përshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit Saimir Smaka për vazhdimin e detyrës, Komisioni, bazuar në nenin 38 të ligjit nr. 84/2016, ka analizuar provat e administruara nga ana e autoriteteve ligjzbatuese, të cilat kanë rezultuar me interes përgjatë hetimit administrativ. Në vendimin objekt shqyrtimi, Komisioni shprehet se në përfundim të hetimeve, një pjesë e rezultateve të cilat pasqyrohen në raportin profesional i ka rezultuar se përmbajtja e këtyre materialeve përputhet dhe mbështet informacionin e ardhur nga organet ligjzbatuese, duke konkluduar se, bazuar në informacionet dhe dokumentacionet e klasifikuara, të cilat nuk mund të përdoren në aktet publike apo të vihen në dispozicion të subjektit, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.
34. Subjekti i rivlerësimit, në ankim dhe parashtrime, pretendoi se konkluzioni i Komisionit është jo logjik dhe jo i drejtë, i nxjerrë në kundërshtim me parimet e procesit të rregullt ligjor dhe rregullat që normojnë procesin e *vetting*-ut, për shkak të mosvënies në dispozicion të provave, moskomunikimit të gjetjeve dhe barrës së provës, ndërkohë që organi ndihmës dhe kompetent për kontrollin e figurës, DSIK-ja, ka konstatuar përshtatshmërinë e tij për vijimin e detyrës. Sipas subjektit, ligji nr. 84/2016 është deficitar sa i përket elaborimit të kriterëve që përcaktojnë sjellje të aftë për *cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë* dhe, në këto kushte, diskrecioni i pakufizuar i organeve të *vetting*-ut në shumë raste bëhet abuziv, si në rastin e tij, pasi, bazuar në parashikimet e nenit 61/5 të ligjit, Komisioni nuk mund të arrinte në konkluzionin për cenim të besimit të publikut duke u bazuar vetëm në një kriter.
- 34.1. Bazuar në vendimin nr. 109, datë 28.12.2021, të GjKKO-së, marrë pas shpalljes së vendimit të Komisionit objekt shqyrtimi, subjekti i rivlerësimit në parashtrime potencoi argumentet e tij përkundër atyre në ankim, konkretisht si vijon.
- 34.2. Në ankim, subjekti pretendoi se procesi i tij i rivlerësimit është paragjykuar edhe për shkak të shkresës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda të datës 04.10.2019, sipas të cilës, pranë kësaj prokurorie ka indicie për përfshirjen e tij në veprën penale “*Korrupsionit pasiv të gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë*”, parashikuar nga neni 319 i Kodit Penal, për të cilën po vijnë hetimet. Sipas subjektit, kjo shkresë është në kundërshtim me rregullat e përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale, pasi, sipas informacionit të dërguar më pas nga Prokuroria e Posaçme kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit, Komisioni është informuar se procedimi penal është regjistruar pa emër, që do të thotë se nuk ka të dhëna që të krijojnë *dyshime minimale* për kryerjen e veprës penale prej tij dhe për vetë periudhën 3-4 vjeçare gjatë të cilës ai nuk ka marrë asnjë njoftim, krijohet bindja se çështja ka mbetur pa vendimmarrje për shkak të ngarkesës së institucionit.
- 34.3. Në parashtrime, subjekti pretendoi se ka rënë çdo dyshim i Komisionit i bazuar në informacionin e dërguar nga organet ligjzbatuese. Në vendimin me të cilin është vendosur pranimi i kërkesës së Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për pushimin

e procedimit penal nr. {***}, regjistruar për veprën penale “Korrupsionit pasiv të gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, sipas nenit 319 të Kodit Penal, GjKKO-ja ka arsyetuar: “Nga analiza e vendimmarrjes së Gjykatës, si dhe nga analiza në tërësi e përgjimeve telefonike të realizuara nuk rezultojnë asnjë indicie apo provë, për të cilin është regjistruar procedimi penal”. Vendimi i GjKKO-së është bazuar në germën “a” të nenit 328/1, pra, fakti nuk ekziston, pretendoi subjekti.

35. Trupi gjykues i Kolegjit, pas shqyrtimit të akteve të administruara në fashikujt e Komisionit dhe ato të administruara në Kolegj, konstaton dhe vlerëson si vijon.

35.1. Së pari, disa prej shkaqeve të ankimit janë analizuar më lart në këtë vendim, konkretisht, lidhur me moskalimin e barrës së provës në paragrafin 16.4, lidhur me përdorimin e informacionit të klasifikuar në paragrafin 16.5, lidhur me kriteret e vlerësimit dhe kufizimin e së drejtës së njohjes me informacionin e klasifikuar, sipas qëndrimit të GjEDNj-së në çështjen *Regner kundër Republikës Çeke* me çështjen e subjektit, në paragrafin 16.6. e nënpikat e tij. Për rrjedhojë, trupi gjykues i vlerëson të ezauruar analizimin e mëtejshëm të tyre.

35.2. Lidhur me pretendimin për paragjykim të vlerësimit të kontrollit të figurës nga shkresa e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, nga sa analizuar gjerësisht më lart në këtë vendim, paragrafët 15.4.1-15.4.4, si dhe referuar informacionit të Prokurorisë së Posaçme se ka indicie për përfshirje të prokurorit Saimir Smaka, me detyrë Prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë në veprën penale “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, parashikuar nga neni 319 i K. Penal, fakt për të cilin hetimet vazhdojnë, trupi gjykues vlerëson se gjatë hetimit administrativ, Komisioni ka pasur të dhëna për veprime të subjektit në kundërshtim me ligjin, konsideruar të dhënat që kanë rezultuar nga hetimi dhe janë marrë në analizë prej tij. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit vlerësohet prej trupit gjykues i pabazuar.

35.3. Lidhur me pretendimin se përshtatshmëria e tij për vijimin e detyrës është vlerësuar nga DSIK-ja, organi ndihmës dhe kompetent për kontrollin e figurës, trupi gjykues, në konsideratë të qëndrimit të Gjykatës Kushtetuese,⁶⁷ vlerëson të sjellë në vëmendje se është Komisioni autoriteti përgjegjës për kontrollin e figurës, dhe vlerësimi prej tij i informacionit të administruar nga organet ligjzbatuese, vjen në përputhje të plotë me kompetencat e tij, të njohura nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit vlerësohet nga trupi gjykues i pabazuar.

⁶⁷ Në vendimin nr. 2/2017, Gjykata Kushtetuese, shprehet se: “Gjykata vlerëson se institucionet kushtetuese të rivlerësimit kanë autoritetin për të ruajtur një kontroll të plotë mbi procesin e verifikimit të figurës, si dhe për të pasur akses tek të gjitha materialet përkatëse. [...] Sipas nenit 14 të ligjit (nr. 84/2016) relatori në çdo rast duhet të ndërmarrë të gjitha procedurat për të siguruar provat e nevojshme për procesin e vendimmarrjes së trupës gjyqësore. [...] Organet e tjera, të cilat janë të përfshira në procesin e rivlerësimit, kanë funksione ndihmëse dhe instrumentale që kanë për qëllim të ndihmojnë institucionet kushtetuese në përmbushjen e mandatit të tyre. Në të gjitha rastet, autoriteti vendimmarrës mbetet tek organet e rivlerësimit (Komisioni dhe Kolegji) të krijuara për këtë qëllim në përputhje me dispozitat e Kushtetutës, si organe gjyqësore të pavarura dhe të paanshme”.

35.4. Lidhur me pretendimin se nga vendimi i GjKKO-së ka rënë çdo dyshim i Komisionit i bazuar në informacionin e dërguar nga organet ligjzbatuese, trupi gjykues vlerëson se analizimi i këtij pretendimi kërkon përgjigje për dy çështje: (i) a ndikon në procesin e rivlerësimit, me natyrë administrative, pushimi i procedimit penal nr. {***}; (ii) faktet e analizuara nga GjKKO, a hedhin dritë apo mund të përdoren në procesin e rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit Saimir Smaka.

35.4.1. Kolegji në jurisprudencën e tij ka mbajtur qëndrimin se procesi i rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, i parashikuar nga dispozitat kushtetuese dhe ligji nr. 84/2016, në funksion të qëllimit kushtetues [...] të rikthimit të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë [...], realizohet në mënyrë autonome bazuar në parime, metodologji, procedura dhe standarde të përcaktuara qartë, në përfundim të të cilit arrihet në konkluzione që jo detyrimisht përfaqësojnë rrethana për thirrjen në përgjegjësinë penale. Gjithashtu, në vështrim të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me objekt, ndër të tjera, rregullimin lidhur me përgjegjësi disiplinore, civile dhe penale e magjistratëve, duke i parashikuar normat në dispozita të veçanta të Kreut I-rë të tij, përcaktohet qartë se përgjegjësia disiplinore është pasojë e veprimeve të caktuara, të cilat jo në të gjithë rastet çojnë në përgjegjësi penale. Sa më sipër, vendimi i GjKKO-së për pushimin e procedimit penal nr. {***}, regjistruar për vepra penale të parashikuara nga Kodit Penal, neni 319 “Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë” dhe 319/ç “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, nuk passjell në mënyrë automatike mos shqyrtimin e veprimeve të subjektit të rivlerësimit në kuadër të një procedimi disiplinor, brenda të cilit ato mund të kenë peshë e vlerësim të ndryshëm nga ajo që kanë në procesin penal.

35.4.2. Referuar vendimit nr. 109, datë 28.12.2021, të GjKKO-së, me të cilin është vendosur pranimi i kërkesës së Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për pushimin e procedimit penal nr. {***} të vitit 2019, regjistruar për veprat penale të parashikuara nga nenet 319 dhe 319/ç të Kodit Penal, lidhur me korrupsionin aktiv dhe pasiv të gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë, trupi gjykues konstaton të pasqyruar, në mënyrë të përmbledhur, si vijon.

Sa i përket rrethanave të çështjes dhe provave

- Në datën 27.09.2018, policia gjyqësore ka referuar aktet për fillimin e procedimit penal të mundshëm: në Gjykatën e Shkallës së Parë Vlorë është zhvilluar procesi gjyqësor në ngarkim të të pandehurve E. D., F. K. dhe M. S. të akuzuar për veprën penale “*prodhim dhe shitje të lëndëve narkotike*” në bashkëpunim, parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal. Shtetasit E. D. dhe F. K. janë hetuar me masën e sigurimit “arrest me burg” ndërsa M. S. është hetuar në gjendje të lirë.
- Në datën 27.09.2018, oficeri i policisë gjyqësore informon se një nga gjyqtarët e gjykimit të çështjes ka qenë gjyqtarja A. Z. dhe mbrojtës i të pandehurit E. D. ka qenë L. Ç., për të cilën, nga policia gjyqësore në bashkëpunim me agjencitë ligjzbatuese, janë disponuar informacione se për të lehtësuar pozitën e të mbrojturit prej saj ka orientuar nënën e të pandehurit E. D., shtetasen L. D., që të marrë takim me prokurorin e çështjes Saimir Smaka, me qëllim që t’i japë

ryshfet për të favorizuar pozitën e tij në gjykim. Sipas informacionit të oficerit të policisë gjyqësore, kjo shtetase ka realizuar takimin me prokurorin Saimir Smaka në ambientet e Prokurorisë dhe *kishte dyshime se i kishte dhënë prokurorit shumën prej 120.000 lekësh* dhe se në këtë takim prokurori i ka sugjeruar shtetases që të marrë takim edhe me gjyqtaren A. Z..

- Në datën 28.09.2018, është vendosur nga gjykata përgjimi i numrave telefonikë në përdorim nga shtetasit A. D. dhe L. B., si dhe ai në përdorim nga prokurori Saimir Smaka (***), për një periudhë prej 15 ditësh. Nga transkriptimi i përgjimeve, pasqyrohen biseda të datës 03.10.2018, 04.10.2018 dhe 08.10.2018, të shtetasit L. B. me asistenten e tij E. R..
- Prokurori ka parashtruar se *Prokuroria e Posaçme, në përfundim të hetimeve me metoda speciale, ka konkluduar se nuk rezulton ndonjë e dhënë për ekzistencën e faktit penal për të cilin kanë filluar hetimet apo për ndonjë vepër penale tjetër, as ndonjë e dhënë për elementë të anës objektive dhe subjektive të veprës penale të parashikuar nga nenet 319 dhe 319/ç të Kodit Penal, as elementet e ndonjë figure tjetër vepre penale, fakti në tërësinë e tij nuk përbën vepër penale, për rrjedhojë procedimi penal duhet të pushohet.*

Sa i përket ligjit të zbatueshëm dhe arsytimit të gjykatës

- Nga sa rezulton nga hetimi në përgjithësi, konkludohet se për këtë procedim penal, pavarësisht faktit se janë kryer të gjithë veprimet hetimore, nuk u bë e mundur që në asnjë rast, me gjithë veprimet e kryera, të provohej ekzistenca e veprave penale të korrupsionit aktiv apo pasiv të gjyqtarit, prokurorit apo funksionarëve të tjerë të drejtësisë, për sa *gjatë gjithë periudhës së përgjuar dhe hetuar* nuk ka asnjë idicie apo provë, që të përbëjë elementë të ndonjë vepre penale.
- Në përmbajtjen e informacionit të policisë gjyqësore referohet se dy të pandehurit (E. D., F. K.) janë ndjekur me masën e sigurimit “arrest me burg”, nga aktet rezulton se fillimisht të dy shtetasit janë ndjekur me masë sigurimi “arrest me burg” me afat dhe në vijim gjyqtari i hetimeve paraprake ka ndryshuar masën e sigurimit vetëm për shtetasin F. K. dhe i pandehuri E. D. ka vijuar me të njëjtën masë sigurimi.
- Në gjykimin e themelit, avokati L. B. nuk ka qenë përfaqësues i asnjë prej të pandehurve. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, prokurori ka kërkuar aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal vetëm për të pandehurin F. K., ndërkohë gjykata i ka vendosur në të njëjtat kushte të dy të pandehurit, duke aplikuar nenin 59 të Kodit Penal, për të dy.
- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka disponuar me vendim përfundimtar nr. {***}, datë 12.09.2018, ndërkohë informacioni është depozituar më datë 27.09.2018 (15 ditë më vonë).
- Nga analiza e vendimmarrjes së Gjykatës, si dhe nga analiza në tërësi e përgjimeve telefonike të realizuara, nuk rezulton asnjë idicie apo provë që të jenë konsumuar elementet e veprave penale për të cilat është regjistruar procedimi penal.

35.4.3. Nga sa më sipër, trupi gjykues konstaton se bazuar në informacionin e policisë gjyqësore për veprime korruptive të prokurorit, veprimet hetimore dhe vënia nën përgjim e numrit telefonik të subjektit, janë kryer pas dhënies së vendimit përfundimtar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor

Vlorë⁶⁸. Periudha kur janë kryer veprimet hetimore nuk përkon me kohën kur subjekti ka takuar nënat e të pandehurve, sipas deklarimeve të tij në seancë dëgjimore se [...] kanë ardhur herën e parë kanë qenë me masë me afat më duket dhe i kam thënë zonjë do prisni se nuk kanë ardhur aktet, vjen prapë në përfundim i them zonjë unë e kam çuar çështjen në gjyq u kam thënë do të shkojë çështja te gjyqtari i seancës paraprake, në qoftë se keni pretendime që prokurori e ka rënduar akuzën [...] ⁶⁹dhe, më tej, [...] vendimi është dhënë dikur nga muaji shtator i vitit 2018, ato kanë ardhur diku nga fillimi i muajit shtator [...] vendimi i seancës paraprake duhet të jetë dhënë rreth muajit qershor 2018, duke mbajtur parasysh lejen vjetore vendimi është dhënë pas muajit shtator 2018 dhe mbaj mend që njëra prej këtyre zonjave ka ardhur në ambientet e prokurorisë dhe i kam thënë këtë gjë, që çështja do të shqyrtohet me objektivitet, me paanësi dhe do të zgjidhet brenda një afati të arsyeshëm [...].⁷⁰

35.4.4. Sa më sipër, duke konstatuar se edhe vetë GjKKO-ja arsyeton se nuk ka indicie apo provë për periudhën e hetuar, trupi gjykues çmon se në funksion të procesit të rivlerësimit, veprimet e subjektit në raport me zbatimin korrekt të ligjit penal, të provuara apo si deduksion i sjelljeve dhe qëndrimeve të tij do të analizohen përgjatë gjithë kohëzgjatjes së procedimit penal me të pandehur E. D. dhe F. K. dhe jo pas përfundimit të këtij procedimi. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se vendimi i GjKKO-së, i cili ka disponuar në aspekt të ekzistencës së ndonjë vepre penale nuk përjashton *a priori* shkelje disiplinore të subjektit të rivlerësimit në këtë procedim.

35.5. Nën dritën e parashikimeve kushtetuese dhe ligjore, si dhe të qëndrimit të Gjykatës Kushtetuese në vendimin 2/2017, ku Gjykata ka analizuar se për sa i takon procesit të kontrollit të figurës, rezulton se sipas nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës objekti i këtij kontrolli është identifikimi i atyre subjekteve që kanë kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar dhe pas njohjes me dokumentacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se konkluzioni i Komisionit, lidhur me kriterin e kontrollit të figurës se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, nuk është i bazuar. Sipas dispozitave kushtetuese dhe ligjore, lidhur me këtë kriter, Komisioni mund të konkludonte nëpërmjet konstatimit të përshtatshmërisë apo papërshtatshmërisë së subjektit, por jo të përdorte indiciet që vijnë nga hetimi për të, si fakte të mjaftueshme për cenimin e besimit të publikut.

35.6. Në vijim, në konsideratë të qëndrimit të mbajtur nga Kolegji se në interpretim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, që cenimi i besimit të publikut të ketë ndodhur, të jetë i arsyeshëm, i konsiderueshëm apo i perceptueshëm si i tillë, duhet që të ekzistojnë shkelje që në vetvete nuk përbëjnë shkaqe për aplikimin e rasteve të tjera të shkarkimit, të parashikuara nga pikat 1, 2, 3 e 4, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016⁷¹, të dhënat e dokumentacionit të administruar nga organet ligjzbatuese do të vlerësohen nga trupi gjykues në vlerësimin në tërësi të çështjes e në harmoni edhe me konkluzionet që do të arrihen lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale.

⁶⁸ Krahas numrit të telefonit vënë nën përgjim –{***}- subjekti i rivlerësimit ka pasur në përdorim edhe numrin tjetër {***}, sipas deklarimeve në deklaratën vetting dhe deklaratat e pasurisë, komunikimet përmes të cilit nuk janë kontrolluar.

⁶⁹ Shih procesverbalin e seancës dëgjimore në Komision, faqe 46

⁷⁰ Shih procesverbalin e seancës dëgjimore në Komision, faqe 55.

⁷¹ Shih vendimin e Kolegjit nr. 19/2023 (JR), paragrafi 94.

E. Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

36. Subjekti i rivlerësimit, në *konsiderata të përgjithshme*, pretendoi se në procesin e rivlerësimit, vlerësimi i aftësive profesionale është veçanërisht i ndjeshëm, në dritën e nevojës për të shmangur dëmtimin, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në ushtrimin e pavarur të diskrecionit gjyqësor. Sipas tij, mangësitë profesionale mund të çojnë në shkarkim vetëm kur nuk mund të përmirësohen nëpërmjet programit njëvjeçar të trajnimit, ndërsa modalitetet dhe kufijtë e vlerësimit të aftësive profesionale janë vlerësuar nga Gjykata Kushtetuese dhe Komisioni i Venecias, ndërsa treguesit kryesorë për vlerësim, po ashtu edhe vlerësimi në mënyrë të detajuar, sigurohet nga ligji nr. 96/2016, ku ligji nr. 84/2016 referon.

36.1. Konkluzionet e Komisionit duhet të ishin vlerësuar në raport me ngarkesën e lartë të punës gjatë periudhës së rivlerësimit - *926 çështje penale nga të cilat ka përfunduar 770, ku sipas tij me një përllogaritje të thjeshtë çdo ditë duhet të arsyetojë 1-2 vendime përfundimtare, përpos veprimtarive të tjera në ushtrim të detyrës*, pretendoi subjekti. Për sa në vendimin e Komisionit theksohet se bazuar në raportin KLP-së dhe dokumentacionin e shqyrtuar nga Komisioni, nuk janë konstatuar problematika që çojnë në një vlerësim negativ të subjektit të rivlerësimit për sa i përket aspektit profesional⁷², subjekti u shpreh se krijohet bindja që konkluzioni fillimisht ka qenë pozitiv dhe për shkaqe të panjohura, por jo objektive, është ndryshuar.

E/I Dosje të përzgjedhura sipas një sistemi rastësor dhe objektiv

37. Lidhur me kallëzimin penal nr. {***}, datë 26.11.2014⁷³, Komisioni ka konkluduar se: “(a) Subjekti ka tejkalluar afatet e marrjes së vendimeve të përcaktuara në udhëzimin nr. 241, datë 21.11.2005, të Prokurorit të Përgjithshëm, i ndryshuar; (b) Vendimi i mosfillimit është nxjerrë 5 ditë përpara se ankuesi të tërhiqte ankimin, për rrjedhojë, subjekti rezulton se nuk e ka argumentuar vendimin e mosfillimit të procedimit penal. (c) Vendimi datë 10.7.2015, “Për mosfillim të procedimit penal” i është komunikuar ankuesit, në tejkallim të afatit të parashikuar nga neni 291/1 Kodit të Procedurës Penale”.

37.1. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se vendimi i mosfillimit të procedimit penal: (i) është marrë me vonesë për shkak të ngarkesës së punës, por mosrespektimi i afatit nuk ka sjellë asnjë pasojë për palët; (ii) është marrë padyshim pas tërheqjes së ankimit dhe në njërin nga dokumentet duhet të ketë padyshim një lapsus në datën e tij; (iii) njoftohet nga sekretaria gjyqësore nëpërmjet shërbimit postar dhe argumenti se vendimet duhet të njoftohen nga policia gjyqësore është i pasaktë.

38. Trupi gjykues i Kolegjit, pas shqyrtimit të akteve në fashikujt e Komisionit dhe në dosjen e këtij procedimi penal, të pretendimeve e shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, lidhur me procedurat e ndjekura prej tij si prokuror i çështjes, vlerëson si vijon.

⁷² Shih vendimin e Komisionit, fq. 30, paragrafi i fundit.

⁷³ Dosja nr. 1, e përzgjedhur sipas një sistemi rastësor dhe objektiv.

38.1. Subjekti i rivlerësimit Saimir Smaka, në parashtrimet për rezultatet e hetimit administrativ nuk ka dhënë shpjegime për barrën e provës së kaluar prej Komisionit lidhur me këtë çështje. Në seancën dëgjimore, lidhur me respektimin e afatit të marrjes së vendimit, ka shpjeguar se deri në vitin 2017, afati ligjor 30-ditor, brenda të cilit prokurori duhej të shprehej për mosfillimin apo për regjistrim procedimi penal, parashikohej nga udhëzimi administrativ i Prokurorit të Përgjithshëm. Me ndryshimet e reja ligjore, Kodi i Procedurës Penale ka parashikuar afatin 15-ditor dhe, sipas tij, udhëzimi administrativ i Prokurorit të Përgjithshëm ka rënë nga fuqia dhe se në këtë rast nuk ka kryer ndonjë shkelje ligjore. Pyetjes nëse e ka zbatuar Udhëzimin e Prokurorit të Përgjithshëm kur ishte në fuqi, subjekti i është përgjigjur se e ka zbatuar në shumicën e rasteve dhe për pyetjen vijuese në sa raste mund të mos e ketë zbatuar ka shpjeguar se [...] në raste përjashtimore, kryesisht në këto vepra penale p.sh., përdorimi me keqdashje i thirrjeve telefonike sepse në rast se ankuesi nuk heq dorë duhet të marrësh tabulatet dhe ato zgjasin mbi 15 ditë [...] akti administrativ nuk ka atë fuqi juridike që ka akti ligjor [...] ⁷⁴. Lidhur me komunikimin e vendimit të mosfillimit ankuesit, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se prokurori e dorëzon vendimin në sekretari, siç bën gjyqtari dhe njoftimi i palëve kryhet nga ftuesi gjyqësor dhe sekretaria gjyqësore.

38.2. Trupi gjykues, së pari konstaton se ndryshe nga qëndrimi në seancë dëgjimore, në ankim, subjekti e pranon shkeljen procedurale të kryer lidhur me tejkalimin e afatit ligjor të marrjes së vendimit, duke dëshmuar edhe në këtë rast mungesë konsistence në qëndrimet e tij, sikundër vijimisht gjatë procesit të tij të rivlerësimit. Trupi gjykues çmon të sjellë në vëmendje se për shkak të boshllëkut ligjor në Kodin e Procedurës Penale në fuqi në kohën e dhënies së vendimit, praktikat lidhur me kryerjen e verifikimit të kallëzimit përpara se prokurori të vendosë për zgjidhjen ligjore të çështjes janë disiplinuar nga Prokurori i Përgjithshëm me Udhëzimin nr. 241, datë 21.11.2005, i ndryshuar ⁷⁵. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, përpara ndryshimeve me ligjin nr. 76/2016, në nenin 148/2 sanksiononte: “*Prokuroret janë të organizuar dhe funksionojnë pranë sistemit gjyqësor si një organ i centralizuar*”. Për rrjedhojë, zbatimi i Udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm, nxjerrë me synim garantimin e mbarëvajtjes së procedimeve penale dhe sigurimin e garancive për palët për kërkimin e së drejtës së tyre, përbente detyrim kushtetues dhe ligjor për subjektin e rivlerësimit. Duke nënvizuar deklarimin e subjektit se *udhëzimin e Prokurorit të Përgjithshëm e ka zbatuar në shumicën e rasteve*, trupi gjykues konstaton pohimin prej vetë atij të kryerjes së kësaj shkelje, në mënyrë të përsëritur, të vazhduar dhe të vullnetshme. Duke mbajtur në konsideratë se udhëzimi parashikonte se prokurori duhet të marrë vendim brenda afatit maksimal 30-ditor nga data e mbërritjes së kallëzimit apo referimit të veprës penale ⁷⁶, tejkalimin

⁷⁴ Shih faqen 39 të procesverbalit të seancës dëgjimore në Komision, datë 05.07.2021.

⁷⁵ I ndryshuar me udhëzimin nr. 2, datë 27.10.2006 dhe udhëzimin nr. 3, datë 19.06.2012, të Prokurorit të Përgjithshëm.

⁷⁶ Udhëzimi nr. 241, datë 21.11.2005, i ndryshuar, në pikën 2 të tij parashikon: “2.1 Në rastet kur me gjendjen e akteve prokurori vlerëson se ekzistojnë rrethana që nuk lejojnë fillimin e procedimit, vendos mosfillimin e procedimit, por jo më vonë se 10 ditë nga mbërritja e kallëzimit apo referimit të veprës penale. Gjatë kësaj periudhe nxitet të bëhet një minimum verifikimesh nëse ka nevojë për një gjë të tillë, në të kundërt vendoset regjistrimi i procedimit. 2.2 Në raste të veçanta, kur me gjithë verifikimet e kryera në afatin e përcaktuar – në pikën 2.1 të sipërpërmendur, prokurori vlerëson se është e domosdoshme të kryhen verifikime të tjera për ekzistencën e elementeve thelbësore të faktit dhe/ose të elementeve të figurës së veprës penale, afati i verifikimit të kallëzimit penal dhe/ose njoftimit të veprës penale të

e afatit, në këtë rast për më shumë se shtatë muaj, me pretendimet *për ngarkesë të punës* dhe se *mosrespektimi i afatit nuk ka sjellë pasojë*, vlerësohen nga trupi gjykues si përpjekje për të justifikuar shkeljen e kryer, me pasojë cenimin e garancive të palëve për kërkimin e të drejtës së tyre. Moskryerja e asnjë veprimi për një periudhë tejet të gjatë, 8-mujore, në shkelje flagrante të detyrimeve ligjore procedurale penale, vlerësohet nga trupi gjykues si një sjellje e pajustificuar që ka passjellë pasoja për palët në procedim dhe dëmtim të imazhit të prokurorit si funksionar i drejtësisë.

38.3. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se vendimi i pushimit *është marrë padyshim pas tërheqjes së ankimit dhe në njërin nga dokumentet duhet të ketë padyshim një lapsus në datën e tij*, nga shqyrtimi i akteve në dosje trupi konstaton dhe vlerëson si vijon.

- Me urdhrin datë 08.07.2015, prokurori Saimir Smaka ka urdhëruar kryerjen e veprimeve hetimore nga policia gjyqësore, ndër të tjera, lidhur me: (i) pyetjen e shtetasit R. S. nëse ka pasur në vijimësi thirrje telefonike dhe nëse jo t'i merret heqja dorë nga ankimi penal; (ii) të administrohen nga kompania celulare të dhënat mbi tabulatet telefonike. Me këtë urdher, prokurori ka kërkuar paraqitjen e relacionit së bashku me fashikullin e hetimit brenda datës 28.07.2015, si dhe të arsyetohet në relacion për rastet dhe arsyet e moskryerjes së detyrave.
- Më datë 09.07.2015, Drejtuesi i Prokurorisë ka kërkuar informacion (urgjent) nga kompania celulare {***} për numrin e telefonit {***}, praktikën e regjistrimit të numrit, tabulatet telefonike nga data 01.11.2014 etj. Në po këtë datë, dosja hetimore është përcjellë për veprim pranë Komisarariatit të Policisë.
- Më datë 15.07.2015, oficeri i policisë gjyqësore ka mbajtur procesverbal për tërheqjen nga ankimi të ankuesit R. S. dhe me shkresë të po të njëjtës datë, Komisarati i Policisë Vlorë ka dërguar pranë prokurorisë dosjen e deleguar për kryerje të veprimeve hetimore, me lëndë “Dërgojmë dosjen hetimore nr. {***}, *sugjeruar për pushim*”.

38.4. Nga sa më sipër, duket e vështirë që në procesverbalin e oficerit të policisë gjyqësore të ketë gabim material në datën e pasqyruar (15.07.2015), për sa nga përcjellja e dosjes hetimore në datën 09.07.2015, kryerja e veprimeve dhe procedurave për pyetjen e ankuesit, me banim në një fshat të Vlorës dhe dokumentimi i tërheqjes së tij nga ankimi, kërkojnë kohë fizike. Përpos kësaj, po në datën 15.07.2015, që figuron në procesverbalin për tërheqjen nga ankimi të ankuesit, është bërë përcjellja e dosjes në prokurori, me shkresën me ekstremitetet përkatëse, për rrjedhojë, duket e vështirë që në të njëjtën datë prokurori të kishte mundësinë e kohës fizike për të arsyetuar vendimin e mosfillimit. Nga ana tjetër, në “Formularin e kontrollit të ushtruar”, datë 21.07.2015, pjesë e dosjes, firmosur nga subjekti i rivlerësimit/prokuror i çështjes dhe Zv/Drejtuesi i Prokurorisë, në kuadër të kontrollit nga prokurori më i lartë si garanci për bazueshmërinë e

marrë me iniciativën e tij, të jetë në maksimum deri në 30 ditë. 2.3 Gjatë periudhës 30-ditore, të parashikuar në pikën 2.2 të këtij udhëzimi, prokurori kryen vetëm verifikime në lidhje me rrethanat që lejojnë ose nuk lejojnë fillimin e procedimit penal. Gjatë kësaj periudhe, prokurori nuk kryen veprime hetimore nga ato të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale”.

argumentimit të vendimit, si datë e përfundimit të çështjes pasqyrohet 10.07.2015, duke zbehur, por jo përjashtuar, mundësinë që në vendimin e prokurorit të ketë gabim material sa i përket datës.

38.5. Lidhur me njoftimin e vendimit, së pari trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit se *afati i përcaktuar në nenin 291 ka të bëjë me të drejtën e ankimit dhe jo me kohën kur duhet të kryhet njoftimi* është i pabazuar. Ligji procedural penal i kohës, në kuadër të garantimit të të drejtave të personit të dëmtuar nga vepra penale, parashikonte detyrimin e njoftimit menjëherë të vendimit të mosfillimit të procedimit penal⁷⁷. Dispozitat procedurale penale, në fuqi në kohën e dhënies së vendimit, përcaktojnë qartë përgjegjësinë e prokurorit edhe në drejtim të respektimit të afateve ligjore të njoftimit të vendimit⁷⁸, si dhe parashikojnë edhe njoftimin e vendimit nga sekretaria gjyqësore, përmes shërbimit postar⁷⁹. Në përmbyllje, trupi gjykues çmon se, përderisa nga aktet në dosje, kontrolli i vendimit është ushtruar nga prokurori më i lartë në datën 21.07.2015, pas të cilit vendimi mund të njoftohej, mbeten të paqarta rrethanat lidhur me përgjegjësitë për respektimin e afateve të njoftimit të vendimit.

38.6. Në përfundim, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka respektuar Udhëzimin e Prokurorit të Përgjithshëm nr. 241, datë 21.11.2005, i ndryshuar, duke tejkaluar pa shkaqe të përligjura, në periudha të paarsyeshme, afatin e marrjes së vendimit të mosfillimit, për rrjedhojë, pretendimi i tij lidhur me këtë konkluzion, në raport me procedimin penal nr. {***}, datë 26.11.2014, vlerësohet i pabazuar.

- 39.** Lidhur me procedimin penal nr. {***}, datë 15.02.2016, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, regjistruar për veprën penale “vjedhje”⁸⁰, për të cilin, pas kryerjes së të gjithë veprimeve hetimore, më datë 28.07.2016, subjekti ka vendosur pushimin e çështjes, Komisioni ka konkluduar: *“(a) Vendimi i pushimit nuk është plotësisht i arsyetuar dhe baza ligjore në vendim nuk është referuar saktë. (b) Subjekti ka vonuar kryerjen e veprimeve hetimore dhe ka zvarritur pa shkak këtë procedim. (c) Në dosje mungojnë vendimet e prokurorit për zgjatjen e afatit të hetimit në zbatim të neneve 323 dhe 324 të Kodit të Procedurës Penale. (ç) Vendimi datë 28.7.2016, “Për pushimin e çështjes” i është komunikuar kallëzuesit, në tejkallim të afatit 5-ditor të parashikuar nga neni 328/2 Kodit të Procedurës Penale”.*

⁷⁷ Kodi i Procedurës Penale, në fuqi në kohën e dhënies së vendimit prej subjektit të rivlerësimit, në nenin 291 të titulluar “Vendimi për mosfillimin e procedimit” parashikonte: “1. Kur ekzistojnë rrethanat që nuk lejojnë fillimin e procedimit, prokurori jep vendim të arsyetuar për mosfillimin e procedimit. 2. Vendimi u njoftohet menjëherë atyre që kanë bërë kallëzim ose ankim, të cilët mund ta kundërshtojnë atë në gjykatë, brenda pesë ditëve nga njoftimi i vendimit”.

⁷⁸ Kodi i Procedurës Penale, në fuqi në kohën e dhënies së vendimit prej subjektit të rivlerësimit, në nenin 24 parashikonte “Prokurori ushtron ndjekjen penale, bën hetime, kontrollon hetimet paraprake, ngre akuzë në gjykatë dhe merr masa për ekzekutimin e vendimeve në përputhje me rregullat e caktuara në këtë Kod”.

⁷⁹ Kodi i Procedurës Penale në fuqi në kohën e dhënies së vendimit, në nenin 134 të titulluar “Njoftimi i akteve të prokurorit”, parashikonte: “1. Njoftimi i akteve të prokurorit, gjatë hetimeve paraprake bëhet nga policia gjyqësore ose nëpërmjet shërbimit postar në format e parashikuara nga neni 133. 2. Dorëzimi i kopjes së aktit të interesuarit nga ana e sekretarisë ka vlerën e njoftimit. Dorëzuesi shënon në origjinalin e aktit faktin e dorëzimit dhe datën”.

⁸⁰ Dosja nr. 2, e përzgjedhur sipas një sistemi rastësor dhe objektiv.

39.1. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se për sa në këtë rast nuk ka fakt penal, pasaktësitë në arsyetim kanë rëndësi të papërfillshme në procesin e tij të rivlerësimit, pasi gabimi në arsyetim në një rast sporadik, edhe sikur të ketë ndodhur nuk përbën shkelje sipas parashikimeve të ligjit nr. 96/2016. Edhe për këtë rast, subjekti i rivlerësimit Saimir Smaka pretendoi se Kodi i Procedurës Penale nuk ka parashikuar asnjëherë afat pesëditor të njoftimit të vendimit nga marrja e tij.

39.2. Nga aktet në dosjen penale, trupi gjykues konstaton se për këtë procedim penal të regjistruar për veprën penale “vjedhje”, parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal, subjekti i rivlerësimit, dy muaj pas regjistrimit të tij, në datën 07.04.2016, ka urdhëruar kryerjen e veprimeve hetimore dhe pas kryerjes së tyre, në datën 28.07.2016, në bazë të nenit 328 pikat 1, germa “b” dhe “d” të Kodit të Procedurës Penale, ka vendosur pushimin e çështjes, sepse fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale dhe ekziston një shkak që nuk lejon ushtrimin e ndjekjes penale.

39.3. Trupi gjykues, edhe në këtë rast, konstaton se subjekti i rivlerësimit Saimir Smaka nuk ka dhënë shpjegime në parashtrimet për rezultatet e hetimit administrativ, por vetëm në seancë dëgjimore. Sa i përket arsyetimit të vendimit, trupi gjykues konstaton se në ankim, me parashtrimin që *nuk ka fakt penal*, subjekti vjen me një qëndrim të kundërt nga sa është shprehur në seancën dëgjimore [...] i qëndron idesë që jemi para institutit të heqjes dorë nga kryerja e veprës penale, pasi e ka analizuar shumë mirë atë dhe ka konstatuar që jemi përpara heqjes dorë në mënyrë vullnetare, personi që dyshohej për vjedhje e ka marrë në telefon kolegun por telefoni ka qenë i fikur [...] ⁸¹.

39.4. Në referim të rrethanave të faktit, të cituara edhe nga vetë subjekti në seancë dëgjimore - *i dyshuari i ka marrë sendet për të punuar në shtëpi dhe nuk ka mundur të njoftojë kolegun për shkak se ky i fundit e ka pasur telefonin të fikur* - trupi gjykues konstaton mungesë të anës objektive dhe subjektive për kryerjen e vjedhjes dhe, për më tepër, kontradiktoritet në arsyetimin e vendimit të pushimit të procedimit penal. Në referim të fakteve të rezultuara nga hetimi penal, rezulton se veprimet e personit ndaj të cilit janë zhvilluar hetimet nuk kanë pasur qëllime kriminale duke e zhveshur veprimin e tij nga ana subjektive e veprës së vjedhjes, për pasojë arsyetimi duhej të mbështetej vetëm në parashikimin e nenit 328, pika 1, germa “b” e Kodit të Procedurës Penale. Arsyetimi dhe përdorimi prej prokurorit si bazë ligjore edhe të germës “d” të kësaj pike, mbi argumentin se personi ka hequr dorë nga kryerja e veprës penale, bie ndesh logjikisht me përfundimin e mësipërm të arritur po prej tij. Në këto kushte, pretendimi i tij se Komisioni ka gabuar në konkluzionin lidhur me këtë çështje gjendet i pabazuar.

39.5. Në ankim, subjekti i rivlerësimit Saimir Smaka nuk ngriti pretendime lidhur me konkluzionin e Komisionit se *në dosje mungojnë vendimet e prokurorit për zgjatjen e afatit të hetimit në zbatim të neneve 323 dhe 324 të Kodit të Procedurës Penale*, për të cilin në seancë dëgjimore ka shpjeguar [...] se *personat kanë qenë pa masë sigurimi, pra, janë gjykuar në gjendje të lirë, thjesht të dyshuar dhe nuk ishte e domosdoshme që të merrej vendim për zgjatje afati hetimi*

⁸¹ Shih faqen 22 të procesverbalit të seancës dëgjimore

[...]. Trupi gjykues vlerëson se edhe ky qëndrim i subjektit vjen në kundërshtim me parashikimet e ligjit procedural penal, për zgjatjen e afatit të hetimit në rastet e hetimeve komplekse ose të pamundësisë objektive për t'i përfunduar brenda afatit të caktuar pavarësisht masës së sigurisë së personit nën hetim, dhe se kjo zgjatje e afatit bëhet detyrimisht vetëm nëpërmjet vendimit përkatës.

39.6. Lidhur me afatin ligjor të njoftimit të vendimit të pushimit, trupi gjykues konstaton se me ligjin nr. 35, datë 30.03.2017, në nenin 328 i Kodit të Procedurës Penale⁸², u shtua pika 2 me përmbajtje: *“Prokurori, brenda 5 ditëve nga marrja e vendimit të pushimit, njofton të pandehurin, mbrojtësin e tij, viktimën ose trashëgimtarët e saj kur identiteti dhe vendbanimi i tyre rezultojnë nga aktet e procedimit, si dhe personin që ka bërë kallëzim ose ankim duke u bërë të ditur të drejtën për t’u njohur me aktet, për të marrë kopje të tyre dhe për të paraqitur ankim në gjykatë”*. Duke konsideruar se në datën e dhënies së vendimit prej subjektit më 28.07.2016, Kodi i Procedurës Penale në fuqi⁸³ nuk parashikonte afatin për njoftimin e vendimit të pushimit, trupi gjykues e vlerëson këtë pretendim të subjektit të bazuar.

39.7. Në përfundim, lidhur me procedimin penal nr. {***}, datë 15.02.2016, regjistruar për veprën penale të “vjedhjes”, trupi gjykues vlerëson të drejtë konkluzionet e Komisionit sa i përket mosarsyetimit plotësisht dhe mosreferimit të saktë të bazës ligjore në vendimin e pushimit, për vonesa në kryerjen e veprimeve hetimore dhe zvarritjen pa shkak të tij. Për rrjedhojë, pretendimet e subjektit, lidhur me këto konkluzione të Komisionit, vlerësohen prej trupit gjykues të pabazuara.

40. Lidhur me procedimin penal nr. {***}, datë 10.02.2016, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë⁸⁴, regjistruar për veprën penale *“përdorim me keqdashje të thirrjeve telefonike”* (neni 275 i Kodit Penal), pushuar me vendim prej subjektit të rivlerësimit më datë 02.03.2016, për të cilin Komisioni ka konkluduar se *vendimi i është komunikuar personit që ka bërë kallëzimin në datën 04.05.2016, në tejkallim të afatit 5-ditor të parashikuar nga neni 328/2 Kodit të Procedurës Penale*, subjekti pretendoi se Kodi i Procedurës Penale nuk ka parashikuar asnjëherë afat pesëditor njoftimi nga momenti i marrjes së vendimit të pushimit. Për sa analizuar në paragrafin 39.6, lidhur me parashikimet e ligjit procedural penal në fuqi në kohën e dhënies së vendimit, trupi gjykues e vlerëson pretendimin e subjektit të rivlerësimit të drejtë.

41. Lidhur me procedimin penal nr. 826/2014, *“mashttrim në dëm të disa personave”* dhe *“falsifikim i dokumenteve”*⁸⁵, Komisioni ka konkluduar: (a) subjekti ka zvarritur hetimet paraprake pa pasur

⁸² Ligji nr. 35/2017 *“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.03.1995, “Kodi i procedurës penale i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”, në nenin 182, parashikon: “Në nenin 328 bëhen këto ndryshime dhe shtesa: Titulli ndryshohet si më poshtë “Pushimi i akuzës ose çështjes”. Pika 1 ndryshohet si më poshtë: “1. Në përfundim të hetimeve paraprake, kur procedohet për kundërvajtje penale, prokurori vendos pushimin e akuzës ose çështjes kur [...]”. Pas pikës 1 shtohet pika 2 me këtë përmbajtje: “2. Prokurori, brenda 5 ditëve nga marrja e vendimit të pushimit, njofton të pandehurin, mbrojtësin e tij, viktimën ose trashëgimtarët e saj kur identiteti dhe vendbanimi i tyre rezultojnë nga aktet e procedimit, si dhe personin që ka bërë kallëzim ose ankim, duke u bërë të ditur të drejtën për t’u njohur me aktet, për të marrë kopje të tyre dhe për të paraqitur ankim në gjykatë”*.

⁸³ Ligji nr. 35/2017, në nenin 286 të tij parashikon: *“Ky ligj hyn në fuqi në datën 1 gusht 2017”*.

⁸⁴ Dosja nr. 3, e përzgjedhur sipas një sistemi rastësor dhe objektiv.

⁸⁵ Sipas informacionit nga Prokuroria e Përgjithshme, dërguar në Komision, me shkresën nr. {***} prot., datë 22.10.2019, rezulton se gjatë viteve 2006-2019 për subjektin e rivlerësimit Saimir Smaka kanë ardhur tri praktika me

arsye ligjore; (b) vendimet për shtyrjen e afatit të hetimit nuk i janë njoftuar të pandehurit dhe kallëzuesit, sipas përcaktimit të nenit 324, pika 3 e Kodit të Procedurës Penale.

41.1. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se kohëzgjatja e hetimeve paraprake 1 vit e 11 muaj është diktuar prej kompleksitetit të çështjes, dinamikës dhe numrit të konsiderueshëm të veprimeve hetimore, ndjekur me vigjilencën e duhur në kushtet e ngarkesës së lartë në Prokurorinë e Vlorës dhe në përfundim të tyre dosja është dërguar për gjykim për veprat penale “*mashttrim në dëm të disa personave*” dhe “*falsifikim i dokumenteve*”, parashikuar nga nenet 143/2 dhe 186/1 të Kodit Penal, me të pandehur shtetasin R. I.. Më tej, subjekti parashtroi dinamikën e shqyrtimit gjyqësor të çështjes, shqyrtim që vijon nga një tjetër trup gjykues në Gjykatën e Rrethit Vlorë, pas vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë⁸⁶.

41.2. Nga aktet në fashikuj, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se edhe për këtë procedim penal, shpjegimet lidhur me barrën e provës subjekti i ka dhënë vetëm në seancën dëgjimore, ku lidhur me konstatimin e Komisionit se vendimet për shtyrjen e afatit të hetimit nuk i janë njoftuar të pandehurit dhe kallëzuesit, sipas përcaktimit të nenit 324, pika 3 e Kodit të Procedurës Penale, ka shpjeguar se [...] *njoftimet nuk janë punë e prokurorit por e ftuesit gjyqësor, prokurori e dorëzon vendimin në sekretari, ashtu siç bën gjyqtari, ka ftues gjyqësor dhe sekretari gjyqësor e cila merret me njoftimin e palëve [...]*⁸⁷ se e ka thirrur disa herë personin nën hetim, nëpërmjet telefonit, ka procesverbal për urdhër për paraqitjeje, por nuk është paraqitur, i ka dërguar shkresë Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, por kjo e fundit nuk e ka arritur ta shoqërojë e ka

*ankesa nga shtetasit S. M., M. M. dhe G. M.. Fashikulli i procedimit penal nr. {***}, i administruar nga Komisioni, i përket ankesës së shtetasit S. M. regjistruar në Prokurorinë e Përgjithshme sipas praktikës nr. {***}. Shtetasi S. M. është ankuar lidhur me procedimin penal nr. {***}, se hetimet janë zvarritur prej dy vjetësh pasi prokurori Saimir Smaka nuk kryente veprimet hetimore.*

⁸⁶ Subjekti parashtroi si vijon:

- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. {***}, datë 11.02.2015, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së prokurorit për caktimin e masës së sigurimit “*arrest me burg*” ndaj shtetasit R. I., duke vlerësuar se ana e prokurorit duhej të kryej ekspertim teknik-topografik nëse kishte mbivendosje të pronave për të cilat ishte dhënë leje ndërtimi nga Bashkia Vlorë.
- Pas ankimit të Prokurorit, Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. {***}, datë 17.03.2015, ka vendosur ndryshimin e vendimit të mësipërm duke caktuar masën e sigurimit “*arrest me burg*” ndaj shtetasit nën hetim R. I.
- Në datën 18.04.2016 është marrë në cilësinë e të pandehurit shtetasi R. I. duke e akuzuar për veprat penale “*mashttrim në dëm të disa personave*” dhe “*falsifikim i dokumenteve*”, parashikuar nga nenet 143/2 dhe 186/1 të Kodit Penal.
- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. {***}, datë 15.11.2016, të ka vendosur pushimin e çështjes penale në ngarkim të të pandehurit pasi sipas trupës është konstatuar pavlefshmëri absolute në vendimmarrjen e organit të akuzës.
- Pas ankimit të Prokurorit, Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. {***}, datë 01.06.2017, ka vendosur prishjen e vendimit nr. {***}, datë 15.11.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe kthimin e akteve pranë kësaj gjykate për rigjykim me një trup tjetër gjykues duke arsyetuar se nuk konstatohen elementë të pavlefshmërisë absolute dhe asaj relative në vendimmarrjen e prokurorisë dhe se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë nuk ka kryer një hetim gjyqësor të plotë në lidhje me akuzat në ngarkim të të pandehurit R. I. për veprat penale “*mashttrim në dëm të disa personave*” dhe “*falsifikim i dokumenteve*”, parashikuar nga nenet 143/2 dhe 186/1 të Kodit Penal.
- Pas paraqitjes së rekursit nga i pandehuri R. I. në Gjykatën e Lartë, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë me vendim nr. {***}, datë 19.11.2020, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi R. I. kundër vendimit nr. {***}, datë 01.06.2017, të Gjykatës së Apelit Vlorë.

⁸⁷ Shih faqen 22 të procesverbalit të seancës dëgjimore, paragrafi i I-rë.

marrë vendim mosgjeteje. Subjekti ka shpjeguar se i ka kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore, të cilat ia ka njoftuar të gjitha personit dhe më vonë avokatit të tij të zgjedhur kryesisht⁸⁸.

41.3. Nga shqyrtimi i akteve në dosjen hetimore, trupi gjykues i Kolegjit konstaton katër vendime të subjektit të rivlerësimit për zgjatjen e afateve të hetimit me nga tre muaj, marrë për arsye të kërkimit të akteve nga disa institucione, pyetjes së dëshmitarëve etj. Pavarësisht numrit të konsiderueshëm të veprimeve hetimore dhe volumit të madh të akteve të administruara nga subjekti, provohet moskryerja e asnjë veprimi hetimor, pa shkaqe të përligjura në disa periudha, në total 11 muaj. Konkretisht, periudha e parë 5 muaj [nga data 15.5.2014, kur regjistrohet procedimi penal, deri në datën 13.10.2014 kur është mbajtur nga prokurori akti i parë hetimor “procesverbali për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale”]; dy periudha 3-mujore në vijim [nga data 30.6.2015 kur është mbajtur “procesverbal i pyetjes së ekspertës teknike” deri në datën 21.9.2015 kur është mbajtur “procesverbali për kërkimin e personit që nuk gjendet R. I.; dhe nga data 21.9.2015 deri në datën 16.12.2015 kur është mbajtur “procesverbali për kërkimin e personit që nuk gjendet R. I.]. Për sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se moskryerja e veprimeve hetimore për një periudhë 11-mujore në total, përbën mos përmbushje të rregullt të detyrës dhe cenon të drejtat e palëve në proces.

41.4. Nga përmbajtja e vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë⁸⁹, trupi gjykues konstaton se objekt gjykimi ka qenë edhe *respektimi i dispozitave procedurale, në lidhje me njoftimin e të pandehurit që nuk gjendet dhe, më pas, me njoftimin e vendimeve të zgjatjes së afatit të hetimeve*. Konkretisht, shtetasi R. I. rekursin në Gjykatën e Lartë e ka bazuar në pretendimet: (i) personi nën hetim nuk është njoftuar asnjëherë për veprimet procedurale që ka kryer prokuroria pas regjistrimit të emrit të autorit datë 09.02.2015; (ii) vendimet për zgjatjen e afateve të hetimeve paraprake janë vendime absolutisht të pavlefshme, në kundërshtim me nenet 128/1/c dhe 324/3 të K.Pr.Penale, pasi nuk i janë njoftuar të pandehurit apo mbrojtësit të tij; (iii) të gjitha veprimet hetimore të kryera pas urdhrimit për regjistrimin e autorit të veprës penale datë 09.02.2015 janë absolutisht të pavlefshme; (iv) nuk ekziston në dosjen e prokurorisë asnjë njoftim apo komunikim të akteve procedurale që duhet të bënte prokurori në momentin që ka marrë dijeni që personi nën hetim ka pasur avokat të zgjedhur [gjatë gjykimit në Gjykatën e Lartë, R. I. ka qenë me avokat të zgjedhur, z. A. V.]; (v) nuk ekziston në dosje ndonjë ftesë për paraqitje në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Vlorë drejtuar të pandehurit në gjendje të lirë apo procesverbal për njoftimin e personit nën hetim; (vi) nga ana e prokurorisë nuk janë zbatuar si duhet kërkesat ligjore për njoftimin e personit në gjendje të lirë, sipas nenit 140 të K.Pr.Penale. Procesverbalet për kërkimin e personit që nuk gjendet janë absolutisht të pavlefshëm për faktin se nuk janë nënshkruar nga personat që kanë deklaruar se personi është larguar⁹⁰.

⁸⁸ Shih faqen 23 të procesverbalit të seancës dëgjimore.

⁸⁹ Shih http://www.gjykataelarte.gov.al/gjl_ceshtje_detaje.php?caseId_sel=2017-08982&ln=Lng1&uni=20231031150109134059

⁹⁰ Shih vendimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 365, datë 19.11.2020, faqe 4, pika 4.

41.4.1. Trupi gjykues, duke mbajtur në konsideratë faktin se qëndrimet e Komisionit lidhur me mosrespektimin e rregullave procedurale që lidheshin me njoftimin e vendimeve të zgjatjes së afatit të hetimeve, përfaqësojnë çështje që lidhen me zbatimin e ligjit, e vlerëson të mjaftueshëm qëndrimin që ka mbajtur Gjykata e Lartë në përgjigje të rekursit të përshkruar më sipër, për t'i dhënë përgjigje pretendimeve të subjektit në ankim lidhur me to. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në arsyetimin e tij, si më poshtëreferuar, ka arsyetuar rreth qartësisimit të situatës faktike dhe sjelljes së prokurorit në raport me ligjin procedural penal:

[...] nga ana e Prokurorisë janë përmbushur detyrimet për njoftimin e personit nën hetim konform dispozitave procedurale të parashikuara nga nenet 140-141 të Kodit të Procedurës Penale. Rezulton se njoftimet për personin nën hetim janë dërguar në adresën e lënë prej tij kur i janë marrë deklaratimet në fazën e hetimeve paraprake. Në këtë adresë, personi nën hetim nuk është gjetur, pas disa përpjekjeve rresht nga ana e organit procedues, siç provohet nga aktet e ndodhura në dosje. Në këto kushte, nga prokuroria është kaluar në njoftimin e të pandehurit, sipas parashikimeve të nenit 141 të Kodit të Procedurës Penale, ku është urdhëruar kërkimi i të pandehurit. Duke qenë se kërkimi i të pandehurit nuk ka dhënë rezultat pozitiv, atëherë nga organi procedues është nxjerrë vendimi i mosgjetyes dhe të pandehurit i është caktuar një mbrojtës kryesisht. Njoftimi i akteve procedurale pas këtij momenti është kryer me anë të njoftimit mbrojtësit të caktuar kryesisht. Në kushtet kur njoftimi i shtetasit R. I. ka qenë i pamundur të realizohej në adresën e tij, me gjithë kërkimet e policisë gjyqësore, prokurori ka vazhduar më tej me vendimin e mosgjetyes e caktimin e mbrojtësit kryesisht, vendim ky i datës 11.01.2016. Më tej, akti i njoftimit të akuzës e kërkesa për gjykim i janë njoftuar mbrojtësit kryesisht në datën 18.04.2016, nga organi i akuzës janë respektuar dispozitat procedurale në lidhje me njoftimin e personit nën hetim, por ka qenë ai (personi nën hetim R. I.) që në fakt i është shmangur procedimit penal në ngarkim të tij, duke marrë në këtë mënyrë pozitën e personit që nuk gjendej. Në kushtet kur janë 6 procesverbale për kërkimin e tij, në adresën që vet ky shtetas ka lënë pranë organit procedues kur i janë marrë deklaratimet, ai nuk mund të pretendojë se nuk është njoftuar për procedimin penal në ngarkim të tij, pasi rezulton qartë se jo vetëm që ka pasur dijeni por i është shmangur këtij procedimi [...]⁹¹.

Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se, nën dritën e konkluzioneve të mësipërme marrë nga Gjykata e Lartë si një gjykatë ligji, nuk mund të konfirmohen qëndrimet e Komisionit lidhur me njoftimin e vendimeve për zgjatjen e afateve të hetimit, personit nën hetim.

41.5. Në përmbledhje të sa më sipër, lidhur me procedimin penal nr. {***}, regjistruar për veprat penale “*mashttrim në dëm të disa personave*” dhe “*falsifikim i dokumenteve*”, trupi gjykues vlerëson të bazuar konkluzionin e Komisionit lidhur me zvarritjet të hetimeve paraprake pa shkaqe të arsyeshme ligjore.

⁹¹ Shih vendimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 365 datë 19.11.2020, pikat 11-14.

42. Lidhur me procedimin penal nr. 1912/2015, regjistruar për veprën penale “*dhuna në familje*”⁹², Komisioni ka konkluduar: “(a) *Subjekti për 7 muaj nga data e regjistrimit të kallëzimit nuk ka kryer asnjë veprim në lidhje me këtë material hetimor, duke mos e regjistruar. Si rrjedhojë, ka vepruar në kundërshtim me nenin 287 të Kodit të Procedurës Penale dhe udhëzimin nr. 241, datë 21.11.2005, të Prokurorit të Përgjithshëm. (b) Subjekti i rivlerësimit ka kërkuar vendosjen e masës së sigurimit personal pas 14 muajsh nga dita e regjistrimit të kallëzimit penal dhe në kundërshtim me kriteret e përcaktuara nga nenet 228, 229 dhe 230 të Kodit të Procedurës Penale, duke kufizuar kështu në mënyrë të padrejtë lirinë e personit*”.

42.1. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se ka pasur prova të mjaftueshme për të vlerësuar se ndodhemi përpara elementëve të figurës së veprës penale “*dhuna në familje*” parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal, kohëzgjatja e hetimeve paraprake, 7 muaj e 22 ditë, është diktuar për shkak të ripyetjes së palëve të përfshira në konfliktin familjar, i pandehuri nuk ka kërkuar aplikimin e gjykimit të shkurtuar dhe se vendimet dhe kërkesat e paraqitura prej tij janë marrë mbi bazë të bindjes së brendshme. Sipas subjektit, ka çmuar në momentin kur atij ju krijua bindja se shtetasi nën hetim kishte kryer veprën penale dhe kërkesa e tij për vendosjen e masës së sigurimit “*arrest me burg*” është shqyrtuar nga Gjykata, e cila nuk ka qenë në një mendim me të, nuk ka caktuar masë dhe, në këto kushte, nuk mund të konkludohet se personit nën hetim i është cenuar liria.

42.2. Trupi gjykues, së pari konstaton se edhe për këtë procedim penal, për barrën e provës subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegimet vetëm në seancë dëgjimore⁹³. Gjithashtu, edhe në këtë rast konstatohet ndryshimi i qëndrimit të subjektit sa i përket *kohëzgjatjes së hetimeve paraprake, 7 muaj e 22 ditë, në seancën dëgjimore në Komision ka shpjeguar se ka pasur një kohëzgjatje relativisht të gjatë për shkak të ngarkesës relativisht të madhe në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe ngarkesës së madhe me çështje të tij, në ankim pretendon se është diktuar për shkak të ripyetjes së palëve të përfshira në konfliktin familjar. Nga aktet në dosje, dinamikat e kësaj çështje rezultojnë si vijon.*

- Në datën 04.02.2015, subjekti i rivlerësimit ka marrë në dorëzim materialin kallëzues nr. {***}, datë 04.02.2015⁹⁴. Në formularin për trajtimin e tij, Zv/Drejtuesi i Prokurorisë shprehet [...] *mendoj se në lidhje me këtë material duhet të kryhen verifikime në lidhje me kryerjen e veprës*

⁹² *Fashikulli i procedimit penal nr. {***}, i administruar nga Komisioni, i përket ankesës së shtetasve M. M. dhe V. M. regjistruar në Prokurorinë e Përgjithshme, sipas praktikës nr. {***}. Ankuesit janë ankuar se: “Prokurori Saimir Smaka, në çështjen nr. {***}, bën shkelje të jashtëzakonshme duke turpëruar institucionin. Ky prokuror, pasi mbante një çështje në sirtar për më se 16 muaj, e çon në gjykatë për masë arresti me burg për personin (pa asnjë hetim apo provë shtesë), gjykata me të drejtë rrëzon kërkesën e tij”.*

⁹³ *Shih procesverbalin e seancës dëgjimore, faqet 24 dhe 25. Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se: (i) ka pasur një kohëzgjatje relativisht të gjatë për shkak të ngarkesës relativisht të madhe në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe ngarkesës së madhe me çështje të tij; (ii) K.Pr.Penale nuk parashikon ndonjë moment kur Prokurori do t'i caktojë masë sigurimi personal personit, veç e lë të lirë dhe mund ta caktojë fillimisht kur e nis si procedim ose mund t'ia caktojë edhe në fund; (iii) se nuk e kupton vendimin e gjykatës që ka dhënë pafajësi, që në vlerësimin e tij është absolutisht i padrejtë, pasi vepra penale është e faktuar sepse zotëria ka qenë me raport mjeko-ligjor deri në 9 ditë, se ka bërë ankim ndaj vendimit të gjykatës por Gjykata e Apelit e ka lënë në fuqi.*

⁹⁴ *Materiali kallëzues është dërguar nga Komisariati i Policisë Vlorë, me nr. {***} prot., datë 03.02.2015 dhe në shkresë janë referuar materialet procedural të dërguara bashkëlidhur: (i) referimi I veprës penale tëk Prokurori; (ii) proces-verbal për ankimin e të dëmtuarit; (iii) vendim ekspertimi mjekoligjor; (iii) procesverbal deklarimi V. M..*

penale të parashikuar nga neni 90 i Kodit Penal dhe pas vlerësimit të rrethanave mendoj se mund të konkludosh [...].

- Në datën 21.09.2015, subjekti i rivlerësimit ka nxjerrë: (i) urdhrin për regjistrimin e procedimit penal me nr. {***}, për veprën penale “*dhuna në familje*”, parashikuar nga neni 130/a/2 i Kodit Penal; (ii) urdhrin për kryerjen e veprimeve hetimore, ndër të tjera, ripyetjen e shtetasve E. M., M. M. dhe V. M., nëse kanë ardhur në dijeni të ndonjë fakti të ri në lidhje me ngjarjen dhe autorët e saj, si dhe për paraqitjen në prokurori të relacionit përkatës, ku të shpjegohen veprimet e kryera brenda datës 20.11.2015, së bashku me fashikullin e hetimit. Dosja hetimore përcillet për veprim pranë Komisarariatit të Policisë Vlorë në datën 22.10.2015.
- Në datën 25.04.2016, në mbështetje të neneve 287/1, 315/3 dhe 485 të Kodit të Procedurës Penale, subjekti i rivlerësimit nxjerr urdhrin për regjistrimin e emrit të personit nën hetim, M. M. në kolonën përkatëse të regjistrimit të njoftimit të veprave penale për procedimin penal me nr. {***} për veprën penale “*dhuna në familje*”, parashikuar nga neni 130/a/2 i Kodit Penal.
- Në datën 28.04.2016, me vendimin nr. {***}, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur rrëzimin e kërkesës së prokurorit me objekt “*caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”*” për shtetasin M. M..
- Në datën 11.05.2016: (i) subjekti i rivlerësimit ka marrë vendim për marrjen me cilësinë e të pandehurit të shtetasit M. M., duke i njoftuar akuzën për kryerjen e veprës penale “*dhuna në familje*”, parashikuar nga neni 130/a/2 i Kodit Penal; (ii) i pandehuri M. M. është njohur me aktet e procedimit penal në ngarkim të tij, sipas “Procesverbal për njohjen e të pandehurit me aktet” dhe është marrë në pyetje nga subjekti sipas “Procesverbal i pyetjes së të pandehurit”; (iii) subjekti i rivlerësimit ka vendosur dërgimin e çështjes për gjykim Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.
- Në konkluzionet përfundimtare, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar: (i) gjykimin e çështjes në ngarkim të pandehurit M. M. për veprën penale “*dhuna në familje*”, parashikuar nga neni 130/a/2 i Kodit Penal; (ii) dënimin e tij me 6 muaj burgim; (iii) pezullimin e dënimit për pjesën e pavuajtur në bazë të nenit 59 të Kodit Penal, në vlerësim të gjykatës.
- Me vendimin nr. {***}, datë 29.01.2018, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur deklarin e pafajshëm të të pandehurit M. M.. Kundër këtij vendimi subjekti ka paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Vlorë.

42.3. Trupi gjykues i Kolegjit, edhe në këtë rast, konstaton se subjekti i rivlerësimit për 7 muaj nuk ka kryer asnjë veprim lidhur me materialin kallëzues, duke mos e regjistruar procedimin penal për hetimin e tij, veprime që vijnë në kundërshtim me Udhëzimin e Prokurorit të Përgjithshëm nr. 241, datë 21.11.2005. Nga aktet në dosje, ku përpos deklarimeve të viktimës E. M. që pretendon se është goditur me grusht nga babai i tij M. M., deklarimeve të këtij të fundit, si i pandehur, dhe bashkëshortes së tij V. M., që deklarojnë se i pandehuri nuk e ka goditur djalin e tij E. M. me grusht, konstatohet se nga dëshmia e penaltetit, i pandehuri, 68 vjeç në kohën e gjykimit, rezulton se nuk ka qenë i dënuar më parë. Nga ana tjetër, aktekspertimi mjekoligjor i datës 30.01.2015, për të dëmtuarin E. M., evidenton llojin e plagës si dëmtim i kryer me mjete të forta mprehëse dhe për shkak të goditjes, shkallën e paaftësisë në punë deri në 9 ditë.

42.3.1. Nga sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, në kërkesën e tij për caktimin e masës së sigurimit “arrest me burg” për shtetasin M. M., nuk ka zbatuar drejt dispozitat procedurale penale, nenet 228, 229, dhe 230 të Kodit të Procedurës Penale. Për masën e sigurimit “arrest me burg”, parakushti - dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova - kërkon analizën në mënyrë ezauruese se përse kjo masë gjen zbatim në çështjen konkrete. Në çdo rast kushtet *sine qua non* të parashikuara në nenin 228 të Kodit të Procedurës Penale duhet të ekzistojnë në mënyrë kumulative. Ndërsa, në vështrim të parashikimeve të nenit 229 të Kodit të Procedurës Penale, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur parasysh ekuilibrat midis rëndësisë së faktit, i cili dyshohet se është kryer nga personi nën hetim dhe masës së sigurisë të kërkuar ndaj tij, sipas rrethanave të faktit, personalitetit dhe moshës së të pandehurit, kohën e caktimit të masës së sigurimit, në përfundim të hetimeve paraprake apo marrëdhëniet e posaçme, duke shmangur interpretimin sistematik të dispozitave penale që përcaktojnë llojet e masave të sigurimit personal⁹⁵.

42.4. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se konkluzioni i Komisionit, lidhur me kohën se kur është kërkuar caktimi i masës së sigurimit, është i gabuar dhe në kundërshtim me Vendimin Unifikues nr. 7/2011, të Gjykatës së Lartë⁹⁶. Trupi gjykues i Kolegjit çmon se vendimi i sipërcituar, si një unitet, duhet lexuar i tëri në funksion të kuptimit dhe forcës detyruese të tij. Gjykata e Lartë, në këtë vendim, në interpretim të ligjit procedural penal, neneve 228, 229 dhe 230 të Kodit të Procedurës Penale, ka ardhur në përfundimin unifikues se *[...]masa e sigurimit mund të caktohet në çdo fazë të procedimit penal, sa herë që nga gjykimi del se kanë lindur, ndryshuar apo mungojnë kushtet paraprake dhe kriteret e rrezikut të parashikuara nga nenet 228 e vijues të Kodit të Procedurës Penale. Kjo gjendje “rreziku” mund të verifikohet, pra mund të lindë, ndryshojë apo mbarojë, rast pas rasti, si gjatë fazës së hetimit paraprak, ashtu edhe gjatë fazës së gjykimit. Vendimi lidhur me caktimin e masës së sigurimit apo për zëvendësimin, revokimin e shuarjen e saj jepet për gjendjen në të cilin është procedimi, për gjendjen në të cilën janë aktet, për rrethanat e faktit e të ligjit në momentin e paraqitjes së kërkesës dhe shqyrtimit të saj nga gjykata [...]*⁹⁷.

42.5. Përpos dyshimit të arsyeshëm dhe të bazuar në prova për kryerjen e veprës penale, trupi gjykues vlerëson se nuk rezulton të kenë lindur apo ndryshuar, qoftë edhe njëri nga kushtet për caktimin e masës së sigurimit personal, sipas nenit 228 të K.Pr.Penale⁹⁸, për rrjedhojë, kërkesa për caktimin e masës së sigurimit “arrest me burg” pas 14 muajsh të regjistrimit të procedimit penal,

⁹⁵ Shih nenin 232 të Kodit të Procedurës Penale.

⁹⁶ Subjekti i rivlerësimit nga Vendimi Unifikues i Gjykatës së Lartë, ka transpozuar pjesën si vijon: “Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se gjykatat më të ulëta kanë interpretuar dhe zbatuar drejt ligjin procedural penal. Masa e sigurimit mund të caktohet rishtazi edhe në fazën e gjykimit, madje nga e njëjta gjykatë që shqyrton themelin e akuzës, meqenëse, në rrethanat e çështjes objekt i këtij gjykimi, rezulton se janë përmbushur kushtet dhe kriteret për caktimin e tyre të parashikuara nga ligji procedural penal”.

⁹⁷ Shih http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Vendime_unifikuese_ne_vite_10678_1.php

⁹⁸ K.Pr.Penale, në nenin 228 të titulluar “Kushtet për caktimin e masave të sigurimit personal”, në pikën 3 të tij parashikon: “[...] 3. Masat e sigurimit personal vendosen: a) kur ekzistojnë shkaqe të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës; b) kur i pandehuri është larguar ose ekziston rreziku që ai të largohet; c) kur për shkak të rrethanave të faktit dhe personalitetit të të pandehurit ka rrezik që ai të kryejë krime të rënda ose të të njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet.

vjen në kundërshtim me nenet 229 dhe 230 të Kodit të Procedurës Penale që parashikojnë mbi nevojat e sigurimit dhe për përshtatshmërinë e masës konkrete të sigurimit duke synuar arritjen e ekuilibrit të nevojshëm për respektimin, garantimin e rendit publik e të interesit publik për dhënien e drejtësisë, me të drejtat dhe interesat ligjore të individit subjekt i procedimit, të dyja të parashikuara nga Kushtetuta.

42.6. Në përmbledhje, lidhur me procedimin penal nr. {***}, regjistruar për veprën penale “*dhuna në familje*”, trupi gjykues vlerëson të bazuar konkluzionet e Komisionit dhe, për rrjedhojë, pretendimet e subjektit të pabazuara.

43. Lidhur me procedimet penale nr. {***} dhe nr. {***}⁹⁹, Komisioni ka konkluduar për të parin se *subjekti i rivlerësimit: (a) nuk ka kryer veprimet hetimore: i. nuk ka pyetur personat që kanë dijeni për veprën penale; ii. nuk ka këqyrur dhe sekuestruar dokumentet e depozituara nga kallëzuesi, i cili pretendon se janë të falsifikuara; iii. nuk ka disponuar me vendim për kryerjen e aktekspertimit grafik të nënshkrimeve të dokumenteve shëndetësore; (b) Nuk ka administruar në dosje asnjë vendim gjykate për të provuar se rasti konkret i procedimit përbën “gjë të gjykuar”;* dhe për procedimin penal nr. {***} *subjekti i rivlerësimit: (a) Nuk ka kryer të gjitha veprimet hetimore. (b) Për një periudhë të gjatë nuk ka kryer asnjë veprim hetimor, duke zvarritur hetimet pa shkaqe ligjore.*

43.1. Lidhur me procedimin penal nr. {***}, subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime dhe prova për konstatimet e Komisionit, për rrjedhojë, bazuar në nenin 51 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i ka qëndruar konstatimeve të hetimit, bazuar në provat e disponuara nga dokumentacioni i administruar. Në ankim, subjekti i rivlerësimit pretendoi se ka marrë vendim mosfillimi duke u bazuar në bindjen e tij të brendshme se në faktet objekt kallëzimi nuk ka pasur elementë të ndonjë veprë penale. Pretendimet në lidhje me dokumentacionin e falsifikuar janë ngritur në gjykimin civil dhe janë rrëzuar nga gjykata. Kallëzimet nga palët që humbasin gjykimet civile e kanë detyruar Prokurorin e Përgjithshëm të udhëzojë prokurorët të jenë të kujdesshëm në regjistrimin e këtyre çështjeve penale. Pavarësisht bindjes se në rastin konkret nuk ka vepër penale, ka regjistruar procedimin penal për të kryer veprimet e urdhëruara nga Gjykata, por kjo është bërë e pamundur për shkak se dokumentet objekt ankimi ishin pjesë e dosjes civile që ishte në gjykim në Gjykatën e Lartë.

43.1.1. Nga shqyrtimi i akteve në dosjen e këtij procedimi penal, trupi gjykues konstaton se në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është regjistruar procedimi penal nr. {***},

⁹⁹ Komisioni i ka administruar, analizuar dhe vlerësuar këto procedime penale, sipas informacionit të Prokurorisë së Përgjithshme, praktika nr. {***}, për ankesën e shtetasit G. M. se: “[...] pasi ka bërë kallëzim penal në prokurori për falsifikim dokumentesh spitalore, prokurori i çështjes Saimir Smaka e ka pushuar çështjen me vendimin nr. {***}, datë 30.12.2014, pa bërë hetim. I drejtohem Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, gjykata vendos detyrimin e prokurorit që të bëjë hetim të orientuar në pesë pika. Prokurori e apelon dhe Gjykata Apelit lë në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë. Ka një vit e gjysmë heshtje nga prokurori, kam marrë kontakt me të dhe më tha bëj kërkesë të ma heqin dosjen [...]”. Prokuroria e Përgjithshme, nga ana e saj, i kërkon Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë që t’i japë zgjidhje ligjore rastit dhe për vendimmarrjen të njoftohet ankuasi.

mbi bazë të kallëzimit nr. {***}, datë 15.05.2014, të shtetasit G. M., i cili ka pretenduar se aktualisht po zhvillohet një proces gjyqësor civil ku ai kërkon nga shtetasi K. G. dëmshpërblim për dëmet që i ka shkaktuar. Shtetasi K. G. ka paraqitur në procesin gjyqësor një kundërpadi, duke pretenduar se edhe ai është dëmtuar gjatë konfliktit prej shtetasit G. M. dhe për të provuar këtë pretendim ka paraqitur në gjykatë dokumente të falsifikuara. Sa më sipër, kallëzuesi ka kërkuar fillimin e procedimit penal ndaj shtetasit K. G. për veprën penale “falsifikim i dokumenteve shëndetësore”, dhe përdorim të tyre në gjykatë, parashikuar nga neni 188 i Kodit Penal. Kallëzuesi i ka bashkëlidhur kallëzimit të gjithë dokumentet shëndetësore të pretenduara të falsifikuara dhe të përdorura në gjykim.

43.1.2. Subjekti i rivlerësimit, në datën 29.10.2014, pa kryer asnjë veprim hetimor, bazuar në nenin 290/1, germa “ç” dhe 291 të Kodit të Procedurës Penale ka marrë vendimin për mosfillimin e procedimit penal nr. {***}, për kallëzimin penal nr. {***}, datë 15.05.2014, pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale. Nga përmbajtja e këtij vendimi, subjekti ka arsyetuar se [...] nëse prokuroria do të hetojë për aktin e ekspertimit mjekoligjor, nëse dëmtimet e shkaktuara shtetasit janë të lehta apo të rënda, vlerësojnë se organet e ndjekjes penale mund të zëvendësojnë në veprimtarinë e tyre organet gjyqësore nuk jemi para ekzistencës së një vepre penale të parashikuar nga legjislacioni penal bazuar në analizën e fakteve dhe konkluzionet e nxjerra arrijmë në përfundimin se materiali i kallëzuar nuk parashikohet nga ligji si vepër penale. Fakti i referuar nuk parashikohet nga ligji si vepër penale. Duke qenë se akti i ekspertimit është shqyrtuar para gjykatës, e cila shqyrton çështjen, është vetëm gjykata ajo që duhet të evidentojë gjatë gjykimit nëse akti i ekspertimit mjekoligjor është ose jo i rremë [...]. Ky vendim i është nënshtruar kontrollit gjyqësor, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, mbi bazën e ankimit të shtetasit G. M., nga Gjykata e Apelit Vlorë, mbi bazën ankimit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, si dhe nga Gjykata e Lartë mbi bazën e rekursit të subjektit të rivlerësimit¹⁰⁰. Në vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit, është vlerësuar se [...] nga ana e organit të akuzës nuk është kryer në mënyrë shteruese dhe ezauruese asnjë veprim për të arritur në përfundimin se fakti penal i pretenduar nga G. M. nuk përbën vepër penale në asnjë rast veprimtaria apo kontrolli i ushtruar nga ana e gjykatës nuk mund të realizojë thithjen e kompetencës kushtetuese të prokurorit për ushtrimin e ndjekjes penale [...].

43.1.3. Trupi gjykues i Kolegjit, në konsideratë të qëndrimit të Gjykatës Kushtetuese, e cila ka vlerësuar se ligjvënësi ia ka nënshtruar kontrollit gjyqësor të gjithë veprimet hetimore paraprake dhe është gjykata që vlerëson bazueshmërinë e veprimeve të prokurorit në ushtrim të funksionit të dhënies së drejtësisë në kontekstin penal¹⁰¹, çmon se për këtë çështje veprimet e subjektit të

¹⁰⁰ Gjykata e rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimi nr. {***}, datë 30.03.2015, ka vendosur: (i) pranimin e ankimit penal të shtetasit G. M.; (ii) shfuqizimin e vendimit datë 29.10.2014, “Mosfillim i procedimit penal nr. {***}” të prokurorit Saimir Smaka; (iii) kryerjen e disa veprimeve procedurale nga prokuroria (pyetje të personave që kanë dijeni për veprën penale); sekuestrim e këqyrje dokumentesh; kryerje të aktekspertimit grafik të dokumenteve. Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin nr. {***}, datë 04.05.2016, të Gjykatës së Apelit Vlorë, ndaj të cilit subjekti i rivlerësimit ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë, i cili nuk është pranuar me vendimin nr. {***} të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

¹⁰¹ Shih vendimin nr. 5, datë 06.03.2009, të Gjykatës Kushtetuese.

rivlerësimit, të vlerësuara në të tre shkallët e gjyqimit, edhe për vetë subjektin, kanë krijuar bindje të plotë për pabazueshmërinë e pretendimit të tij se ka *vepruar bazuar në bindjen e brendshme*. Në këtë situatë faktike, trupi gjykues e vlerëson pretendimin e subjektit të rivlerësimit të pabazuar dhe vetëm si përpjekje për të justifikuar mungesën e argumenteve ligjorë për mosushtrimin e funksionit në përputhje me ligjin, me pasojë cenimin e të drejtave të palëve në proces.

43.1.4. Mbi bazën e kallëzimit penal nr. {***}, të vitit 2016, të shtetasit G. M., i cili ka pretenduar të njëjtat fakte si në procedimin penal nr. {***}, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë më datë 8.6.2016 ka regjistruar procedimi penal nr. {***} *“falsifikim i dokumenteve shëndetësore”*. Nga aktet në dosje, trupi gjykues konstaton se me urdhrin datë 03.04.2017, subjekti i rivlerësimit ka urdhëruar kryerjen e disa veprime hetimore, por i vetmi veprim hetimor i kryer është kërkimi i dosjes gjyqësore në arkivën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, sipas procesverbalit datë 09.05.2017, ku pasqyrohet se dosja nuk u gjet pasi është në Gjykatën e Lartë. Subjekti i rivlerësimit, me vendim, në datën 11.12.2017, bashkon procedimin penal nr. {***}, me procedimin penal {***} të vitit 2017¹⁰² dhe vazhdimin e hetimeve në një procedim të lidhur me nr. {***}, në datën 28.12.2017, bazuar në nenin 326 të Kodit të Procedurës Penale, vendos pezullimin e hetimeve për procedimin penal nr. {***} dhe dërgimin e akteve policisë gjyqësore për ndjekje të mëtejshme, për shkakun se autori i veprës penale nuk njihet. Në këtë vendim, subjekti kryesisht bën të njëjtin arsyetim si në vendimin e mosfillimit të datës 29.10.2014 [...] *duke qenë se akti i ekspertimit është shqyrtuar para një gjykate e cila shqyrton çështjen, është vetëm gjykata ajo që duhet të evidentojë gjatë gjyqimit nëse akti i ekspertimit është i rremë apo jo. Njëkohësisht palët në gjykim nëse kanë pretendime lidhur me aktin e ekspertimit mund të bëjnë kërkesa apo prapësime dhe të kërkojnë kryerjen e një ekspertimi të ri që do të tregonte nëse rezultatet e ekspertimit janë apo jo të vërteta [...]. Më tej, arsyeton se [...] nga rrethanat e mësipërme, duke marrë parasysh edhe deklaratimet e dhëna nga personat si më lart cituar, organi procedues çmon se nuk jemi para ekzistencës së ndonjë vepre penale të parashikuar nga legjislacioni penal. Nga tërësia e veprimeve të mësipërme rezulton se fakti i referuar nuk parashikohet nga ligji si vepër penale. Në kuadër të detyrimit ligjor për të përcaktuar shkakun e ardhjes së pasojës, organi hetimor ka kryer veprimet e duhura dhe të mundshme hetimore dhe nuk është bërë e mundur zbulimi i autorit të veprës penale [...].*

43.1.5. Lidhur me procedimin penal nr. {***}, subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime dhe prova për konstatimet e Komisionit, për rrjedhojë, bazuar në nenin 51 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i ka qëndruar konstatimeve të hetimit, bazuar në provat e disponuara nga dokumentacioni i administruar. Në ankim, subjekti i rivlerësimit pretendoi se bazuar në nenin 326 dhe 343 të Kodit të Procedurës Penale ka vendosur pezullimin e hetimeve deri në përfundimin e gjyqimit nga Gjykata e Lartë, për shkak se nuk mund të administronte në dosje dokumentin objekt ankimi.

¹⁰² Në vendimin e subjektit të rivlerësimit nuk referohen të dhëna për procedimin penal nr. {***} të vitit 2017 dhe në dosjen e procedimit penal nr. {***} nuk ka akte që referojnë të dhëna për procedimin penal nr. {***}.

43.1.6. Sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se për 10 muaj subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer asnjë veprim hetimor, pa asnjë shkak të përligjur a të dokumentuar. Për më tepër, referuar formularit për trajtimin e materialit hetimor, Zv/Drejtuësja e Prokurorisë jep mendim *se [...] duhet të procedohet me regjistrimin e procedimit penal për veprën penale të parashikuar nga neni 188 i K. Penal (të administrohet dosja e procedimit penal dhe të vazhdojnë hetimet sipas vendimit të gjykatës)*. Nga ana tjetër, në vendimin e pezullimit, subjekti i rivlerësimit mban të njëjtin qëndrim sikundër në rastin e procedimit penal nr. {***}, duke dëshmuar, jo vetëm konsistencë të qëndrimeve në kundërshtim me ligjin procedural penal, por edhe mungesë qartësie për kushtet e vendosjes së pezullimit të hetimeve, sipas nenit 326 të Kodit të Procedurës Penale.

43.2. Në përmbledhje, lidhur me procedimet penale nr. {***} dhe nr. {***}, trupi gjykues e vlerëson të bazuar konkluzionet e Komisionit se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer veprimet e nevojshme hetimore se nuk ka administruar në dosje asnjë vendim gjykate për të provuar se procedimi penal nr. {***} përbën “gjë të gjykuar”, si dhe ka zvarritur hetimet pa shkaqe ligjore duke moskryer asnjë veprim hetimor për një periudhë të gjatë për procedimin penal nr. {***}.

44. Lidhur me kallëzimin penal nr. {***}, të shtetasit F. M.¹⁰³ për veprën penale “shpërdorim detyre”, neni 248 i Kodit Penal, regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier¹⁰⁴, nga ana e kësaj prokurorie me vendimin e datës 06.11.2015, është vendosur mosfillimi i procedimit penal, pasi është konstatuar se fakti i kallëzuar nga shtetasi F. M. nuk përmban elementët e një vepre penale të parashikuar nga legjislacioni penal. Komisioni, pas shqyrtimit të dosjes së procedimit penal në ngarkim të të pandehurit F. M. dhe pretendimeve të këtij shtetasi në kallëzim, i ka kaluar barrën e provës subjektit lidhur me sa konstatuar. Subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime vetëm në seancën dëgjimore duke shpjeguar *se e ka çuar shtetasin F. M. në gjyq dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë e ka dënuar me 9 muaj burg*, shpjegime të cilat janë vlerësuar prej Komisionit pa lidhje me konstatimet dhe jo konkrete për të provuar të kundërtën e tyre. Në këtë situatë faktike, Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit: “(a) Nuk ka zbatuar nenet 133 - 141 të Kodit të Procedurës Penale në lidhje me njoftimin e akteve të shtetasit F. M.; (b) Ka cenuar të drejtën e shtetasit F. M. për t’u njohur me dosjen hetimore, duke vepruar në kundërshtim me nenet 105 dhe 110/2 të Kodit të Procedurës Penale”.

44.1. Në ankim, subjekti i rivlerësimit pretendoi se: (i) *veprimet hetimore të kryera në çështjen nr. {***}, datë 25.05.2015, kanë kaluar filtrin e gjykatës, e cila nuk ka konstatuar asnjë shkelje procedurale. Subjekti ka pasur të drejtë të paraqiste në gjykatë të gjithë shkeljet e pretenduara;* (ii) *i pandehuri është njohur me të gjithë aktet e hetimit sepse çështja është dërguar për gjykim;* (iii) *vendimi i prokurorit për marrjen e kopjeve të akteve është në përputhje të plotë me parashikimet e nenit 105 të K.Pr.Penale, kërkesa është bërë gjatë kohës që çështja ishte në gjykim*

¹⁰³ Në kallëzimin e tij, shtetasi F. M. pretendon se: “Drejtuësi i Prokurorisë R. T., prokurori Saimir Smaka, etj., kanë kryer krimin e gjobvënies ndaj tij. Vlera e dëmit prej 110 milion lekësh që i faturohet atij, ka moton ‘O pronën e familjes M., o burgun, o raprezalje, arrestime, gjenocid deri në eliminim fizik’”.

¹⁰⁴ Materiali kallëzues është dërguar për kompetencë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier nga Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria Task-Forcë”.

dhe organi procedues që ka pasur të drejtën të shqyrtojë kërkesën dhe të japë kopje të akteve është gjykata.

44.2. Nga aktet në dosje, trupi gjykues i Kolegjit konstaton dhe vlerëson si vijon.

44.2.1. Subjekti i rivlerësimit/prokuror në procedimin penal nr. {***}, në ngarkim të shtetasit F. M., për veprat penale të parashikuara nga nenet 150 e 200 të Kodit Penal, me vendimin e datës 26.02.2015, bazuar në nenin 34/4 dhe 141/1 të K.Pr.Penale ka deklaruar mosgjetjen e personit nën hetim F. M., ka vendosur caktimin si avokat mbrojtës kryesisht, avokat A. Sh., si dhe “të bëhet njoftimi i personit nën hetim duke i dorëzuar një kopje mbrojtësit të caktuar”. Në përmbajtje të vendimit analizohet se [...] për nevoja të përfundimit të hetimeve është ftuar personi nën hetim F. M. që të paraqitet në Prokurori në datën 20.02.1015. Për njoftimin e kësaj ftese janë ngarkuar shërbimet e policisë gjyqësore. Rezulton se shërbimet e policisë gjyqësore nuk kanë bërë të mundur njoftimin e personit nën hetim dhe kështu nuk është bërë e mundur pyetja e këtij shtetasi [...]. Referuar akteve të prokurorit: (i) vendim për marrjen në cilësinë e të pandehurit të shtetasit F. M. dhe njoftimin e akuzës; (ii) procesverbal për njohjen e të pandehurit me aktet, të cilat mbajnë datën 02.03.2015 dhe janë nënshkruar nga mbrojtësi A. Sh., konstatohet se nuk janë të plotësuara ora dhe data e njoftimit (në vendim) dhe numri i faqeve të fashikullit të hetimeve (në procesverbal). Edhe për shkak të këtyre mangësive, trupi gjykues nuk e gjen të bazuar pretendimin e subjektit që nuk ka shkelje procedurale në veprimet hetimore.

44.2.2. Në dosje janë të administruara procesverbalet e datave 23.02.2015 dhe 25.02.2015 të oficerit të policisë gjyqësore ku pasqyrohet se është shkuar në banesën e shtetasit F. M., e cila është gjendur e mbyllur dhe në ambientet që mendohet se frekuenton, por shtetasi nuk është gjetur. Në dosje nuk gjendet ftesa e përmendur në vendimin e datës 26.02.2015 dhe në procesverbalet e oficerit të policisë gjyqësore nuk përshkruhet arsyeja e kërkimit të personit nën hetim është bërë me qëllim dorëzimin/komunikimin e ftesës së prokurorit. Për rrjedhojë, trupi gjykues konstaton se nuk janë respektuar përcaktimet e nenit 140/1 dhe 141 të Kodit të Procedurës Penale, që parashikojnë njoftimin e të pandehurit nën hetim duke i dorëzuar kopjen e aktit dhe rastet që detyrojnë autoritetin procedues të urdhërojë kërkimin e tij. Gjithashtu, nga aktet në fashikullin e këtij procedimi penal, trupi gjykues konstaton se kërkesat e personit nën hetim për vënie në dispozicion të kopjes së dosjes hetimore nuk dëshmojnë mungesë interesi nga ana e tij e, për rrjedhojë, pamundësinë e organit procedues për gjetjen e tij [në fashikull janë të administruara kërkesa të shtetasit F. M. për vënie në dispozicion të kopjes së dosjes hetimore, të cilat mbajnë datat 27.10.2014, 21.01.2015 dhe 02.04.2015, ku në të parën shtetasi ka shënuar edhe numrin e telefonit celular].

44.2.3. Me vendimin datë 04.04.2015, subjekti i rivlerësimit, bazuar në nenin 110/2 të Kodit të Procedurës Penale, ka vendosur: “Rrëzimin e kërkesë memories të pandehurit F. M. si të pabazuar”. Në përmbajtje të vendimit pasqyrohet se në datën 03.04.2015 është dërguar një kërkesë memorie e paraqitur nga i pandehuri F. M. në të cilën ka kërkuar që të njihet me aktet e dosjes hetimore në ngarkim të tij dhe arsyetohet se është vendosur që në përfundim të hetimeve paraprake çështja penale e tij të përfundojë në gjykim dhe se kompetente për zgjidhjen e çështjes

në themel është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë. Si rrjedhim, duke qenë në këtë fazë të hetimeve, është Gjykata, në kuptim të nenit 110/2 të K.Pr.Penale, organi procedues që shprehet me vendim brenda 15 ditëve dhe edhe kërkesat dhe memoriet e palëve”. Trupi gjykues konstaton se data e kërkesës së shtetasit F. M., e pasqyruar në vendim (03.04.2015) nuk korrespondon me datat e kërkesave të këtij shtetasi të administruara në dosjen penale [shih paragrafin më lart]. Nga aktet në dosje, rezulton se subjekti ka marrë vendim për dërgimin e çështjes për gjykim në datën 02.03.2015 dhe po këtë datë mban kërkesa e tij drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, për gjykimin e këtij procedimi penal. Trupi gjykues, së pari konstaton se mosdisponimi i kërkesës së datës 21.01.2015, kur çështja nuk ishte dërguar për gjykim, për të vjen në shkelje të parashikimeve të Kodit të Procedurës Penale, nenit 105, pika 2 “Marrja e kopjeve, ekstrakteve dhe vërtetimeve”, që përcakton se: “1. Gjatë procedimit dhe pas përfundimit të tij, cilido që ka interes mund të marrë, me shpenzimet e veta, kopje, ekstrakte ose vërtetime të akteve të veçanta. 2. Kërkesa shqyrtohet nga prokurori, për aktet e hetimit paraprak ose nga gjykata që ka dhënë vendimin për ato të shqyrtimit gjyqësor”¹⁰⁵.

44.2.4. Përpos sa më sipër, edhe për kërkesën e datës 02.04.2015, paraqitur në kohën që çështja ishte dërguar për gjykim, vendimi i subjektit të rivlerësimit për rrëzimin e saj vlerësohet nga trupi gjykues jo në përputhje me parashikimet e nenit 105, pika 2 të Kodit të Procedurës Penale, që rregullon lidhur me organin që disponon kërkesat e palëve për kopje të akteve. Shtetasi F. M. ka kërkuar kopje të *materialeve hetimore*, për pasojë, për këtë kërkim, nuk është gjykata organi procedues. Nga ana tjetër, trupi gjykues konstaton se vendimin për rrëzimin e kërkesës së shtetasit F. M. subjekti i rivlerësimit e ka bazuar gabimisht në nenin 110/2 i Kodit të Procedurës Penale¹⁰⁶. Për sa më sipër, veprimet e subjektit të rivlerësimit vijnë në kundërshtim me ligjin procedural penal, me pasojë cenimin e të drejtave të shtetasit F. M. e, për rrjedhojë, pretendimi i subjektit se *vendimi i tij është në përputhje të plotë me nenin 105 të Kodit të Procedurës Penale* vlerësohet prej trupit gjykues i pabazuar.

44.3. Në përmbledhje, trupi gjykues e vlerëson të drejtë konkluzionin e Komisionit se në procedimin penal në ngarkim të shtetasit F. M., subjekti i rivlerësimit nuk ka zbatuar dispozitat e ligjit procedural penal lidhur me njoftimin e akteve dhe ka cenuar të drejtat e tij për t’u njohur me dosjen hetimore.

- 45.** Lidhur me denoncimin për veprime procedurale jo korrekte të subjektit të rivlerësimit në kuadër të procedimit penal nr. 249/2016 për veprën penale të “Dhunës në familje”, subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti shkaqe ankimi të adresuara ndaj konkluzioneve të Komisionit. Për pasojë, trupi

¹⁰⁵ Kodi i Procedurës Penale, në fuqi në kohën e zhvillimit të këtij procedimi, në nenin 105 të titulluar “Marrja e kopjeve, ekstrakteve dhe vërtetimeve” parashikon “1. Gjatë procedimit dhe pas përfundimit të tij, cilido që ka interes mund të marrë, me shpenzimet e veta, kopje, ekstrakte ose vërtetime të akteve të veçanta. 2. Kërkesa shqyrtohet nga prokurori, për aktet e hetimit paraprak, ose nga gjykata që ka dhënë vendimin për ato të shqyrtimit gjyqësor. 3. Lëshimi i kopjeve, ekstrakteve ose vërtetimeve nuk e heq ndalimin e publikimit.”

¹⁰⁶ Palët dhe përfaqësuesit e tyre kanë të drejtë, në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit, të paraqesin memorie dhe kërkesa me shkrim. Organi procedues shprehet me vendim brenda 15 ditëve”.

grykues e gjen pa relevancë pretendimin lidhur me këtë konkluzion, duke konfirmuar si të bazuar në ligj e prova qëndrimin e Komisionit lidhur me këtë çështje.

46. Në analizë të të gjitha konkluzioneve të mësipërme, trupi grykues arrin në përfundimin se subjekti ka demonstruar mangësi në aspektin e njohurive ligjore dhe të arsytimit ligjor, sipas parashikimit të nenit 73, pikat 2 dhe 3 të ligjit nr. 96/2016.
47. Lidhur me procedimin penal nr. {***}, trupi grykues vlerëson të drejtë konkluzionet e Komisionit, lidhur me shkelje të kryera nga subjekti i rivlerësimit në këtë çështje, që janë:
- (i) Kërkesa për caktimin e masës së sigurimit “detyrim për paraqitje”, për shtetasin F. K. nuk është e argumentuar drejt sepse nuk përputhet me pjesën arsyetuese të kërkesës për caktimin e masës së sigurimit dhe me provat e administruara gjatë hetimit.
 - (ii) Ndryshimi i cilësimit të veprës penale nga ana e subjektit nuk është i argumentuar dhe bie në kundërshtim me vetë argumentet e tij të paraqitura në kërkesën për gjykim dhe me provat e administruara gjatë hetimit.
 - (iii) Subjekti i rivlerësimit nuk ka argumentuar kërkesën e tij për pezullimin e ekzekutimit të dënimit penal për shtetasin F. K., duke mos marrë në analizë kushtet e përcaktuara nga neni 59, pika 1 e Kodit Penal.
 - (iv) Subjekti i rivlerësimit ka favorizuar shtetasin F. K., duke cenuar parimin e një procesi të drejtë dhe të barabartë nëpërmjet moszbatimit të dispozitave penale dhe procedurale penale, me pasojë cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë.
48. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të pabazuara konkluzionet e Komisionit dhe pretendoi se ka ushtruar me korrektesë ndjekjen penale, bazuar në bindjen e brendshme dhe provat e administruara, duke parashtruar si më poshtë.

Në ankim:

- Për shtetasin nën hetim F. K., u kërkua masë sigurimi “detyrim paraqitje në policinë gjyqësore”, pasi, sipas aktit të ekspertimit kimik, lënda narkotike e sekuestruar në pjesën më të madhe përbëhet nga paracetamoli dhe ky shtetas rezultoi përdorues dhe i padënuar më parë.
- Për shtetasin nën hetim E. D., u kërkua masë sigurimi “arrest me burg” për shkak se ky shtetas ishte përsëritës, rrethanë që mbahet parasysh në caktimin e masës së sigurimit. Për të njëjtat arsye nuk u kërkua ndaj këtij shtetasi pezullimi i ekzekutimit me burgim.
- Gjykata ka vlerësuar të aplikojë të njëjtën masë dënimi për të dy të pandehurit dhe pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim për njërin prej tyre.
- Në përfundim të hetimeve, ka çmuar se vepra penale e konsumuar nga secili i pandehur është ajo e parashikuar nga neni 281/1 i Kodit Penal. Të dhënat e grumbulluara nuk provonin, tej çdo dyshimi të arsyeshëm, ndonjë nga rrethanat cilësuese të parashikuara nga neni 283/2 i Kodit Penal.
- Ka vlerësuar të mos bëjë ankim ndaj vendimit të gjykatës, pasi mos bërja e ankimit është në çmim të prokurorit, në varësi të arsytimit të vendimit. Sipas urdhrave të Prokurorit të

Përgjithshëm dhe parashikimeve të Kodit të Procedurës Penale, neni 408 e vijues, janë të parashikuara rastet kur ankimi i prokurorit është taksativ.

*Në parashtrimet e depozituara në Kolegj, me nr. {***} prot., datë 24.07.2023, subjekti ngriti të njëjtat pretendime si në ankim dhe potencoi se bazuar në vendimin e GjKKO-së nr. 109, datë 28.12.2021, ku është konkluduar se fakti nuk ekziston, ka rënë çdo dyshim i Komisionit, bazuar në informacionet e dërguara nga institucionet ligjzbatuese.*

49. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit, pas shqyrtimit të akteve në dosje dhe pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, në ankim dhe në parashtrime, shtjellohet në detaj si vijon.

49.1. Së pari, nga aktet në dosje, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se:

49.1.1. Në datën 24.11.2017, Drejtoria e Policisë Vlorë ka përcjellë në prokurori materialet procedurale¹⁰⁷ në ngarkim të shtetasve E. D. dhe F. K., të arrestuar në flagrancë për kryerje të veprës penale “*prodhim dhe shitje të lëndëve narkotike*”. Në po këtë datë, me urdhër të subjektit të rivlerësimit është regjistruar procedimi penal nr. {***}, për veprat penale “*prodhim dhe shitje të lëndëve narkotike*”, parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal, si dhe është urdhëruar regjistrimi si persona nën hetim i shtetasve E. D. dhe F. K..

49.1.2. Sipas procesverbalit të datës 23.11.2017, të kapjes në flagrancë:

- shtetasi E. D. është arrestuar duke i shitur një dozë heroine një shtetasi tjetër, në xhepin e xhupit i janë gjetur 12 doza heroine në qese të vogla plastmasi dhe ka deklaruar se këto doza i ka blerë nga shtetasi F. K. për t'i shitur se është i papunë dhe për përdorim vetjak.
- shtetasit F. K., nga kontrolli i banesës i është gjetur një qese e madhe me pluhur heroine, një sasi materiali bimor me ngjyrë jeshile *canabis sativa*, një sërë medikamentesh mjekësore dhe një qese tjetër me 12 doza heroine në qese të vogla plastmasi. Në procesverbalin e datës 23.11.2017 “Për marrjen e të dhënave nga personi ndaj të cilit zhvillohen hetime”, ky shtetas deklaron se *lëndën narkotike që iu gjet e ka për përdorim vetjak dhe një pjesë për ta shitur te përdoruesit e tjerë*. Të dy shtetasit E. D. dhe F. K. e kanë pranuar kryerjen e veprës penale dhe kanë kërkuar gjykim të shkurtuar.

49.1.3. Sipas procesverbalit të përgjimit ambiental, datë 24.11.2017, kryer me vendim të subjektit të rivlerësimit, ndër të tjera, nga biseda e dy shtetasve është fiksuar: “E. D.: *na kanë kapur me fotografi ore, unë tek ty e ti tek mua se kemi marrë gjëra. [...] F. K.: epo më plasi mua ça thonë ata, burgu për burra është [...]. E. D.: Martinin e kapën lart. U futën renda në shtëpi dhe më treguan fotot, ja ku je, ja ku ke vajtur, kë ke takuar, ça ke dhënë [...] F. K.: Epo ja do t’i shikoj, le*

¹⁰⁷ Informacion për referim të veprës penale tek Prokurori; procesverbal i kapjes në flagrancë, raport shërbimi, procesverbal i kontrollit të vendeve-3 copë, procesverbal për këqyrjen dhe marrjen e provave materiale-3 copë, procesverbal për sekuestrimin e provave materiale-3 copë, procesverbal për peshimin e provave materiale-4 copë; vendim për kryerjen e ekspertimit biokimik-4 copë; procesverbal për marrjen e mostrës së urinës-3 copë; vendim për kryerjen e ekspertimit toksikologjik- 3 copë; procesverbal i deklarimit të personit ndaj të cilit zhvillohen hetime-3 copë; procesverbal i arrestimit në flagrancë-3 copë; procesverbal kontrolli personal -2 copë; letra e të drejtave të arrestuarit -2 copë. Të gjithë dokumentet e sipërcituar mbajnë datën 23.11.2017.

të m'í tregojnë mua. E. D.: e di ore që jemi për burg, këtyre i do dhënë ndonjë lekë. Po ne s'kemi lekë [...]. F. K.: Po nuk del asnjë kafe [...]".

49.1.4. Në datën 24.11.2017, subjekti i rivlerësimit i kërkon gjykatës vlerësimin e arrestit në flagrancë dhe caktim mase sigurimi personal "arrest në burg" për të dy shtetasit. Në kërkesë, subjekti i rivlerësimit citon *se të dhënat dhe deklaratimet që i bashkëlidhen kësaj kërkesë mbështesin ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm se këta shtetas janë autor të veprës penale "prodhim dhe shitja e lëndëve narkotike", të parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal*¹⁰⁸.

49.1.5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. {***}, datë 25.11.2017, duke arsyetuar se [...] në rastin konkret, personi nën hetim është i dyshuar për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga neni 283/2 i Kodit Penal [...] vleftëson të ligjshëm arrestimin në flagrancë të dy shtetasve dhe cakton për të dy masën e sigurimit "arrest me burg", me afat 40 ditë. Vendimi ka marrë formë të prerë me vendimin nr. {***}, datë 20.12.2017, të Gjykatës së Apelit Vlorë.

49.1.6. Në datën 03.01.2018, subjekti i rivlerësimit i kërkon sërish Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë caktimin si masë sigurimi personal "arrest në burg" për dy shtetasit e sipërcituar, duke cituar sërish se *dyshohen për kryerje të veprës penale "prodhim e shitje lëndësh narkotike", neni 283/2 i Kodit Penal*. Në kërkesë theksohet se organi procedues është në pamundësi të përcaktimit të llojit të lëndës narkotike, pasi nuk është administruar akti i ekspertimit kimik.

49.1.7. Në datën 2.2.2018 subjekti i rivlerësimit i kërkon sërish Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë caktimin e masës së sigurimit personal "arrest në burg" për shtetasin E. D., ndërsa për shtetasin F. K. kërkon caktimin e masës "detyrim paraqitje". Në këtë kërkesë, subjekti argumenton se *nga të dhënat dhe deklaratimet e cituara, mbështetet ekzistenca e dyshimit të arsyeshëm se shtetasit janë autorë të veprës penale "prodhimi e shitje e lëndëve narkotike", të parashikuar nga neni 283/2 i Kodit të Procedurës Penale, dhe se të gjitha rrethanat e bëjnë të domosdoshme dhe në përputhje me nevojat e sigurimit caktimin ndaj tyre të masës së sigurimit "arrest në burg", duke krijuar një kontradiktë mes arsyetimit dhe kërkimit për masën ndaj shtetasit F. K..*

49.1.8. Me kërkesën e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë, përfaqësuar nga subjekti i rivlerësimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendim nr. {***}, datë 6.02.2018, cakton masë sigurimi "arrest me burg" për shtetasin E. D. dhe "detyrim paraqitje" për shtetasin F. K., duke urdhëruar lirimin e tij. Në po të njëjtën datë, më 06.02.2018, subjekti i rivlerësimit nxjerr urdhrin për ekzekutimin e menjëhershëm të vendimit nr. {***}, datë 06.02.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, për lirimin e menjëhershëm të shtetasit F. K..

49.2. Në seancë gjyqësore, ku ka zgjedhur të japë shpjegimet për barrën e provës, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se [...] *mendoj se s'ka ndonjë problematikë, sepse sasia e lëndës narkotike e gjitha është 2 gram dhe madje mund të ishte në kufijtë e pushimit të çështjes. Prokuroria e Vlorës deri në 3 gram i pushon direkt, nuk hyn fare në hetim, do të thotë që është*

¹⁰⁸ Kodi Penal në nenin 283, paragrafi i dytë parashikon: "[...] Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga shtatë gjer në pesëmbëdhjetë vjet".

sasi shumë e vogël dhe që nuk mendoj se përbën ndonjë rrezikshmëri të madhe, sepse caktova detyrim paraqitje për njërin dhe arrest me burg për tjetrin. Ata mund t'í hetosh edhe pa masë fare, në lidhje me ndryshimin e cilësimit juridik, në përgjimin ambiental që është kryer në Drejtorinë Vendore të Policisë Vlorë nuk provohet bashkëpunimi [...] po të lexosh me kujdes dosjen personat janë arrestuar në vende të ndryshme, pra, nuk janë arrestuar në ndonjë makinë apo në ndonjë banesë që t'í çosh në bashkëpunim [...] njëri thotë e shes tjetri thotë e blej thotë se e konsumon vetë [...], për më tepër, edhe në rast se unë kam gabuar në lidhje me pezullimin është vendimi i gjykatës më se i drejtë, i kanë dhënë të dyve pezullim [...] ¹⁰⁹.

49.3. Pas shpjegimeve, trupi gjykues i Komisionit i ka drejtuar disa pyetje subjektit, për të cilat ka marrë përgjigje si vijon.

- Lidhur me përcaktim ligjor për sasinë minimale të lëndës narkotike të lejuar për përdorim, ka shpjeguar se [...] ka disa vendime unifikuese [...] ata nuk përcaktojnë një limit të themi kështu [...] nuk ka normativë [...] ¹¹⁰.
- Lidhur me raportin midis dy shtetasve nën hetim, ka shpjeguar se [...] janë në një marrëdhënie të tillë që njëri e shet e tjetri e mban për qëllime përdorimi [...] po ta lexosh me kujdes te përgjimi ambiental ata flasin më shumë për mundësitë e tyre jo për bashkëpunimin [...] bashkëpunimi ka ca elementë, se ka marrëveshjen, marrëveshja është para kryerjes së veprës penale [...] ¹¹¹.
- Lidhur me ndryshimin e cilësimit të veprës penale, ka shpjeguar se [...] masat i kam kërkuar për 238/2 [...] gjyqtari i seancës paraprake e ka konfirmuar këtë cilësim [...] e njëjta gjë ka ndodhur edhe me gjyqtaren e themelit [...] ka dhënë të njëjtin cilësim juridik por vetëm ka diferencuar llojin dhe masën e dënimit [...] prokurori nuk është i lidhur domosdoshmërisht me atë cilësim juridik që sjell policia gjyqësore, është në çmimin e tij që të vlerësojë nëse jemi përpara faktit penal të prodhimit e shitjes së lëndëve narkotike në bashkëpunim [...] ¹¹².
- Lidhur me mosankimin ndaj vendimit të gjykatës që ka vendosur në kundërshtim me sa kërkuar prej tij për shtetasin E. D., ka shpjeguar se [...] e kam konsultuar me vetë gjyqtaren e çështjes dhe me thotë në një bashkëbisedim juridik [...] dhe më ka thënë ke mbajtur një qëndrim të diferencuar në lidhje me rastin konkret [...] duke çmuar analizën juridike të fakteve, provave e rrethanave që dolën gjatë shqyrtimit gjyqësor mendoj se vendimmarrja ishte e drejtë dhe, për këtë arsye, nuk i kam bërë apel [...] ¹¹³.
- Lidhur me kërkesën për masa sigurie të ndryshme për të pandehurit, ka shpjeguar se [...] kam vlerësuar personalitetin e të pandehurve, sepse siç e thashë, lënda narkotike ka qenë në limit, 2 gram dhe e përzier [...] i pandehuri F. K. nuk ka qenë i dënuar më parë, jo për këtë vepër, mund të ketë qenë i dënuar për vepra të tjera [...] ¹¹⁴.

¹⁰⁹ Shih faqe 26 të procesverbalit të seancës dëgjimore.

¹¹⁰ Shih faqe 35-36 të procesverbalit të seancës dëgjimore.

¹¹¹ Shih faqe 39 të procesverbalit të seancës dëgjimore.

¹¹² Shih faqe 47 të procesverbalit të seancës dëgjimore.

¹¹³ Shih faqe 49 të procesverbalit të seancës dëgjimore.

¹¹⁴ Shih faqe 51-52 të procesverbalit të seancës dëgjimore.

49.4. Trupi gjykues vlerëson se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit vijnë në kundërshtim me parashikimet e Kodit Penal dhe të qëndrimit të Gjykatës së Lartë me vendimin Unifikues nr. 1, datë 27.03.2008¹¹⁵ dhe dëshmonen si përpjekje të tij për minimizim në maksimum të rëndësisë së faktit penal dhe rrezikshmërinë e të pandehurit F. K., i cili gjatë hetimit ka pohuar se lëndën narkotike e ka për përdorim vetjak *dhe për ta shitur*, pohim i njëjtë i bërë edhe nga i pandehuri tjetër E. D..

49.5. Nga aktet e sipërreferuara, përfshirë edhe ato të nxjerra prej vetë subjektit të rivlerësimit, evidentohet se shtetasit janë autorë të veprës penale “*prodhimi e shitje e lëndëve narkotike*”, kryer në bashkëpunim, vepër e parashikuar nga neni 283/2 i Kodit të Procedurës Penale. Të gjitha provat e grumbulluara, dëshmonin bashkëpunimin mes të pandehurve, njohjen me njëri-tjetrin, marrëveshjen për të tregtuar së bashku me role të përcaktuara lëndën narkotike (shtetasi F. K., të cilit i janë gjetur edhe mjete për prodhim, prodhon dhe shet, kurse shtetasi E. D. blen prej tij për të shitur), shqetësimin e përbashkët të evidentuar në përgjimin ambiental se do të vihen nën përgjegjësi për aktivitetin e përbashkët kriminal, si edhe elementë të tjerë që të çojnë në konkluzionin se vepra është kryer në bashkëpunim, ashtu siç vetë subjekti ka ngritur dyshimet e para e ka urdhëruar regjistrimin e saj në regjistrin e njoftimeve të veprave penale. Pavarësisht se fillimisht, mbi këto prova, për dy të pandehurit, subjekti i rivlerësimit ka bërë klasifikimin e të njëjtës veprës penale, sipas nenit 283/2 të Kodit Penal, në kërkesën për gjykim e çështjes së datës 23.05.2018 e ka ndryshuar këtë kualifikim duke e kualifikuar veprën, sipas nenit 283/1 të Kodit Penal, pa paraqitur asnjë provë ose rrethanë të re apo të ndryshme që nga hetimet e para për asnjërin prej të pandehurve. Ndërsa në “konkluzione përfundimtare” ka referuar të gjithë të dhënat e rezultuara nga hetimi për të dy të pandehurit, sikundër në aktet e mëparshme të tij, subjekti ka konkluduar se *ndodhemi para elementëve të figurës së veprës penale “prodhim dhe shitje e lëndëve narkotike”* dhe pa analizuar kriteret e parashikuara nga neni 59, pika 1 e Kodit Penal, ka kërkuar

¹¹⁵ Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë unifikuar praktikën gjyqësore lidhur me: 1. Mbi cilat kritere duhet të bazohet gjykata për të përcaktuar nëse bëhet fjalë për “dozë të vogël” dhe a mund të përcaktohet konkretisht sasia maksimale e lëndës narkotike që do të konsiderohet “dozë e vogël”? 2. Kur doza çmohet jo e vogël, por mjekët e konsiderojnë për përdorim vetjak ditor, a do konsiderohet mbajtja e saj si “për përdorim vetjak”? 3. Sasia e lëndës narkotike, që përjashton nga dënimi personin, për shkak të faktit që e ka për përdorim vetjak, a duhet të ndryshojë në lidhje me llojin e lëndës narkotike? Lidhur me nocioni juridiko-penal që është shprehur nga ligjvënësi me togfjalëshin “në doza të vogla”, Kolegjet e Bashkuara Penale të Gjykatës së Lartë edhe pse nuk mund të bëhet ndonjë përcaktim numerik i sasisë së lëndëve të ndaluara që do të shprehte në peshë sasinë e dozës për t’u konsideruar e vogël, duhet të interpretohet në kuptimin që, në aspektin sasior, lënda narkotike dhe psikotrope etj., duhet të jetë në atë masë sa të konsiderohet realisht e vogël për përdorim vetjak nga ana e individit konkret, dhe jo në përgjithësi Përdoruesi i lëndëve narkotike, i cili e mban atë jo për përdorim vetjak, qoftë edhe në doza të vogla, kur është shpërndarës i saj në një nga format që parashikon neni 283/1 i Kodit Penal, ka përgjegjësi penale sipas kësaj dispozite. Çmojnë gjithashtu se përcaktimi i dozës së vogël të lëndës narkotike e psikotrope, për efekt të zbatimit të dispozitës së nenit 283 të Kodit Penal, duhet të bëhet me ndihmën e specialistëve të fushës (toksikologë etj.), të thirrur si ekspertë dhe rast pas rasti, jo vetëm sipas llojit të lëndës narkotike e psikotrope, por edhe të cilësive fiziko-biologjike dhe shkallës së vartësisë nga droga të personit konkret-mbajtës i lëndës narkotike dhe psikotrope”.

pezullimin e ekzekutimit të vendimit dhe vënien në provë të të pandehurit F. K.. Neni 283/2 është cituar prej subjektit edhe në kërkesën e drejtuar gjykatës në datën 02.02.2018, ku diferencon masat e sigurimit ndaj shtetasve, në mënyrë të paargumentuar përkundrejt qëndrimit të tij deri në këtë moment. Ky fakt është evidentuar edhe nga Drejtuesi i Prokurorisë/ drejtuese e seksionit, të cilët në *formularin për njohjen e ecurisë dhe përfundimin e çështjes*, nënshkruar prej tyre, kanë dhënë mendim në aktet e njoftimit të akuzës duhej të argumentohej pse vepra penale nuk është kryer në bashkëpunim, sepse procedimi penal është regjistruar për nenin 283/2 të Kodit Penal.

49.6. Subjekti i rivlerësimit në këtë procedim rezulton të ketë ndryshuar akuzën për të pandehurit, pa analizuar elementët e veprës penale për të cilën ai ka arritur në konkluzion. Ai ka shmangur nga analiza mungesën e marrëveshjes mes tyre dhe pse aktiviteti i kryer prej të pandehurve duhej konsideruar si veprimtari, e cila ishte zhvilluar në mënyrë autonome, kur të gjitha faktet që kishin rezultuar prej hetimit flisnin për të kundërtën. Pretendimi se ky konkluzion është një çështje e bindjes së brendshme vlerësohet si abuziv, pasi e gjithë analiza që duhej të bënte subjekti duhej mbështetur në faktet e rezultuara prej hetimit dhe në vlerësimin e elementëve të veprës penale për të cilën ishte regjistruar fillimisht procedimi, si e kryer në bashkëpunim. Pa asnjë shkak ligjor dhe faktik, subjekti rezulton të ketë kërkuar edhe diferencim të masave të dënimit për dy të pandehurit, ndërsa duket se ka lehtësuar në kërkimin e tij pozitën e të pandehurit Kalemaj, i cili rezulton se ka pasur një rol më aktiv dhe të spikatur në kryerjen e aktivitetit kriminal. Si pasojë e këtij lehtësimi, pasi gjykata ka dhënë dënime të njëjta për të dy të pandehurit, subjekti duket se ka hequr dorë nga mbrojtja e kërkimit të tij nëpërmjet apelimit të vendimit gjyqësor, duke lehtësuar në këtë mënyrë edhe pozitën e të pandehurit tjetër D.. Pretendimi i subjektit se ankimi nuk ishte i detyrueshëm nuk është relevant, për sa kohë që trupi gjykues po vlerëson logjikën dhe mungesën e argumentit të konstatuar në qëndrimin e subjektit në vlerësimin e kësaj çështje dhe jo moszbatimin prej tij të udhëzimeve të detyrueshme.

49.7. Për sa më sipër, shkeljet e konstatuara në procedimin penal të analizuar vlerësohen prej trupit gjykues se demonstrojnë mangësi të theksuara në aspektin e njohurive ligjore dhe të arsytimit ligjor, sipas parashikimit të nenit 73, pikat 2 dhe 3, të ligjit nr. 96/2016.

49.8. Përveç sa më sipër, konsideruar dijeninë e subjektit për dyshime të ngritura ndaj aktivitetit të tij procedural lidhur me këtë çështje, për shkak të të dhënave që janë përcjellë nëpërmjet shkresave të Prokurorisë së Posaçme¹¹⁶, pohimet e subjektit, në seancën dëgjimore në përgjigje të pyetjeve të bëra nga trupi gjykues dhe vëzhguesi ndërkombëtar, të marra vetëm pas insistimit të trupës së Komisionit, të cilat konfirmojnë vërtetësinë e disa prej informacioneve konfidenciale të aksesuara nga trupi gjykues në agjencitë ligjzbatuese, arrihet në konkluzionin se motivet e subjektit, që mbështesin veprimtarinë e tij të paligjshme në procedimin penal të përshkruar më lart, afektojnë nënindikatorin e integritetit të parashikuar nga neni 75, pika 3 e ligjit nr. 96/2016. Në këtë arsyetim përfshihet edhe konkluzioni i arritur në paragrafin nr. 35.6 të këtij vendimi, rreth peshës që kanë informacionet që janë marrë në kuadër të kriterit të kontrollit të figurës, të cilat

¹¹⁶Shkresat e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, nr. {***} prot., datë 04.02.2020, administruar në Prokurorinë e Përgjithshme me nr. {***} prot., datë 06.02.2020, dhe nr. {***} prot., datë 26.05.2021, administruar në Komision me nr. {***} prot., datë 27.05.2021.

potencojnë përfundimin e arritur për mangësitë e theksuara të subjektit në drejtim të kriterit të aftësive profesionale.

50. Në konkluzion, trupi gjykues, arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e nenit 44, germa “c” e ligjit nr. 84/2016 dhe, për pasojë, ai kualifikohet si i papërshtatshëm në kuptim të nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.
51. Trupi gjykues, mbështetur në konkluzionet e mësipërme, e gjeti pa vend aplikimin e nenit 61, pika 5 e ligjit nr.84/2016, përderisa të gjithë elementët e përfshirë në analizën për mbështetjen e këtij konkluzioni prej Komisionit janë kualifikuar nga kjo trupë gjykuese si të përfshira në mangësi nën dritën e nenit 61, pika 3, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe nenit 61, pika 4 të ligjit, lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale.
52. Për sa më lart, trupi gjykues vlerëson se vendimi nr. 415, datë 07.07.2021, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Saimir Smaka, është i mbështetur në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 415, datë 07.07.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Saimir Smaka.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 20.09.2023, në Tiranë.

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

RELATORE

Ina RAMA

nënshkrimi

KRYESUESE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi